

Titulli: MORALI ISLAM

Nga: Komisioni i përgatitjes së librave mësimorë

E përktheu nga arabishtja: Vullnet Merja

Redaktoi: Hajri Shehu

Korrektore teknike: Vjollca Feza

Kopertina: T. Gorbani

Përkujdesja grafike:

Botoi: Shoqata "Flladi"


ISBN

Copyright: Shoqata "Flladi"

Tirazhi 1000 kopje

Formati:

Shtypur në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese "LILO"



Shoqata
Flladi

PARATHËNIE

Në moralin islam, fjala *terbijeh*, "edukatë" është e bashkëshoqëruar me fjalën *ta'lim* "studim". Prandaj dijetarët e fesë dhe mësuesit e medreseve thonë se edukata është mesazh për udhëzimin e njerëzisë.

Në Kur'anin Famëlartë, në synnetin e Profetit Fisnik (s.a.u.s) dhe në thëniet e imamëve të Ehli Bejtit (a.s) dëshmohet fuqishëm rëndësia e edukimit dhe e pastërtisë së shpirtit. Ato nxjerrin në pah se studimi pa edukim nuk mund të jetë pishtar ndriçues; studimi mund të shndërrohet në një mbulesë, e cila e pengon njeriun që të ecë në rrugën e plotësimit e të përsosurisë. Nga këtu kuptohet qartë se, morali që urdhëron feja për edukimin e vetes është prej shtyllave themelore të programeve mësimore- edukative. Shpërfillja e moralit ka rezultate dhe ndikime negative në jetën individuale dhe atë shoqërore.

Nganjëherë fjalët "etikë" dhe "moral" kanë kuptim të përbashkët; nganjëherë kanë kuptime të veçanta dhe të pavarura. Nëse i kuptojmë ashtu siç duhet etikën dhe moralet e mira, do të mësojmë se kanë përmbajtje më të gjerë, kjo përmbajtje e gjerë është kultura. Kultura përfshin zakonet e sjelljet të cilat i japin çdo shoqërie njëjtësinë (identitetin) dhe përcaktojnë pozitën e saj.

Islami, në mesazhin e tij për mbarë njerëzinë i fton shoqëritë që të përvetësojnë moralet, të cilat janë në përputhje me natyrën krijuese të njeriut. Islami nuk i mohon zakonet shoqërore që kanë bashkësitë; ai mohon zakonet që janë në kundërshtim me thelbin e fesë së All-llahut (xh.sh.). Profeti Muhammed (s.a.u.s.), pasi i erdhi kurora e profetësisë, nuk i mohoi zakonet dhe traditat e pëlqyeshme të asaj kohe. Ai thoshte se ato zakone janë plotësuese për moralet e mira.

Kultura luan rol të madh në shoqëri. Njësoj si gjaku, i cili qarkullon në çdo qelizë të trupit të njeriut, po ashtu edhe kultura depërton në çdo qelizë të shoqërisë, te mendimtarët, punonjësit dhe institucionet e mëdha a të vogla. Kësisoj, kultura ndryshon jetën shoqërore.

Kur erdhi Islami dhe u përhap drita dhe ngrohtësia e tij u formua një shoqëri e re, me shpirt të ri. Ky shpirt është solidarësia dhe dashuria mes anëtarëve të saj.

All-llahu (xh.sh.) thotë: ***“Muhammedi është i dërguari i All-llahut, e ata (sahabët), që janë me të janë të ashpër kundër jobesimtarëve, e të mëshirshëm ndërmjet njëri-tjetrit...”*** (Surja “Fet'h” 29)

Dhe: ***“Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur të shpenzoje çfarë ka në Tokë, nuk do të arrije t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, sepse Ai është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”*** (Surja “Enfal”: 63)

Kur njerëzit i besuan mesazhit të Profetit Muhammed (s.a.u.s) dhe përqafuluan fenë e All-llahut (xh.sh.) turma-turma, filloi të dukej një kulturë e re. Njëherazi, Profeti (s.a.u.s.) i shfarosi ato zakone dhe tradita që ishin në kundërshtim me natyrën krijuese të njeriut. Ai ftoi të falej namazi me xhemat, të falej namazi i xhumasë; ai urdhëronte në të mira dhe ndalonte nga të këqijat; ai nxiste për marrëdhënie të fuqishme vëllazërore, për respektimin e prindërve, për mbajtjen e lidhjeve

farefisnore, për respektimin e fqinjit dhe të drejtat e fqinjit etj. Ai e ftonte besimtarin për ta zbukuruar veten me vetitë e pëlqyera morale, si; thjeshtësia, mbajtja e premtimeve, zemërbutësia, vetëpërmbytja, falja, respektimi dhe nderimi i jetimëve, vizita tek i sëmuri, pjesëmarrja në gëzime e hidhërime, mikpritja, çuarja e amanetit etj. Nga ana tjetër, ai luftonte sjelljet e këqija, si përgojimin, smirën, thashethemen, talljen dhe përqeshjen e të tjerëve, gënjeshtren etj.

Kur Islami parashtroi etikën dhe kulturën e tij, nuk e parashtroi thjesht bojë mbi letër, këto duhen zbatuar me qëllim që të forcohet personaliteti i individit dhe i shoqërisë. Në programin e Islamit gjendet shpërblimi dhe ndëshkimi në këtë jetë e në Jetën tjetër. Islami përqendrohet në vazhdimësinë e jetës së njeriut pas vdekjes. Në atë jetë njeriu do të korrë atë që ka mbjellë në këtë jetë.

Sipas kulturës dhe etikës islame, individ i që punon për veten e tij, sjell edhe produkte shoqërore; p.sh, kur myslimani kujdeset për jetimin, ai ka si qëllim të fitojë kënaqësinë e All-llahut dhe Xhennetin; nga ana tjetër, ai i siguron jetimit një jetë të sigurt dhe e edukon me kulturë të dobishme për shoqërinë. Pra, kultura islame i vizaton individit dhe shoqërisë rrugën e vërtetë për të arritur lumturinë e vërtetë në këtë jetë dhe në Jetën tjetër.

I nderuar lexues! Shoqata "*Flladi*", sjell në duart tuaja këtë libër me titull "*Morali Islam 2*", i cili flet për etikën dhe moralin e myslimanit. Ky libër është përgatitur nga komisioni i përgatitjes së librave mësimorë që ndodhet pranë shoqatës së shkollave të fesë e Kur'anit në Republikën Islamike të Iranit. Njëkohësisht ky libër është përkthyer edhe në gjuhën arabe. Lusim All-llahun fuqiplotë që ky libër të jetë i dobishëm për lexuesit dhe kërkuesit e moraleve të pëlqyeshme, që të jemi shembull i përkryer në shoqëri. Shoqata "*Flladi*" falënderon të gjithë ata e të gjitha ato që morën pjesë në përgatitjen e këtij libri.

All-llahu u dhëntë suksese në jetën dhe veprimtaritë e tyre në këtë botë dhe na shpërbleftë me Xhennet në botën tjetër

MËSIMI 1

POZITA E DIJES DHE E DIJETARËVE NË ISLAM

Kërkimin e diturisë dhe të njohjes Islami e konsideron njësoj si çështjet e tjera të jetës. Edhe këto kanë rregulla të veçanta. Disa prej rregullave kanë të bëjnë me mësuesin gjatë mësimit. Disa të tjera kanë të bëjnë me nxënësit dhe studentët në marrëdhëniet e tyre shoqërore në klasë. Disa të tjera kanë të bëjnë me mësuesit dhe nxënësit së bashku. Këtu po paraqesim pozitën e dijes e të dijetarëve në Islam nëpërmjet thëniesve të Kur'anit dhe të haditheve profetike.

a- Pozita e dijes dhe e dijetarëve në Kur'an

E para fjalë që iu shpall të dërguarit tonë Hazreti Muhammedit (s.a..u s.) ishte fjala *“Lexo!”* Për këtë All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”**(1)

(1) (Sure “Alak”, ajetet 1-5.)

All-llahu (xh.sh.) i lartëson dijetarët besimtarë më shumë se sa të tjerët. Ai (xh. sh.) thotë: **“...All-llahu i lartëson ata prej jush që besuan, i lartëson në shkallë të lartë, ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni.”** (2)

(2) (Sure “El Muxhadele”, ajeti 11.)

Nuk ka dyshim se urtësia është burimi i mirësive dhe atij që i është dhënë urtësia, i është dhënë mirësi e madhe. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, i është dhuruar mirësi e madhe; përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush.”** (3)

(3) (Sure “El Bekare” ajeti, 269.)

Dijetarët, siç thotë Kur’ani Famëlartë, kanë pesë cilësi:

1- Besimin. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Ai është që ta zbriti librin ty e në të ka ajete të qarta. Dhe ato janë bazë e librit. E ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E, ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë, për të shkaktuar hutë, e kinse kërkojnë komentimin e tyre. Por, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: “Ne u kemi besuar atyre që janë të paqarta, të gjitha janë**

nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes..." (4)

(4) (Sure "Ali Imran" ajeti 7.)

2- Tehuhidin (besimin se Zoti është Një e i Pashoq). All-llahu (xh.sh) thotë: "All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dhe dëshmuan edhe melekët e dijetarët dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit..." (5)

(5) (Sure "Ali Imran", ajeti 18.)

3- Pikëllimi ndaj frikës së All-llahut. Në Kur'an thuhet: "Thuaj: "I besuat ju atij ose nuk i besuat (atij nuk i bëhet dëm), e atyre që u është dhënë dijeni (nga librat e parë) para tij, kur u lexohet atyre, ata hidhen me fytyra (përdhe) duke i bërë. Dhe thonë: "I lartësuar është Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është përmbushur. Dhe duke qarë, hidhen me fytyra (përdhe) (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më përlujen (ndaj All-llahut)." (6)

(6) (Sure "El Isra", ajetet 107-109.)

4- Devotshmëria dhe frika ndaj All-llahut (xh.sh.). Në Kur'an thuhet: "Edhe te njerëzit, edhe te gjallesat, edhe te kafshët po ashtu ka ngjyrave të ndryshme. Por nga robtë e Tij ia kanë frikën All-llahut vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është Mëkatfalës." (7)

(7) (Sure "El Fatir", ajeti 28.)

b- Pozita e dijes dhe e dijetarëve në hadithet profetike

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë:

1 - "Atij që All-llahu ia do të mirën, e mundëson të studiojë fenë." (8)

(8) (Sahibul Buhari, kapitulli i dijes.)

2 - "Dijetarët e ymmetit tim janë si të dërguarit e Beni israilitëve." (9)

(9) (Biharul Anuar, vëll. 2, f. 22, kap. 8.)

3 - "Dijetarët janë trashëgimtarët e të dërguarve (profetëve)." (10)

(10) (Sunen ibn Maxhab, vëll. 1. kap. 18, hadithi /223.)

4 - "Për dijetarin kërkojnë falje ç'farë ka në qiej e në Tokë." (11)

(11) (Sunen ibn ebi Daud, vëll. 2. f. 285.)

5 - "Njerëzit më të afërt me profetët janë dijetarët dhe muxhahidinët: dijetarët u mësojnë njerëzve ato që sollën të dërguarit; ndërsa

muxhahidinët, me shpatat e tyre sakrifikojnë për mbrojtjen e atyre që sollën të dërguarit.” (12)

(12) (Ihja ulumi dijn i Gazaliut, kapitulli i dijes.)

6 - “Në Ditën e Gjykimit, boja e dijetarit do të peshohet me gjakun e dëshmorëve.” (13)

(13) (Ihja ulumi dijn i Gazaliut, kapitulli i dijes.)

7 - “Dijetarët në Tokë janë të njëjtë me yjet në qiell që tregojnë rrugën në errësirat e Tokës e të detit. Po të shuhen udhëzuesit (yjet), mund të humbasim.” (14)

(14) (Kenzul Ummal, hadithi / 28769.)

8 - “All-llahu e udhëzoi Ibrahimin (a. s.) duke i thënë: “O Ibrahim, Unë jam i Gjithëdijshëm dhe i dua dijetarët.” (15)

(15) (Ihja ulumi dijn i Gazaliut, kapitulli i dijes.)

9 - “Vdekja e një fisi është më e lehtë se vdekja e një dijetari.” (16)

(16) (Ihja ulumi dijn i Gazaliut, kapitulli i dijes.)

10 - “Atij që studion fenë e All-llahut, All-llahu do t’ia largojë vështirësitë dhe do t’i dhurojë mirësi kur ai nuk pret t’i vijë ato.” (17)

(17) (Ihja ulumi dijn i Gazaliut, kapitulli i dijes.)

11 - “Ditën e Gjykimit bëjnë ndërmjtësim tre veta: të Dërguarit, dijetarët dhe dëshmorët (në rrugën e All-llahut).” (18)

(18) (Sunen ibn Maxbah, hadithi / 4209.)

12 - “Sadekaja më e mirë është që një person të fitojë dijen dhe t’ia mësoi atë vëllait të tij.” (19)

(19) (Sunen ibn Maxbah, kreu 20, hadithi / 243.)

13 - “Vërtet, All-llahu, melekët, milingona në follenë e saj dhe peshku në det luten për dijetarët e njerëzve.” (20)

(20) (Kenzul Ummal, hadithi / 28736.)

14 - “Shikimi në fytyrën e dijetarit është ibadet (adhurim).” (21)

(21) (Biharul Anuar, vëll. 1, kapituli i dijes.)

15 - “Vdjekja e dijetarit është çarje në Islam, që nuk mbyllet gjatë gjithë jetës.” (22)

(22) (Kenzul Ummal, hadithi / 28761.)

Vlera e studiuesit dhe e kërkuesit të diturisë në hadithet e Profetit Muhammed (s.a.u.s.)

Profeti Muhammed (s.a. u. s.) ka thënë:

1 - “Kërkimi i diturisë është detyrë e çdo myslimani.” (23)

(23) (*Sunen ibn Maxhab, vëll. 1, kreu 18 hadithi / 224.*)

2 - “Kërkojeni diturinë qoftë edhe në Kinë, sepse kërkimi i diturisë është detyrë e çdo myslimani.” (24)

(24) (*Biharul Anuar, vëll. 1, f. 180, kreu 1.*)

3 - “Atij që e kërkon diturinë dhe e përvetëson atë, All-llahu do t’a shpërblejë me dy të mira. Kush e kërkon diturinë por nuk arrin ta përvetësojë, All-llahu do t’a shpërblejë me një të mirë.” (25)

(25) (*Et Tergijb ue Et Terhijb, vëll. 1, f. 96.*)

4 - “Kërkuesi i diturisë mes të paditurve është njësoj si i gjalli mes të vdekurve.” (26)

(26) (*Kenzul Ummal, hadithi 28726.*)

5- “Kushdo që del për të kërkuar dijen, ai është në rrugën e All-llahut derisa të kthehet.” (27)

(27) (*Sunen Termidhij, hadithi 2647.*)

6- “Kushdo që do të shohë shpëtuesit e Zjarrit të shohë ata që mësojnë dijen, sepse betohem në Atë që shpirti im është në dorën e Tij se për atë nxënës që hedh hapat për të shkuar në derën e dijetarit, All-llahu do t’a shpërblejë njësoj sikur të ketë bërë adhurim një vit dhe për çdo hap do t’i ndërtojë atij një qytet në Xhennet. Kur ecën, edhe toka kërkon falje për atë. Ngryset dhe zgjohet i falur...” (28)

(28) (*Tefsir Fabrudin Rraziu, vëll. 2, f. 180.*)

7- “Kushdo që kërkon dijen është njësoj si ai që agjëron ditën dhe falet natën. Një kapitull dijeje që mëson një njeri është më e mirë për të se sa që të jetë Ebu Kubejs (kodwr nw Mekw) flori dhe e shpenzon në rrugën e All-llahut.” (29)

(29) (*Tefsir Fabrudin Rraziu, vëll. 2, f. 180.*)

8- “Nëse kërkuesin e diturisë e merr vdekja në këtë gjendje (duke kërkuar diturinë), ai vdes shetid (dëshmor).” (30)

(30) (*Et Tergijb ue Et Terhijb, vëll. 1, f. 96.*)

9 - “Mes atij që kërkon (studion) një kapitull të diturisë dhe ka qëllim që me anë të saj të ringjallë islamin mes tij dhe të dërguarve do të ketë një shkallë.” (31)

(31) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28833.*)

10 - “Melekët u shtrojnë krahët e tyre kërkuesve të diturisë nga kënaqësia për atë që ai kërkon (dijen).” (32)

(32) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28720.*)

11- “Kushdo që përshkon një rrugë për të kërkuar dije, All-llahu do ta udhëzojë atë në një prej rrugëve të Xhennetit.” (33)

(33) (*Kenzul Ummal, hadithi 28720*)

12- “Në jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: “Një ditë, Profeti (s.a.u.s.) hyri në xhami dhe pa dy lagje myslimanësh. Njëra lagje ishin të zhytur në përmendjen dhe adhurimin e All-llahut (xh.sh.), ndërsa lagja tjetër po studionin. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) tha: “Të dy grupet po bëjnë vepër të mirë, sepse të parët i luten All-llahut (xh.sh.), ndërsa grupi tjetër po mësojnë atë që nuk dinë nga çështjet e fesë. Këta të fundit janë më të mirët, sepse edhe unë për diturinë u dërgova.” (34)

(34) (*Sunen ibn Maxhab, hadithi 229, Kenzul Ummal, hadithi / 28701 dhe hadithi / 28873, me ndryshim në frazë.*)

Nga këto hadithe kuptojmë më së miri rëndësinë e diturisë në këtë jetë dhe ndikimet e saj në Ahiret. Vërtet, përparimi e qytetërimi që korrën myslimanët dhe shoqëria islame e kanë burimin te ky burim i madh e i pashtershëm i dijeve. Sheriati Islam dëshmon se dituria është bashkëshoqëruese e islamit e besimit, sepse shoqëria islame ka nevojë për dy sy; njëri është “dituria” dhe tjetri “besimi.”

Përmbledhje

Dija dhe njohja kanë pozitë të lartë në Islam. E para që iu shpall profetit tonë, Hazreti Muhammedit (s.a.u.s.) ishte përmendja e mirësisë së dijes. Kur’ani dhe hadithet e bekuara i lavdërojnë dijetarët dhe nxisin në kërkimin e dijes.

Pyetje

- 1- Përmendni ajetet e bekuara që flasin për pozitën e dijetarëve.
- 2- Çfarë thonë hadithet e nderuara për pozitën e dijetarëve? Përmendni një hadith.
- 3- Cilët janë të shpëtuarit në Ditën e Gjykimit? Argumetoheni me hadith të Profetit (s.a.u.s.)
- 4- Përmendni një hadith që flet për pozitën e dijetarit në krahasim me pozitën e adhuruesit.
- 5- Çfarë roli luan dija në formimin e shoqërisë islame?

MËSIMI 2

POZITA E DIJES DHE E DIJETARËVE NË ISLAM (2)

Vlera e dijes dhe e dijetarëve në hadithet e Ehli Bejtit (a.s.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë:

1- **“O njerëz! Dijeni mirë se përsosuria e fesë është kërkimi i diturisë dhe zbatimi i saj. Dijeni se kërimi i diturisë është mw i detyrueshëm sesa kërkimi i pasurisë, sepse pasuria është e caktuar dhe e siguruar për ju. Vërtet, i Drejti (All-llahu xh.sh.) e ka ndarë pasurinë mes jush, jua ka siguruar atë qw do t’ua japë juve. Ndërsa dituria është tek dijetarët dhe ju jeni të urdhëruar ta merrni diturinë prej dijetarëve, prandaj merreni atë.”**(35)

(35) (El-Kafij, vëll.1, f.30.)

2- Dhe: **“Dija është shtatë herë më e përsosur se sa pasuria:**

Së pari: Dituria është trashëgimi e profetëve, kurse pasuria është trashëgimi e faraonëve.

Së dyti: Dituria nuk pakësohet kur e jep, ndërsa pasuria pakësohet.

Së treti: Pasuria ka nevojë për ruajtës, ndërsa dituria e mbron mbartësin e saj.

Së katërti: Dituria hyn në qefin, ndërsa pasuria qëndron.

Së pesti: Pasuria i jepet edhe besimtarit dhe jobesimtarit, por dija e vwrтетw i jepet vetëm besimtarit.

Së gjashti: Të gjithë njerëzit kanë nevojë për dijetarin në çështjet e fesë dhe nuk kanë nevojë për të pasurin.

Së shtati: Dituria e forcon mbartësin e saj kur të kalojë Siratin, ndërsa pasuria e pengon.” (36)

(36) (Biharul Anuar, vëll. 1, f.185.)

3- Dhe: **“Kreu i të mirave është dituria dhe qëllimi i moraleve është dituria.”** (37)

(37) (Gurerul Hikem: f. 41, 16.)

4- Dhe: **“Dija është trashëgimi fisnike.”** (38)

(38) (Nehxhul Belaga, urtësia 5.)

5- Dhe: **“Dituria është mburojë ndaj të këqijave.”** (39)

(39) (Gurerul Hikem, f. 64, 794.)

6- Dhe: **“Dituria është e humbura e besimtarit.”**(40)

(40) (Biharul Anuar, vëll. 1, f.167, kreu 1.)

Imam Zejnul Abidine (a.s.) ka thënë: **“Sikur ta dinë njerëzit se çfarë të mirash ka kur kërkon diturinë, do ta kërkonin edhe sikur të ketë gjakderdhje dhe zhytje në thellësi të detërave. All-llahu (xh.sh.) e**

frymëzoi Danialin duke i thënë; Robi më i pikëlluar tek Unë do të jetë ai që nuk i respekton dijetarët dhe që nuk i pason ata. Dhe, robi më i dashur tek Unë do të i devotshmi, kërkuesi i shpërblimit, respektuesi i dijetarëve, ndjekësi i të urtëve dhe përfituesi prej të urtëve.” (41)

(41) (*Usulul Kafij, vëll. 1, f. 35.*)

Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: “Ai që mëson një kapitull dijeje, do të shpërblehet njësoj si ai që e zbaton dijen dhe atyre nuk u pakësohet asgjë nga shpërblimi. Ai që mëson një dije që e çon në humbje mëkati i tij është njësoj si ai që e bën atë mëkat dhe nuk u pakësohet asgjë nga mëkatet e tyre.” (42)

(42) (*Usulul Kafij, vëll. 1, f. 35.*)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: “Shpërblimi i atij që mëson një dije është njësoj me shpërblimin e atij që studion. Prandaj, mësojeni dijen prej bartësve të saj dhe mësoni vëllezërit tuaj ashtu siç jua mësuat ju dijetarët.” (43)

(43) (*Usulul Kafij, vëll. 1, f. 35.*)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: “Ai që mëson një të mirë, do të shpërblehet njësoj si ai që e bën një të mirë.” Shoku i tij, Ebu Basiri e pyeti: “Po nëse këtë të mirë ua mëson të tjerëve a do të shpërblehet?” Ai tha: “Po.” Ebu Basiri i tha: “Po kur të vdesë?” Imami i tha: “Po, edhe nëse vdes.” (44)

(44) (*Usulul Kafij, vëll. 1, f. 35.*)

Dhe: “Cilido që e mëson dijen dhe e zbaton atë dhe ua jep të tjerëve për hir të All-llahut (xh.sh.), ai do të jetë i nderuar tek banorët e qiellit dhe për të do të thuhet: “Ai ka qenë nga ata që e kanë studiuar dijen për hir të All-llahut, e ka zbatuar për hir të Alla-llahut dhe ua ka dhënë të tjerëve për hir të All-llahut.” (45)

(45) (*Usulul Kafij, vëll. 1, f. 35.*)

Përsosuria e dijetarit në krahasim me përsosurnë e adhuruesit

Edhe për këtë temë flasin disa hadithe. Ndër to përmendim:

Pofeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “Dija është më e përsosur se adhurimi.” (46)

(46) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 2857.*)

Dhe: “Cilido që del për të kërkuar një kapitull të dijes ku me të cilën kërkon që të largojë të pavërtetën nga e vërteta, ose kërkon të zëvendësojë humbjen me udhëzimin, është njësoj me atë person i cili falet dyzet vjet.” (47)

(47) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28835.*)

Dhe: “Të fjeturit me dituri është më i përsosur se të falurit me padituri.” (48)

(48) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28711.*)

Dhe: “Kërkimi i ditorisë është më i përsosur tek All-llahu sesa namazi, agjërimi, haxhi dhe xhihadi në rrugën e Tij.” (49)

(49) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28755.*)

Dhe: **“Përsosuria e dijetarit në krahasim me adhuruesin është si përsosuria e hënës mbi yjet e tjerë në Natën e Bedrit (kur ajo plotësohet).” (50)**

(50) *(Biharul Anuar, vëll. 1, f.124, kreu 4.)*

Dhe: **“Një fakih (jurist) është më i ashpër ndaj shejtanit sesa një mijë adhurues.” (51)**

(51) *(Ihjaul Ulumi Dijn (Ringjallja e dijeve fetare) e Gazaliut, kreu i diturisë.)*

Dhe: **“Një rekat që bën i vetëdijshmi për All-llahun është më i mirë se një mijë rekate që bën i pavetëdijshmi për All-llahun.” (52)**

(52) *(Kenzul Ummal, hadithi/ 28786.)*

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Një fjalë prej urtësisë, që një njeri e dëgjon e më pas e transmeton dhe e zbaton atë është më e mirë se një vit adhurim.” (53)**

(53) *(Biharul Anuar, vëll. 1, f.183, kreu 93.)*

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Të kujtuarit një orë e diturisë është më e mirë se të falurit natën.” (54)**

(54) *(Biharul Anuar, vëll. 1, f. 204, kreu 4.)*

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Dijetari, prej të cilit fitohet dituri është më i mirë se adhurimi i një mijë adhuruesve.” (55)**

(55) *(Biharul Anuar, vëll. 2, f.18, kreu 8.)*

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Dijetari është më i përsosur se një mijë adhurues dhe një mijë zahid (asketikë).” (56)**

(56) *(Biharul Anuar, vëll. 2, f.19, kreu 9.)*

Qëllimi i kërkimit të diturisë

Në këtë mësim dhe në mësimin e shkuar paraqitëm disa hadithe të Profetit (s.a.u.s.) dhe të Ehli Bejtut (a.s.), të cilat sqarojnë pozitën e dijes dhe denjësinë e dijetarëve. Është e domosdoshme që të dimë se cila është ajo dituri që e meriton këtë pozitë dhe cilët janë ata dijetarë që kënaqen me këtë titull?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje mund të thuhet: të gjitha dijet janë të rëndësishme dhe rëndësia e tyre varet nga dobitë që çdo dije i sjell shoqërisë dhe nga përmbushja e interesave të saj. Prandaj mësimi i të gjitha fushave të dijes është uaxhib kifaji *(nëse dikush e vepron, bie detyra për ta kryer të tjerët)* në Sheriatin islam. Mirëpo hadithet lavdërojnë dhe respektojnë më shumë dijet fetare dhe dijetarët e fesë. Ndër këto hadithe përmendim:

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vdekja e dijetarit shkakton një çarje (vrimë) në Islam, e cila nuk mbyllet deri në mbarim të kësaj jete.” (57)**

(57) *(Kenzul Ummal, hadithi/ 28761)*

Dhe: **“Betohem në Atë, nw dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit se një dijetar i vetëm është më i fortë mbi shejtanin sesa një mijë adhurues, sepse adhuruesi e kryen adhurimin për veten e tij, ndërsa dijetari e mëson diturinë për të tjerët.” (58)**

(58) *(Kenzul Ummal, hadithi/ 28908)*

Dhe: Historia thotë se një ditë, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) hyri në xhami dhe vuri re që disa njerëz u grumbulluan rreth një personi. Profeti (s.a.u.s.) pyeti: **“Kush është ky burrë?”** i thanë: **“Është i ditur.”** Profeti tha: **“Për çfarë është i ditur?”** “I thanë: **“Është më i dituri i njerëzve për gjenezat e arabëve, për kohën e Xhahilijetit dhe për poezitë e tyre.”** Profeti u përgjigj: **“Kjo dituri e tij as e dëmton atë që nuk e di e as që fiton ai që e mëson atë.”** Pastaj tha: **“Dijet janë tre: Ajet i qartw e i zbatueshw, dispozitw e drejtw dhe traditw e praktikueshme. Të tjerat përveç këtyre janë tepricë.”** (59)

(59) (El-Kafj, vëll.1, f. 32, hadithi 1.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarët e të dërguarve. Sigurisht, të dërguarit nuk kanë lënë pas as dinarë e as dërrhem, por ata kanë lënë trashëgimi hadithet e tyre. Ai që përfiton prej atyre haditheve ka fituar mirësi të mëdha. Prandaj, shikojini punët tuaja se ku mbështeteni kur i kryeni ato...”** (60)

(60) (Kenzul Ummal, vëll. 1 kreu, mirësia e dijes.)

Pra, nga të gjitha dijet, dijet e fesë kanë një pozitë të veçantë, sepse sjellin dobi të shumta për shoqëritë njerëzore. Sa më shumë të përhapen dijet e fesë, aq më shumë është e mbrojtur feja nga shmangiet e devijuesve dhe nga dëshirat dashakeqëse.

Përmbledhje

Hadithet e Profetit dhe të Ehli Bejtit (a.s.) sqarojnë pozitën e dijes dhe denjësinë e dijetarëve. Ato i ftojnë myslimanët të kërkojnë dijen dhe i nxisin për këtë. Ato thonë se kërkimi i diturisë është më e detyrueshme se sa kërkimi i pasurisë.

Sheriati islam e konsideron dijen më të përsosur sesa adhurimi dhe dijetarin më të përsosur sesa adhuruesi.

Islami i jep më shumë pëparësi kërkimit të dijeve fetare, sepse në këto dije ka mirësi të shumta për mbarë shoqëritë njerëzore.

Pyetje

- 1- Përse Imam Aliu (a.s.) e quan kërkimin e diturisë më të domosdoshme se kërkimi i pasurisë?
- 2- Cilat janë ndryshimet më kryesore mes dijes dhe pasurisë? Sqarojeni këtë duke u mbështetur në hadithin e permendur nga Imam Aliu (a.s.)
- 3- Përse dijetari konsiderohet më i përsosur se adhuruesi? Sqarojeni këtë duke u mbështetur në hadithet e dy mësimëve të mëparshme.
- 4- A kanë të gjitha fushat e dijes vlerë të njëjtë? Cili është matësi i shkallës së rëndësisë?

MËSIMI 3

RREGULLAT DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT (1)

Në mësimet e shkuara u njohëm me pozitën e dijes dhe mirësinë e saj. Në këtë mësim do të njihemi me rregullat islame rreth mësimit dhe mësimdhënien.

Dijetari i shquar islam, Shehidu Thanij (dëshmorit i dytë) i ka ndarë këto rregulla në tri pjesë:

- 1- Detyrat e përbashkëta mes pedagogut dhe studentit ose mes mësuesit dhe nxënësit.
- 2- Detyrat e veçanta për mësuesin dhe pedagogun.
- 3- Detyrat e veçanta për studentin dhe nxënësin.

Këto rregulla të ndara sipas mendimit të dëshmorit të dytë po i sqarojmë si vijon.

Detyrat e përbashkëta

Duhet që mësuesi dhe nxënësi të kujdesen për:

1- Çiltërsia e nijetit

Islami i porositi të gjithë besimtarët që të jenë të çiltër në nijetet e tyre për çdo punë që bëjnë. Pra, qëllimet e tyre të jenë për All-llahun (xh.sh.), sepse shpërblimi dhe përhershmeria e punëve arrihen me qëllimin e çiltër. Po ashtu, edhe vlera e punës është te qëllimi: nëse qëllimi është për All-llahun (xh.sh.) puna e tij do të jetë e shpërblyer dhe e qëndrueshme. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, kurse ajo që është te All-llahu është e përjetshme. E, Ne do t’ua japim shpërblimin më të mirë për atë që vepruan, atyre që ishin të durueshëm.” (61)**

(61) (Sure “En Nabl”, ajeti 96.)

Kuptimi i çiltërsisë në qëllim do të thotë që njeriu mos shpresojë gjë tjetër kur bën ndonjë punë me përjashtim të kënaqësisë së All-llahut (xh.sh.) dhe mos të shohë qëllim tjetër. Kjo përshkak se çdo gjë lëviz drejt zhdukjes me përjashtim të All-llahut (xh.sh.). Ai që punon jo për All-llahun, ai njeri do të jetë prej të humburëve.

Kur’ani thotë: **Thuaje: “A t’ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?” Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë.” (62)**

(62) (Sure “El Kehf, ajetet”, 103-104.)

Dhe: **“All-llahu është shumë bamirës për robërit e vet; Ai e begaton atë që do; Ai është i gjithëfuqishmi, ngadhënjyesi.”** (63)

(63) (*Sure “Esh Shura”, ajeti 19.*)

Dhe: **“E kush e ka për qëllim botën tjetër, duke qenë ai besimtar, përpiket për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (te Zoti)”** (64)

(64) (*Sure “El Isra”, ajeti 19.*)

Profeti Muhammed (s.a.u.s) ka thënë: **“Sigurisht, punët varen nga nijeti (qëllimi) dhe shpërblimi a ndëshkimi i njeriut sipas nijetit të tij. Imgrimi i atij që del për All-llahun dhe të dërguarin...”** (65)

(65) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 7272 dhe Munijetul Murijid, f. 84.*)

Sipas kësaj thënie arritja e qëllimit të çiltërt është atëherë kur bazohet te kënaqësia e All-llahut (xh.sh.) dhe e profetit Muhammed (s.a.u.s.) në çdo punë që bëjmë, përfshi këtu edhe mësimin dhe të mësuarit. Për këtë Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nijeti i besimtarit është më i mirë se puna e tij.”**

Rrugët e arritjes së singëritetit në nijet

Që të arrihet singëriteti në nijet duhet që të pastrohet shpirti prej papastërtive që do të thotë që në zemër mos gjindet asgjë tjetër përveç besimit në All-llahun (xh.sh.) dhe adhurimi të jetë i singertë vetëm për Atë. All-llahu (xh.sh) në Kur'an thotë: **“Ne ta shpallëm ty librin për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje All-llahun duke qenë i singertë në adhurimin e Tij! Vini re! Adhurim i singertë është vetëm ai për All-llahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër All-llahut, s'ka dyshim se All-llahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë se All-llahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është rrenës, jobesimtar.”** (66)

(66) (*Sure “Ez Zumer”, ajetet 2, 3.*)

Dhe: **“Dhe ata të cilëve u është dhënë libri, nuk u ndanë vetëm pasi që u erdhi argumenti.”** (67)

(67) (*Sure “El Bejjine”, ajeti 4.*)

Po ashtu singëriteti në qëllime, është prej kushteve të afrimit te All-llahu (xh.sh.) dhe kjo pas njësisshmërisë së Tij (teuhidit). All-llahu (xh.sh.) thotë: **Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd.”** (68)

(68) (*Sure “El Kehf”, ajeti 110.*)

S'ka dyshim se singëriteti në qëllim përcakton vlerën e çdo pune. Nga këtu kuptojmë se nëse nijeti nuk është për All-llahun kjo e çon njeriun në shkatërrim.

Profeti Muhammed (s.a.u.s) ka thënë: **“Për cilido që e mëson një dije dhe me këtë dije nuk kërkon afrim tek All-llahu por, këtë dije ua mëson të tjerëve për të fituar këtë jetë, ai nuk do ta ndiejë erën e Xhennetit në Ditën e Gjykimit.”** (69)

(69) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 29020 dhe Munijetul Murijd, f. 134.*)

Dhe: **“Për cilindo që e mëson një dije jo për All-llahun dhe me këtë dije nuk kërkon afrim tek All-llahu, vendi i tij do të jetë në Zjarr.”** (70)

(70) (*Sunenu Termidhiu, vëll. 5, libri i dijes, kreu 6.*)

Dhe: **“Cilido që kërkon një dije dhe me anë të saj kërkon debat me dijetarët, mendjelehtët dhe me anë të saj kërkon të largojë njerëzit nga e vërteta, All-llahu do ta fusë në Zjarr.”** (71)

(71) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 29036.*)

Dhe: **“Mos e mësoni dijen që me anë të saj të debatoni me mendjelehtët, të debatoni dijetarët dhe të largoni me të njerëzit prej jush. Falënderojini me fjalët tuaja ato që ka All-llahu, sepse ato janë të përhershme e të qëndrueshme dhe çdo gjë tjetër zhduket. Bëhuni burim i urtësisë, fenerë ndriçues për udhëzim, bujar për familjet, pishtarë në errësira, ringjallës të zemrave, vishuni me morale të mira që të njiheni te banorët e Qiellit e të jeni të padukshëm te banorët e Tokës.”** (72)

(72) (*Sunenu Ed Darimij, vëll. 1 dhe Munijetul Murijd, f. 135.*)

Dhe: **“Ai që e mëson dijen për katër gjëra do të hyjë në Zjarr: për tu dukur tek dijetarët, për të debatuar mendjelehtët, të largojë njerëzit prej tij dhe të marrë pozitë tek prijësit.”** (73)

(73) (*Sunenu Ed Darimij, vëll. 1 dhe Munijetul Murijd, f. 135.*)

Në një hadith të profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“Sa herë që rob i shton dijen shtohet dëshira e tij për këtë jetë dhe shtohet largimi nga All-llahu.”** (74)

(74) (*Sunenu Ed Darimij, vëll. 1 dhe Munijetul Murijd, f. 135.*)

Imam Aliu (a. s.) transmeton se profeti Muhamed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Dy njerëz nuk ngopen; kërkuesi i dynjasë dhe kërkuesi i dijes. Ai që merr nga kjo dynja ato që All-llahu i ka bërë të lejuara, është i mbrojtur. Ai që merr ato që nuk janë të lejuara është, i mbaruar, vetëm nëse pendohet dhe kthehet në ato që All-llahu i ka lejuar. Ai që e merr dijen prej merituesve të saj ai, është i shpëtuar. Dhe ai që me anë të dijes do këtë jetë, ajo do të jetë pjesa e tij.”** (75)

(75) (*El Kafij, vëll. 1, f. 46.*)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Nëse shikoni dijetarin dëshirues së kësaj jete, akuzojeni atë ndaj fesë tuaj, sepse çdo njeri që do diçka është i rrethuar me atë që do.”**

Dhe: All-llahu (xh.sh.) i tha Daudit (a.s.): **“Mos vendos mes meje dhe mes teje një dijetar i cili e pëlqen këtë dynja, sepse të largon nga rruga e dashurisë time.”** (76)

(76) (*El Kafij: vëll. 1 fq. 46.*)

Ai ka transmetuar edhe thënien e profetit (s.a.u.s.): **“Fukahatë (dijetarwt) janë besnikët e të dërguarëve nëse nuk pasojnë këtë dynja.”** i thanë: **“O i Dërguari i All-lahut, si e pasojnë ata këtë dynja?”** Ai tha: **“Duke ndjekur sultanin. Nëse veprojnë kështu, kini kujdes prej tyre për fenë tuaj!”** (77)

(77) (El Kafj, vëll. 1 f. 46.)

Nga këtu kuptojmë se kushti i parë për të fituar dijen është që të bëhet për të fituar kënaqësinë e All-lahut (xh.sh.) dhe kjo dije të jetë për ta njohur Atë. Në këtë mënyrë All-llahu na bekon në këtë jetë dhe mëshira e Tij na përfshin edhe në Ahiret.

Përmbledhje

S’ka dyshim se arritja e kënaqësisë së All-lahut është nijeti i çdo njeriu mysliman në punët e tij. Për këtë duhet që mësuesi dhe nxënësi, ta kenë gjithmonë parasysh këtë nijet, sepse baza e pranimi të punëve është qëllimi i sinqeritetit.

Pyetje

- 1- Cilët janë të humburit në këtë jetë? Argumentojeni me ajet Kur’ani.
- 2- Si mund të arrihet sinqeriteti në nijet?
- 3- Cili është ai qëllim për të cilin Profeti na thotë që të jemi të kujdesshëm ndaj tij kur kërkojmë dijen?
- 4- Sipas Imam Sadikut, cilët janë ato lloje dijetarësh ndaj të cilëve duhet të jemi të kujdesshëm?
- 5- Cilët dijetarë janë besnikët e të dërguarve? Përmendni një tekst nga hadithi i Profetit (s.a.u.s.)

Mësimi i katërt

ETIKAT DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Në mësimin e kaluar u njohëm me detyrën e parë të përbashkët mes mësuesit dhe nxënësit dhe kjo detyrë ishte sinjeriteti në njëjtë. Në këtë mësim do të flasim për një tjetër detyrë të përbashkët dhe kjo është:

Dija dhe puna

Prej detyrave të mësuesit dhe nxënësit është puna, sepse kërkimi i dijes dhe mësimi i njerëzve nuk janë qëllim në vetvete; por qëllimi është puna dhe sjellja e mirë. Jeta e njeriut nuk është tjetër veçse përvoja e tij praktike. Për këtë duhet që puna të shoqërohet me dije, sepse ai që punon pa dije është i humbur.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, vepruesi pa dije është si ai që nuk ecën në rrugën e duhur e largësia e kësaj rruge nuk i sjell asgjë atij përveçse e largon nga nevojat e tij. Vepruesi me dije është si ai që ecën në rrugë të qartë. Kur e sheh dikush, thotë ai është duke ecur përpara apo po kthehet pas.”** (78)

(78) *(Nebxhul Belaga, fjalimi 154.)*

Imami kërkon prej nesh që të punojmë me vetëdije dhe të vazhdojmë jetën tonë në përputhje me mënyrën e cila mbron dhe forcon hapat tona dhe lëvizjet tona, sepse të ecja në rrugë jo të qartë do të thotë humbje. Prandaj, është detyrë e çdo njeriu që t'i kuptojë mirë lëvizjet e tij dhe të përcaktojë për çfarë synimi po ecën.

Të njëjtë me këtë kuptim kemi hadithin nga Imam Sadiku (a.s.): **“Vepruesi pa dije është si ai që ecën në rrugë të paqartë. Shpejtësia e ecjes në këtë rrugë i sjell veçse largim.”** (79)

(79) *(Biharul Anuar, vëll. 1, f. 206, kapitulli 5.)*

Po ashtu edhe hadithi i transmetuar nga zotëria jonë profeti Muhammed (s.a.u.s.), i cili ka thënë: **“Adhuresi i cili nuk mëton është si ndërtuesi që natën ndërton ndërtesën dhe ditën (ndërtesa) shembet.”** (80)

(80) *(Kenzul Ummal, vëll. 10, f. 179, hadithi 2893.)*

Në këtë hadith të Profetit (s.a.u.s.) gjendet ilustrim më i thellë për atë njeri i cili e kalon natën e tij me adhurim dhe sapo të zbardhë mëngjesi vepron pa u menduar, e pa u mbështetur në dije e mendim dhe më pas bën mëkate, të cilat e asgjësojnë atë shpërblim që e fitoi me adhurim gjatë natës.

Veprimet e paditura të njeriut janë pa qëllim dhe të zbrazëta nga kuptimi.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Adhuresi i paditur është si gomari i mullirit, i cili rrotullohet por nuk ikën nga vendi i tij.”** (81)

(81) *(Kenzul Ummal, vëll. 10, f. 208.)*

Të gjitha përpjekjet e një njeriu të tillë janë të pavlera dhe ky njeri kurrë nuk do të përparojë në jetë dhe nuk do të arrijë përsosurinë, sepse veprim dhe çdo lëvizje që bën nuk janë të bazuara në dituri e cila i ndriçon atij jetën dhe e udhëzon në rrugën e drejtë.

Ky person është njëloj me atë njeri, i cili e agjëron dhe nuk i di rregullat e agjërimit dhe bën gabime, të cilat e bëjnë të pavlefshëm agjërimin e tij. Së fundi, nga agjërimi nuk ndien asgjë tjetër përveç urisë e etjes. Për këtë, Imam Aliu (a.s.) e ngjason njeriun e paditur me gomarin e mullirit që ecën e ecën, mirëpo, në të vërtetë nuk ikën dot nga vendi dhe kur përfundon punë dërgohet i lodhur e i rraskapitur në kasolle.

Nga këtu kuptohet që puna e mirë domosdo duhet të jetë e mbështetur në dije (këtu është fjala për dijen dobiprurëse për këtë jetë dhe për Jetën tjetër.) Lidhur me këtë duhet patur parasysh:

Së pari: Të mënjanohej dijet të cilat nuk kanë dobi në jetë. Në një lutje të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“O Zot! Më mbro prej dijes, e cila nuk sjell dobi, prej zemrës, e cila nuk frikësohet, prej lutjes, e cila nuk dëgjohet dhe prej vetes, e cila nuk ngopet...”** (82)

(82) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 3609.*)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Dija që nuk sjell dobi, është si ilaçi që nuk shëron.”** (83)

(83) (*Gurerul Hikem, f. 191.*)

Nga kjo del se nuk është mirë që njeriu ta shpërdorojë kohën dhe moshën e tij duke kërkuar dije e më pas kjo dije të mos ndikojë në jetën e tij dhe të mos përfitojnë njerëzit prej saj.

Së dyti: Duhet që njeriu, pasi e merr dijen të punojë. Për ata që nuk punojnë Kur’ani Famëlartë thotë: **“Tek All-llahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e bëni.”** (84)

(84) (*Sure “Es Saf”, ajeti 3.*)

Kur’ani i ngjason disa dijetarë jahudinj me gomerët, që mbajnë libra mbi kurriz: **“Shembulli i atyre që janë obliguar me Teurat, dhe nuk e zbatojnë atë, është si shembulli i një gomari që bart libra. Shembull i keq është shembulli i popullit që i përgënjeshtroi ajetet e All-llahut e All-llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar.”** (85)

(85) (*Sure “El Xhumua”, ajeti 5.*)

Imam Aliu transmeton se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Dijetarët janë dy grupesh: dijetarë të cilët e zbatojnë dijen e tyre dhe këta janë të shpëtuar dhe dijetarë të cilët nuk e zbatojnë dijen e tyre këta janë të mbaruar. Vërtet, edhe banorët e Zjarrit do të pështirosen prej erës së dijetarëve të cilët nuk e zbatojnë dijen e tyre. Nga më të penduarit prej banorëve të Zjarrit do të jetë ai njeri, i cili fton një tjetër në rrugën e All-llahut dhe ky e pranoi dhe e adhuroi All-llahun dhe All-llahu do ta fusë në Xhennet; ndërsa ftuesi hyn në Zjarr përshkak sepse nuk e ka zbatuar dijen dhe ka ndjekur unin dhe shpresën e gjatë. Ndjekja e unit të largon nga e vërteta, ndërsa shpresa e gjatë e harron Ahiretit.”** (86)

(86) (El Kafij, vëll. 1, kapitulli i dijes.)

Në një hadith tjetër Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **“Sigurisht, dijetar është ai që punon me dije, edhe nëse ka pak dituri.”** (87)

(87) (Biharul Anuar, vëll.76, kapitulli 67.)

Pra, etaloni i dijetarit është puna që mbështetet në atë dije që zotëron.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nuk ka mësuar (nuk është dijetar) ai që nuk punon me dijen që ka.”** (88)

(88) (Gurerul Hikem, f. 153.)

Transmetohet nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.) se Isai i biri i Merjemes (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të dy) ka thënë: **“Nuk është në dobinë tënde të mësosh atë që nuk e punon.”** (89)

(89) (Mizanul Hikmeti, kapitulli, 2888.)

Vërtet, dija e shumë, nëse nuk veprohet sipas saj, shton veçse padituri.

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Njeriu që do të ketë dënim më të rëndë është dijetari nga dija e të cilit nuk përfitohet.”** (90)

(Biharul Anuar, vëll. 2, f.37.)

Dhe: **“Pa dyshim, këshillat e dijetarit që nuk punon sipas dijes që zotëron, largohen nga zemrat njësoj si largohet shiu nga guri i lëmuar.”**

(90) (El Kafij, vëll.1, f. 44.)

Kur Imam Aliu po fliste në mimber, tha: **“O njerëz, nëse mësoni, punoni sipas asaj që keni mësuar! Vërtet, dijetari që nuk punon sipas dijes që ka, është si i padituri dhe i çoroditur, i cili nuk zgjohet nga padituria e tij. Për këtë dijetar të zhveshur nga dija, mendoj se argumenti mbi të është më i madh dhe fatkeqësia është e vazhdueshme, se sa i padituri i çoroditur në paditurinë e tij. Që të dy janë të çoroditur e të fjetur. Mos dyshoni se do të ankoheni, mos u ankoni se do të mohoni, mos i nënçmoni vetat tuaja se do të jeni mashtrues në drejtësi e do të humbisni. Prej drejtësisë është që të studioni dhe prej studimit është të mos mashtroheni...”** (91)

(91) (El Kafij; vëll.1, f.45.)

Muffadal ibn Umer e ka pyetur Imam Sadikun (a.s.) për shenjat e shpëtimtarëve nga Zjarri në Ditën e Gjykimit dhe Imami është përgjigjur: **“Atij, puna e të cilit përputhet me thënien e tij, pranoja dëshminë. Ndërsa puna e atij që nuk përputhet me thënien e tij, është musteudaa.”** (92)

(92) (El Kafij, vëll. 1, f. 45.)

Përmbledhja e thënieve: Hadithet e nderuara e shoqërojnë dijen me punë. Nuk ka dije pa punë, po ashtu nuk ka punë pa dije. Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“Vërtet, dija thërret për punë nëse e zbaton qëndron dhe nëse nuk e zbaton ikën prej tij.”** (93)

(93) (Biharul Anuar, vëll.2, f.33.)

Transmetohet se Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Dija është e shoqëruar me punën. Ai që di punon dhe dija thërret për punë. Nëse e zbaton atë, përndryshe largohet prej tij.”** (94)

(94) (Biharul Anuar, vëll. 2, f.37.)

Vetëm puna është garanci për vazhdimësinë e dijes, përndryshe dija do të përballet me harresën dhe zhdukjen.

Përmbledhje

Islami nuk e quan dijen qëllim në vetvete dhe dija e fiton vlerën saj me dobinë e saj në jetën e njerëzve. Nga këtu, islami fton të largohemi prej atyre dijeve që nuk luajnë rol në ndërtimin e jetës së njerëzve. Edhe hadithet islame e vërtetojnë se puna, e cila pa dije e kuptim, e çon njeriun në çoroditje e në humbje.

Pyetje

- 1- Si e përfytyrojnë hadithet e Profetit Muhammed (s.a.u.s) adhuruesin e paditur?
- 2- Si e shembullson Imam Aliu (a.s.) atë njeri që nuk punon me dije?
- 3- Përmendni ajete nga Kur'ani që flasin për ata që nuk kanë dije.
- 4- Cili është përfundimi në Ahiret i dijetarit që nuk punon? Përmendni një hadith.
- 5- Cilët janë shpëtuesit prej Zjarrit në Ditën e Gjykimit? Përmendni hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (a.s.) që flet për këtë.

Mësimi i 5^{-të}

ETIKA DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Në vazhdim të paraqitjes së etikave dhe të detyrave të përbashkëta, do të flasim për një detyrë të rëndësishme dhe kjo është:

Largimi prej mendjemadhësisë së dijes

Pasi mësuesi dhe nxënësi bëjnë nijetin e çiltër për All-llahun (xh.sh.) për ta kërkuar, përvetësuar dhe përhapur dijen dhe pasi të vendosin për të vepruar sipas dijes e të kuptuar në këtë jetë, vjen kujdesi prej mashtrimit të dijes.

Njeriu e do përsosurinë dhe përpiqet që të përparojë në jetën e tij. Është e natyrshme që ai ta ndienjë kënaqësinë e dijes, që të nxitet të përvetësojë sa më shumë prej saj për të arritur përsosurinë. Por, njeriu duhet ta kuptojë se përsosuria në dije është parapërgatitëse për të arritur përsosurinë e pakufizuar, e cila e bën të denjë të afrohet tek All-llahu (xh.sh.). Duke u mbështetur në këtë, duhet që përvetësimi i dijes dhe fitimi i moraleve të larta të bëhen për All-llahun, që të fitohet kënaqësia e Tij (xh.sh.). Ka raste që kërkimi i dijes e bën njeriun të harrojë qëllimin kryesor. Në këtë rast ai e kërkon dijen për interesa vetjake. Kështu, ai zhytet thellë e më thellë në detin e pafund të dijes dhe e harron detyrën kreysore dhe synimin parësor.

Në moralin islam thuhet se çdo gjë që pengon rrugën për tek All-llahu dhe e pengon njeriun të arrijë kënaqësinë e All-llahut, quhet “Hixhab.” Në këtë gjendje është i pamundur kërkimi i dijes, sepse gjinden angazhime të cilat e pengojnë atë në kërkimin e përsosurisë. Arsyet:

Së pari: Dija shton fuqitë e njeriut dhe sundimin e tij mbi natyrën.

Së dyti: Dija ndikon në anët e tjera të përsosurisë dhe mendjemadhësia vjen si pasojë e asaj që njeriu fitoi prej pozitës shkencore. Për këtë transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Dija është hixhabi (pegësë) më i madh.”**

E rëndësishme është që përvetësimi i dijeve të jetë portë për njohjen e vetvetes, të botës si dhe të qëllimit të ekzistencës, e më pas për njohjen e All-llahut (xh.sh.). Kjo njohje është e rregullt dhe rrugë për të edukuar vetëveten dhe për formimin e personalitetit. Nëse kërkimi e përvetësimi i dijes do të shndërrohet në gjendje mendjemadhësie, kur njeriu nuk njeh askënd tjetër përveç vetes së tij, atëherë do të goditet nga vetëpëlqimi e mendjemadhësia dhe interesi i tij do të jetë të fitojë sa më shumë dije që të mbërrijë në pozitën më të lartë mes njerëzve. Kjo e bën të largohet nga thjeshtësia ndaj njerëzve dhe nga frika ndaj All-llahut (xh.sh.). Në këtë rast dija bëhet shkak që njeriu të bjerë nga ana morale. Është detyrë që kërkuesit dhe përvetësuesit e dijes ta shfrytëzojnë dijen e tyre për të fituar vlera shpirtërore dhe dija të jetë faktor i pastrimit të shpirtërave, i zemrave dhe i ndërgjegjeve të tyre.

Mbështetja tek All-llahu (xh.sh.)

Është detyrë e të gjithë atyre që punojnë në fushën e dijes - nxënës, mësues, studiues, kërkues, hulumtues, etj që t'i mbështeten All-llahut (xh.sh.), të kenë besim në vetet e tyre dhe të mos i mbulojë ndjenja e paaftësisë dhe e dobësisë, sepse:

Së pari: Përvetësimi i dijes është i vështirë, ka lodhje e mundime që nuk mund të kalohen lehtë. Njeriu duhet të jetë i parapërgatitur dhe t'i mbështet All-llahut (xh.sh.) në këtë mision dhe duhet ta dijë mirë se fuqia dhe mbarësia e kanë burimin vetëm tek All-llahu Fuqplotë.

Së Dytë: Në të shumtën e rasteve, puna në fushën e dijes nuk mund t'i sigurojë gjërat më të domosdoshme të jetës. Në këtë mënyrë, mundet që tek disa njerëz të depërtojë ndjenja e zemërimit dhe e hidhërimit. Por, ata duhet ta dinë se All-llahu është sipërmarrësi i tyre në jetën e përditshme. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, All-llahu (xh.sh.) ka marrë përsipër riskun e kërkuesit të dijes, veçanërisht për ata që e përfitojnë dijen për të tjerët.” (95)**

(95) (*Kenzul Ummal, hadithi/ 28701 dhe Muninetul Murijd, f.160.*)

Së treti: Duhet që kërkuesi i dijes të këtë parasysh këtë të vërtetë: arritja e përsosurisë në dije nuk kufizohet vetëm me studim e përvetësim, edhe pse këto përbëjnë thelbin e misionit, dija është dritë të cilën All-llahu e hedh në zemrën e robve të mirë që Ai dëshiron.

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Dija nuk është vetëm me studim, por ajo është dritë që hidhet në zemrën e atij robi që All-llahu (xh.sh.) dëshiron ta udhëzojë.” (96)**

(96) (*Biharul Anuar, vëll. 1, f.224, kapitulli 7.*)

Devotshmëria

Më lart thamë se duhet pasur kujdes nga ndjenja e vetëpëlqimit në dije, e cila shpeshherë i josh kërkuesit dhe përvetësuesit e dijes. Mundet që njeriu të mashtrohet për arsye të pozitës në dije dhe goditet nga mendjemadhësia, e cila bëhet shkak dhe pengesë për të ndjekur rrugën e All-llahut dhe për të zbatuar porositë e Tij (xh.sh.). Prandaj, është detyrë e të gjithë atyre që i kanë hyrë rrugës së dijes që u japin dije të tjerëve, që të edukojnë vetat e tyre, të forcojnë shpirtin e besimit brenda vetes së tyre me qëllim që dija të jetë rruga e saktë për t'u afruar tek All-llahu fuqplotë.

Devotshmëria është një tjetër kusht për përvetësimin e dijeve, sepse All-llahu (xh.sh.) e ka bërë devotshmërinë kusht për udhëzimin, siç thotë në Kur'an: **“Ky është Libri në të cilin nuk gjendet dyshim, është udhëzues për të devotshmit.” (97)**

(97) (*Sure “El Bekare”, ajeti 2.*)

All-llahu (xh.sh.) u ka premtuar diturinë të devotshmëve, ku thotë: **“Bëhuni të devotshëm e All-llahu t'ju mësojë juve.” (98)**

(98) (*Sure “El Bekare”, ajeti 282.*)

Dhe: **“O ju që besuat, nëse keni frikë All-llahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t’ua mbulojë të këqijat, do t’ua falë mëkatet. All-llahu është dhurues i madh.”** (99)

(99) (Sure “El Enfal”, ajeti, 29.)

Nëse dija është dritë të cilën All-llahu (xh.sh.) e hedh në zemrën e atij që do, atëherë duhet që ne ta kërkojmë dijen prej Tij (xh.sh.). Mirëpo, ky kërkim nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm me dua (lutje), por të përpiqemi me devotshmëri, me pastërti, me çiltërsi dhe t’u themi jo përshpëritjeve të djallit. Kjo, sepse, nëse zemra është e pastër ajo do ta pranojë dritën e All-llahut; përndryshe nuk e pranon.

Djetarët duhet të jenë shembull për të tjerët. Është transmetuar se një eulia ka thënë: “Vërtet, njerëzit janë në pozitë më të ulët se dijetarët. Nëse dijetarët janë të kuptueshëm, të devotshëm, zuhadë (asketikë) në këtë jetë, njerëzit do të zbatojnë të lejueshmet e çështjeve së kësaj jetës. Nëse dijetarët hyjnë në të lejueshmet e njerëzve, nuk do të tregohet i kujdesshëm ndaj të dyshimtave. Nëse dijetarët bëjnë të dyshimtat, njerëzit do të veprojnë haramet (të ndaluarat). Nëse dijetarët do të veprojnë të ndaluarat, atëherë njerëzit do të bëhen jobesimtarë e mohues.

Morali i përsosur

S’ka dyshim se dijetarët janë shembull për të tjerët. Prandaj, është detyrë që ata të zbukurohen me morale të pëlqyera dhe cilësi positive.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kërkojeni dijen dhe zbukurojeni atë me butësinë dhe seriozitetin. Bëhuni të thjeshtë ndaj atyre që i mësoni dhe ndaj atyre që ju dhanë dijen. Mos u bëni dijetarë të ashpër, sepse pavërtetësia e juaj do t’ju largojë nga e vërteta.”** (100)

(100) (El kafij, vëll. 1 f. 36.)

Po për këtë gjë All-llahu (xh.sh.) i thotë të dërguarit të Tij: **“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.”** (101)

(101) (Sure “Ali Imran, ajeti 159.)

Ndershmëria dhe pastërtia

Që ta kryejnë detyrën e tyre ashtu siç duhet, dijetarët gjithmonë duhet të ndiejnë vetëm nevojën e All-llahut (xh.sh.) dhe të askujt tjetër. Të qënin i mjaftueshëm ndaj njerëzve (nga ana materiale) i jep dijetarit ndjenjën e krenarisë e të fisnikërisë. Nëse dijetari përballet me vështirësi materiale në jetën e tij, mos e shfaqë nevojën e tij para njerëzve, sepse nëse njerëzit do ta kuptojnë se ai është nevojtar do t’i zgjasin atij dorën e ndihmesës. Kur ta ndihmojnë, ata do t’i pushtojë ndjenja se kjo ndihmë është mirësi ndaj tij dhe se ata po ia sigurojnë kafshatën e gojës. Nëse ndodh kjo, atëherë dijetari nuk do të veprojë sipas qëllimit të tij kryesor në drejtim të shoqërisë, por do të përpiqet të kënaqë njerëzit dhe t’i përgjigjet dëshirave të tyre. Dijetari duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm se All-llahu (xh.sh.) është Sipërmarrësi i të gjithëve, në përgjithësi dhe i dijetarëve, në veçanti. Prandaj, nuk

është e pëlqyeshme për dijetarin që të hedhë sytë në ato që ndodhen në duart e njerëzve. Edhe më e shëmtuar është që dijetarët të qëndrojnë para dyerve të pushtetarëve që atyre t'u sigurohet një post t'u jepet pasuri. Nëse ata veprojnë në këtë mënyrë, do t'ua kthejnë shpinën njerëzve dhe do ta shesin fenë e tyre për interesat e kësaj jete, për interesat e pushtetarëve, prijësve e udhëheqësve dhe All-llahu (xh.sh.) do t'i dënojë me dënim rëndë në Ditën e Gjykimit.

Duhet theksuar fakti se ka dijetarë që hyjnë në rrjetin e padrejtë udhëheqës, jo për të ndihmuar të padrejtët, por që të përkrahin të paaftët e të shtypurit për padrejtësitë që u bëhen. Këta lloj dijetarësh nuk duhet të fajsohen. Në histori përmendet se Imamët e Ehli Bejt (a.s.) kanë pasur raste të tilla dhe një ndër ta ka qenë rasti i Ali ibn Ja'kubit, i cili edhe pse shërbente në shtetin e padrejtë, ishte ndihmëtar për të paaftët e të shtypurit.

Kapja pas simboleve të fesë

Është detyrë e dijetarëve dhe e atyre që kanë hyrë në rrugën e dijes që të jenë shembull në punët e fesë e rregulla të fesë, siç janë, prania e vazhdueshme nëpër xhami, në morale të pëlqyera, në zbatimin e etikës islame, vizitimi i të sëmurëve, përmbushja e nevojave të njerëzve, thjeshtësia ndaj njerëzve, etj. Po ashtu, dijetarët duhet të jenë shembull në paraqitjen e tyre të jashtme, në pastërtinë e trupit e të rrobave, si dhe në përdorimin e erërave të këndshme. Pamja e jashtme e tyre nuk duhet të jetë larguese; nuk duhet prej tyre të kundërojnë erëra të përbuzura; ata nuk duhet të veshin rroba që janë në kundërshtim me kulturën e shoqërisë në të cilën jetojnë.

Me fjalë përmbledhëse: Është detyrë e dijetarëve që të jenë shembulli më i lartë dhe veprat e tyre të jenë mishëruar me simbolet (dispozitat) e fesë dhe me ligjet e saj, me qëllim që njerëzit të marrin mësim prej veprave të tyre më shumë se ç'mësojnë prej thënieve të tyre.

Përmbledhje

- Ka mundësi që dija të shndërrohet në një "pengesë" mes njeriut e Zotit (xh.sh.), sepse dija përmban kënaqësi dhe faza, që e mashtrojnë njeriun dhe e bëjnë të pavëmendshëm ndaj qëllimit të kërkimit të dijes dhe të përvetësimit të saj. Prandaj, duhet që dijetarët dhe kërkuesit e dijes të jenë të kujdesshëm ndaj vetëkënaqësisë e mendjemadhësisë.
- Vërtet, rruga e kërkimit dhe e përvetësimit të dijes është e vështirë; prandaj dijetarët dhe kërkuesit e dijes duhet të mbështeten te All-llahu (xh.sh.).
- Përderisa dija është dritë e All-llahut, atëherë devotshmëria është prej kushteve të përgatitjes shpirtërore për ta përvetësuar atë dritë.
- Mbështetja tek All-llahu (xh.sh.) dhe çiltërsia e qëllimit, e bëjnë dijetarin dhe kërkuesin e dijes që të jetë sa më shumë i preukopuar. Duhet që njerëzit të mos e ndiejnë nevojën materiale të dijetarit.

- Përputhja mes thënies dhe veprës është e domosdoshme për të gjithë njerëzit, në përgjithësi por më shumë kjo përputhshmëri duhet të gjendet tek dijetarët dhe përvetësuesit e dijes. Ata duhet të jenë shembull në ruajtjen e etikës e të simboleve (dispozitave) të fesë.

Pyetje

- 1- Përse Profeti Muhammed (s.a.u.s.) e quan dijen “hixhabi” më i madh?
- 2- Përse duhet që kërkuesit dhe përvetësuesit e dijes të jenë të mbështetur më shumë tek All-llahu?
- 3- Përse devotshmëria konsiderohet kusht për fitimin e përvetësimit të dijes?
- 4- Përse e pranuan njerëzit Profetin Muhammed (s.a.u.s.)? Argumentojeni me ajet nga Kur’ani.
- 5- Sqaroni shkurtimisht detyrat e përbashkëta për nxënësin dhe mësuesin.



Mësimi i 6^{të}

DETYRAT E MËSUESIT (1)

Pasi u njohëm me detyrat e përbashkëta mes mësuesit dhe nxënësit, në këtë mësim dhe në atë që do të vijë më pas do të flasim për detyrat e veçanta të mësuesit.

Dijetari i shquar islam, Shehidu eth Thani, i ka ndarë detyrat e mësuesit në tri grupe;

- a- Detyrat individuale, b- Detyrat ndaj nxënësve të tij, c- Detyrat në klasën e mësimi.

A- Detyrat individuale

Është detyrë e mësuesit që të mos japë mësim për atë temë për të cilën nuk ka njohuri të mjaftueshme. Ai nuk duhet ta fillojë mësimin derisa të dëshmojnë personalitete për aftësitë e tij pedagogjike. Përndryshe, nëse mësuesi nuk është i aftë, ai është njëllor si ai që vesh rroba më të mëdha se përmasat e tij.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që nuk është i aftë, ngjason me atë që vesh rroba fallso.”** (102)

(102) *(Sunen ibn Daud, kapitulli i etikës, hadithi 4997 dhe Munijetul Murij, f. 217.)*

Duhet që mësuesi të mos merret me ata që nuk e respektojnë dijen dhe nuk e vlerësojnë pozitën e saj. Në këto raste, dija dhe dijetari do të përballen me nënçmim. Në të shkuarën, dijetarët e konsideronin shkuarjen e mësuesit në shtëpinë e nxënësit përçmim dhe fyerje, për shak të madhështisë së dijes, për arsye se kur nxënësi shkon te mësuesi, ai nuk ndien në vetvete se është më lart se mësuesi. Prandaj, shumë dijetarë këshillonin të kundërtën: mësuesi ta presë nxënësin në shtëpinë e tij. Dijetarët porositnin gjithashtu për të imigruar nga një vend në tjetrin për të kërkuar e përvetësuar dije, edhe pse kishte vështirësi, sepse misioni i kërkimit e përvetësimit të dijes është më i madh se sa vështirësitë.

Më lart, kur përmendëm detyrat e përbashkëta të mësuesit e të nxënësit, thamë se të dy palët duhet të kenë qëllim të çiltërt. Përsëri dëshmojmë e themi se mësuesi është më parësor në këto detyra sesa nxënësi, sepse, nëse mësuesi nuk punon sipas dijes që zotëron, do të humbasë ndikimin në vetat e nxënësve të tij dhe nuk do t'ia dëgjojnë fjalën duke u shfajsuar se mësuesi nuk është i vërtetë në thëniet.

Për këtë Kur'ani thotë: **“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Por ju e lexoni Librin (Teuratin). A nuk po mendoni?”** (103)

(103) *(Sure “El Bekare, ajeti 44.)*

E kanë pyetur Imam Sadikun (a.s.) për dijetarët që përmenden në ajetin: **“...Por nga robërit e Tij vetëm dijetarët ia kanë frikën All-llahut; All-llahu është mbi gjithçka, është Mëkatfalës.”** (Sure “Fatir”, ajeti 28). Ai (a.s.) është përgjigjur:

“Të tillët janë ata, veprat e të cilëve dëshmojnë thëniet e tyre. Ata, vepra e të cilëve nuk e vërtetojnë atë që thonë, nuk janë dijetarë.” (104)

(104) (Usulul Kafij, vëll. 1, f. 36.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Shpinën time e thyejnë dy njerëz; dijetari që shkel kufijtë dhe i padituri i kapur fort pas paditurisë së tij. I pari i largon njerëzit nga dija e tij, sepse nuk e zbaton atë. I dyti i largon nga adhurimi i tyre me paditurinë e vet.” (105)**

(105) (Biharul Anvar, vëll.1, f. 208.)

Është detyrë që dijetari të jetë i prerë; pra nëse thotë se do ta bëjë diçka, ta bëjë e jo të thotë diçka e të bëjë diçka tjetër. Dijetari nuk duhet t'i urdhërojë nxënësit ta bëjnë diçka dhe vetë të bëjë të kundërtën e asaj që thotë, supozojmë, p. sh, ai i këshillon nxënësit e tij që të falin namazin me xhemat, të vizitojnë të sëmuret, të marrin pjesë në xhenaze, të vizitojnë farefisën etj, mirëpo vetë nuk i kryen këto, ose i ndalon nxënësit të bëjnë disa vepra dhe vetë i bën.: p.sh., i paralajmëron dhe i këshillon nxënësit që të mos jenë të apasionuar pas kësaj jete e të mos mashtrohen me bukuritë e saj; ndërkohë, vetë jeton jetë luksoze. Ndoshta ka arsye që Sheriati e pengon dijetarin të kryejë një detyrë fetare. Edhe nëse ka arsye, ai duhet të jetë shembull me qëllim që respekti i njerëze për atë të jetë më i madh. Nëse njerëzit shohin në veprat e tij diçka që e prish këtë shembull, atëherë ata nuk do t'i besojnë fjalëve të tij dhe tek ta do të lindin dyshime për të. Të gjithë e dimë se agjërimi në Ramazan është detyrë e të gjithë atyre që kanë përmbushur kushtet e agjërit. Po ashtu, e dimë se ky muaj është i shenjtë. Prandaj kushdo që përpiket të shkelë mbi këtë shenjtëri, shihet i çmendur në sytë e të tjerëve. Për këtë, kushdo që mund të ketë arsye për të mos agjëruar, duhet të mos hajë e të mos pijë në sytë e të tjerëve, sepse ky veprim mund t'i nxisë njerëzit e dobët shpirtërisht të marrin guximin e të shkelin shenjtërinë e këtij muaji të madhërishtëm. Nëse dijetari e bën këtë, atëherë gjendja e tij do të jetë delikate, sepse ai shihet si shembull nga të tjerët. Prandaj, dijetarit i del për detyrë që të mos kryejë veprime që e vendosin në qarkun e dyshimeve e të akuzës.

Duhet që mësuesi të jetë në shkallë të lartë në moral. Është mëse e natyrshme që çdo vepër dhe thënie e dijetarit të jetë shumë ndikuese; prandaj atij i kërkohet që të jetë i thjeshtë, zemërgjerë dhe shpirtmirë me njerëzit. Nëse i ka këto cilësi e të tjera të ngjashme me këto, ai do të jetë më afër me njerëzit dhe ata do t'ia dëgjojnë fjalët dhe do të frymëzohen prej jetëshkrimit të tij. Në mësimet e mëparshme lexuan veprimin që bëri Hazreti Isai (a.s.), i cili njihej me emrin “El Mua’lim”, se si u lau këmbët apostujve, me qëllim që t'u mësonte atyre kuptimin e thjeshtësisë. Ai u tha atyre: **“Ua lava këmbët për thjeshtësi ndaj jush, prandaj tregohuni të thjeshtë ndaj njerëzve, ashtu siç u bëra unë me ju. Urtësia rritet aty ku ka thjeshtësi e jo aty ku ka mendjemadhësi, njësoj si bima, e cila rritet e zhvillohet në tokë pjellore e jo në shkëmbinj.”**

- Nuk duhet që dija të jetë në shërbim të të padrejtëve, sepse ka njerëz që interesohen për dijen, me qëllim që të armatosen me të që të jenë të fuqishëm, më tiranë e më diktatorë. Po ashtu, nuk duhet që qëllimi i kërkimit e i përvetësimit të dijes të jetë vetëm për fitimet e kësaj jete. Nëse

ndodh kjo, atëherë është detyrë e mësuesit që të mos jetë koprrac e të mos i ndalojë nga të mësuarit, sepse ndoshta do të vijë një ditë e ata do të zgjohen dhe do t'i kuptojnë gabimet dhe do t'i ndreqin gjendjet e tyre falë punës së mësuesit. Mësuesi e bashkon dijen me moralin e përkryer e kështu ai është shembull ndikues te nxënësit e tij. Dijetarët e shkuar nuk e fillonin mësimin para se t'u jepnin këshilla e porosi nxënësve. Kur bindeshin për moralin e tyre, atëherë e fillonin mësimin. Prandaj është detyrë e çdo mësuesi që dijen t'ua japë atyre që e meritojnë, që ajo të mos bëhet mjet në duart e të padrejtëve, për të përhapur shkatërrimin e gjithanshëm.

- Mësuesi duhet të jetë bujar në dijen që zotëron, ta përhapë atë, të mos jetë koprrac dhe mos e fshehë atë. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Dhe kur All-llahu mori zotimin nga ata që u pati dhënë Librin - që gjithqysh t'ua jepni atë njerëzve e të mos e fshihni; por ata e lanë pas dore atë për pak gjë të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe.”** (106)

(106) (*Sure “Ali Imran”, ajeti 187.*)

Dhe: **“Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi ua sqaruam ato njerëzve në Librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë.”** (107)

(107) (*Sure “Bekare”, ajeti 159.*)

Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.), ka thënë: **“Zeqati i dijes është t'ua japësh atë robve të All-llahut.”** (108)

(108) (*El Kafij, vëll.1, f.41.*)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Unë kam lexuar në librin e Aliut (a.s.): Vërtet, All-llahu ka marrë besën prej të paditurve që ata të kërkojnë dijen dhe u ka marrë besën të diturve që t'ua mësojnë dijen të paditurve, sepse dija më parë ka qenë padituri.”** (109)

(109) (*El Kafij, vëll.1, f. 41.*)

- Prej detyrave të mësuesit është që të shfaqë të drejtën e të vërtetën, derisa njerëzit të arrijnë të dallojnë se cila është e vërteta e drejtësia dhe cila është e pavërteta dhe padrejtësia, me qëllim që askush të mos shfajsohet e të mos thotë që nuk e dija se cila ishte e vërtetë dhe askush nuk më ka udhëzuar në të. S'ka dyshim se urdhërimi për të mira e ndalimi nga e keqja është pikësëpari detyrë e dijetarëve, por edhe e çdo besimtari me aq sa të mundet. Nga këtu kuptohet se përgjegjësi më të madhe në këtë anë kanë dijetarët, mësuesit dhe edukatorët. Kjo i bën ata që të jenë gjithmonë paraprijës për ndalimin e të këqijave e të bidateve.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur të shfaqet bidati në ymmetin tim, dijetari të shfaqë dijen e tij. Nëse nuk e bën, atë do ta mallkojë All-llahu.”** (110)

(110) (*Biharul Anuar, vëll.2, f.13, kapitulli, 72.*)

Kjo do të thotë që çdo shpërfillje në këtë detyrë dhe çdo pavendshmëri në përballjen me bidatin do ta çonte njerëzinë në mashtrim dhe do ta shmangte nga feja e tyre. Është detyrë e dijetarëve që të jenë të guximshëm e të aftë dhe të sqarojnë të drejtën dhe të vërtetën; përndryshe, ata do të jenë fajtorë dhe përgjegjës për devijimin e njerëzve.

Përmbledhje

Prej detyrave të dijetarit është që ai të jetë i aftë në mësim. Puna e tij duhet të jetë në përputhje me thëniet e tij, të zbukurohet me moralet e larta e të përkryera, t'i njohë nxënësit e tij të çiltër, të jetë guximtar përballë bidatit e të këqijave dhe të përhapë të vërtetën pa luhatje e pa frikë.

Pyetje

- 1- Çfarë aftësish duhet të ketë dijetari a mësuesi përpara se të fillojë mësimin?
- 2- A duhet që dijetari t'ia japë kujtdo dijen?
- 3- Cilat janë të veçantat e dijetarit sipas hadithit të transmetuar nga Imam Sadiku (a.s.)?
- 4- Përse dijetarët e shkuar nuk e fillonin mësimin përpara se t'i këshillonin e t'i porositnin nxënësit për moralin?



DETYRAT E MËSUESIT (2)

Detyrat e mësuesit kundrejt nxënësve janë:

- 1- T'i njohë ata me etikën e fesë dhe pohojë rëndësinë e saj në rrugën e kërkimit e të përfitimit të dijes. Për çdo gjë gjendet enë dhe ena e dijes është zemra. Prandaj, duhet që mësuesi para se të fillojë mësimin, t'i përgatitë shpirtërisht nxënësit e tij që t'i pranojnë të vërtetat shkencore, me qëllim që ata t'i përvetësojnë sa më mirë ato dhe t'i zbatojnë kudo që të jenë. Kushti i parë në këtë rrugë është që mësuesi të përpiqet t'i udhëzojë nxënësit që të jenë të çiltër në qëllim e në përcaktimin e synimeve për të përfituar dije. Nga kjo del se misioni i parë i mësuesit është që t'u sqarojë nxënësve qëllimet e larta të dijes, me qëllim që ata të kuptojnë se jeta në këtë jetë është njësoj si vegimi, të cilin i eturi e mendon se është ujë, t'u sqarojë atyre se çdo gjë në këtë jetë është e paqëndrueshme dhe se përsosuria e vërtetë për njeriun është kur arrin afrimin tek All-llahu (xh.sh.).
- 2- Pasi mësuesi bindet për botëkuptimin e nxënësve, për pastërtinë e ndërgjegjeve dhe për çiltërsinë e zemrave të tyre, vjen misioni tjetër, i cili është sqarimi i vlerave të dijes, i pozitës së saj dhe rëndësia e përfitimi i moraleve të pëlqyeshme. Këtë mision mësuesi e kryen duke u përmendur atyre se njeriu, i cili arrin të kuptojë të vërtetën, i ka plotësuar dy kushte: njëri është dija dhe tjetri është përkushtimi, devotshmëria. Po ashtu, ai u kujton atyre sakrificat dhe mundimet e edhe eksperiencën e dijetarëve të shkuar, që t'i kenë gjithmonë parasysh dhe të nxjerrim mësimë prej tyre.
- 3- Marrëdhëniet e mësuesit me nxënësit duhet të ngrihen mbi besën e vëllazërisë islame. Prandaj, duhet që mësuesi të mbartë për nxënësit ndjenjën e babait për fëmijët. T'u dojë atyre atë që u do fëmijëve të vet dhe t'u përbuzë atyre atë që përbuz për fëmijët e vet. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Askush prej jush nuk është besimtar derisa t'i dojë vëllait të tij atë që do për veten e vet.” (111)**
(111) (Sabihu i Buhariut, vëll. kapitulli i imanit dhe Munijetul Murijid, f. 190)
- 4- Mësuesi duhet t'i ndalojë nxënësit e tij nga punët e ndaluara (haram) e të këqija dhe t'i paralajmërojë ata për ndikimet negative që sjellin moralët e papëlqyera. Ai duhet të përdorë një metodë transparente, larg nervozimit ose t'i flasë tërthoras, sepse biseda e drejtëpërdrejtë ndoshta çon në shkeljen e kufijve moralë. Metoda më e mirë në edukim është këshilla me butësi e më pas udhëzimi në rrugën e drejtë. All-llahu (xh.sh.) e urdhëroi profetin Musa (a.s.) që së bashku me

vëllanë e tij, Harunin të shkonte te Faraoni dhe u tha: **“Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”(112)**

(112) (Sure “Ta Ha”, ajeti 44).

S’ka dyshim se metoda e butë dhe udhëzimi për të mos e bërë një punë që është në kundërshtim me Sheriatin dhe me moralin e mirë, do t’i hapë portën çdo nxënësi që të hyjë në rrugën e drejtë, nëse nuk e ndjek këtë rrugë.

5- Mësuesi duhet të mos tregohet mendjemadh dhe t’i pëlqejë vetja para nxënësve. Thëniet e tij të jenë të bashkuara me respektin dhe thjeshtësinë. Në këtë mënyrë mund të arrihet lidhja shpirtërore dhe dashuria mes mësuesit dhe nxënësve të tij e nxënësit do të ndikohen prej personalitetit të tij gjatë mësimit. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’anin Famëlartë: **“E të jeshë i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty.”(113)**

(113) (Sure “Esh Shuara”, ajeti 215)

Pra, mësuesi dhe edukatori duhet të vishen me cilësinë e butësisë, të dashurisë dhe të mëshirës. Kështu, nxënësit do të kuptojnë se ai dëshiron të mirën e tyre. Kështu, nxënësit do ta kuptojnë më së miri çiltërsinë, pastërtinë dhe intelektin e mësuesit e të edukatorit të tyre. Mësuesi duhet që të njohë emrat e nxënësve që në fillim dhe t’u flasë atyre me respekt. Nëse ndonjë nxënës mungon, kur të vijë të nesërmen, ta pyesë se si ka qenë me shëndet dhe ta kuptojë arsyen e mungesës së tij me butësi përse mungoi. Sepse kjo lloj metode:

Së pari: Bëhet faktor i suksesit të mësuesit në misionin e tij.

Së dyti: Ruan respektin dhe pozitën e tij në zemrat e nxënësve.

6- Duhet që mësuesi t’i marrë në konsideratë nivelin e nxënësve të tij dhe aftësitë e tyre. Nëse, projekti i mësimdhënies së një lënde nuk është në përshtatje me nivelin e nxënësve, në përfundim do të shihen përfundime negative. Prandaj, është e domosdoshme që projekti i mësimdhënës të mos jetë i vështirë e jofrytdhënës, sepse do të dobësohet inkurajimi i nxënësve dhe ata nuk do t’ua vënë veshin fjalëve të tij. Kur nxënësit e pyesin mësuesin, ai duhet t’u përgjigjet qartë. Nëse ndonjë pyetje e tyre mund të jetë e vështirë dhe ka nevojë për hulumtim, e shtyn përgjigjen për një ditë tjetër, sepse, nëse përgjigjja nuk do të jetë e qartë dhe bindëse, mund të sjellë hutim e devijim te nxënësit. Po kështu, edhe gjendja për dijetarin. Edhe ai të mos përgjigjet nëse nuk është i bindur për përgjigjen; përndryshe, njerëzit do të hutohen e do të përfundojnë në devijim.

Mësuesi duhet ta sistemojë mësimin e lëndës në një program të caktuar dhe të jetë sa më i thjeshtë e i kuptueshëm për nxënësit. Përveç kësaj duhet që të përzgjedhë temat sipas rëndësisë së saj.

7- Mësuesi duhet të mbjellë te nxënësit vetëbesimin dhe shpresën, t’i nxitë ata për përparim e lartësim në rrugën e përsosurisë njerëzore e shkencore; gjithmonë t’u japë zemër që të pyesin dhe të shfaqin mendimet e tyre. Nëse ndonjë prej nxënësve shtron një pyetje qesharake, shfaq ndonjë mendim të gabuar, mësuesi e sqaron pyetjen a mendimin me respekt e zemërgjerësi dhe të mos e nënvleftësojë, sepse

nënvleftësimi i nxënësit çon në shkeljen e etikës në marrëdhëniet dypalëshe dhe në shkëputjen e atyre marrëdhënieve të ngritura mbi bazën e dashurisë e të respektit të ndërsjelltë.

8- Mësuesi duhet ta bëjë sa më të thjeshtë e sa më të larmishme orën e mësimit, që lënda të kuptohet sa më shpejt. Nëse mësuesit do të zbatojnë program të vështirë në mësimdhënie, lënda do t'u duket e rëndë nxënësve entuziazmi i tyre do të zbehet dhe përfundimi nuk do të jetë i kënaqshëm. Programi i vështirë i bën nxënësit edhe të dyshojnë në aftësitë dhe në zgjuarsitë e tyre. Së fundi, në shpirtërat e tyre do të hyjë mërzia dhe dështimi.

9- Mësuesi duhet t'i nxitë nxënësit që të përparojnë sa më shumë në mësim. Këtë e bën duke i ngarkuar ata me gjurmime e hulumtime shkencore ose shtron pyetje shkencore dhe ata përgjigjen. Pra, të ushtrojë diskutimin e lirë. Po ashtu, mësuesi i nxit ata që të bëjnë kritikë për një temë të caktuar, me qëllim që tema të ngulitet sa më shumë në mendjen e nxënësve dhe të bëhet sa më shumë e kuptueshme.

10- Mësuesi duhet të bashkëpunojë me nxënësit me drejtësi e me barazi. Të mos bëjë asnjë dallim mes tyre, sepse të gjithë janë të barabartë në detyra e të drejta. Mirëpo, është e natyrshme që disa nxënës të jenë të dalluar nga të tjerët për nga vëmendja dhe nxënësia e lëndës së mësimit. Ka prej tyre që janë më sipër nga të tjerët, sepse studiojnë më shumë dhe gjurmojnë e hulumtojnë për çështje që kanë të bëjnë me lëndën që mëson në klasë. Në këtë gjendje, mësuesi duhet të kujdeset për këta nxënës. Këtë përkujdesje dhe këtë interesim të mos e konsiderojë dallim, sepse është shumë e keqe që mësuesi të bëjë barazi mes nxënësit aktiv dhe atij që është përtac. Në këtë rast barazia do të shkaktojë mërzitje për nxënësit e zgjuar dhe do t'i bënte përtacë, si dhe shton sjelljet e papëlqyera tek përtacët.

11- Mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm në profesionin e tij dhe të mos trajtojë tema që nuk janë pjesë e specialitetit që ai ka dhe as nuk ka aftësi të mjaftueshme për trajtimin e sqarimin e asaj teme. Nëse do të hyjë në trajtimin e temave që janë jashtë specialitetit të tij, atëherë, nga njëra ana, do të pakësohet respekti ndaj tij dhe nga ana tjetër ai do jetë shkak i devijimit të nxënësve. Po ashtu, mësuesi të mos thotë se fusha e dijes ku është specializuar është e vetmja që e meriton të respektohet, duke u përpjekur kështu që të ulë vlerat e fushave të tjera të dijes.

12- Mësuesi duhet që pasi t'i ketë njohur mirë aftësitë e nxënësve, t'i drejtojë ata te mësues a pedagogë të njohur për të zgjeruar dijet e tyre.


13- Kur mësuesi është i bindur për aftësitë e nxënësve, duhet t'i aktivizojë ata për mësimin dhe udhëzimin e të tjerëve; gjithashtu, t'i përmendë ata në ceremoni e në tubime të ndryshme, sidomos para njerëzve të shquar e të njohur.

Përmbledhje

S'ka dyshim se edukimi i nxënësve me etikën islame, thirrja e tyre në përkushtimin ndaj All-llahut (xh.sh.), forcimi i marrëdhënieve me ta, thjeshtësia ndaj tyre, forcimi i shpirtit shpresues në ta, nxitja e tyre për studim, bashkëbisedimi, bashkëpunimi me drejtësi e barazi me ta dhe mosdallimi mes tyre - të gjitha këto janë detyra të mësuesit kundrejt nxënësve.

Pyetje

- 1- Përse duhet që para se të fillojë mësimin, mësuesi të bëjë edukimin moral të nxënësve?
- 2- Si duhet të jenë marrëdhëniet mes mësuesit dhe nxënësve?
- 3- Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi kur të formulojë programin e lëndës?
- 4- Cila është përgjegjësia e mësuesit ndaj inferioritetit dhe aftësive të disave prej nxënësve të tij?
- 5- Cila është përgjegjësia e mësuesit ndaj nxënësve të tij të sukseshëm e inferiorë?



Shoqata

Fladi

Mësimi i 8-të

DETYRAT E MËSUESIT (3)

A- Detyrat e mësuesit në klasë

- 1- Para se të hyjë në klasë, mësuesi duhet jo vetëm të jetë përgatitur për mësimin, por të kujdeset edhe për paraqitjen e tij të jashtme, si, p. sh., pastërtia, me qëllim që të jetë shembull për nderim. Pastërti nuk do të thotë që të veshë rroba luksoze e të shtrenjta, por të interesohet për estetikën e tij. Nderimin nuk e sjell veshja e rrobave të shtrenjta, por rrezet që dalin prej thënieve e punëve të tij.
- 2- Kur mësuesi të dalë nga shtëpia për të shkuar në mësim, të përmendë All-lahun (xh.sh.) dhe të thotë këtë lutje, e cila është përcjellë nga Profeti Muhammed (s.a.u.s): **“O Zot, unë të kërkoj Ty të më mbrosh nga humbja, as të mos çoj të tjerët në humbje, të mos poshtërohem, as të mos i poshtëroj të tjerët, të mos më bëhet padrejtësi, as të mos bëj padrejtësi, të më mbrosh prej paditurisë, as të mos i bëj të tjerët të paditur...”** Pastaj të thotë: **“Bismilah, All-llahu është Mbrojtësi dhe Sipërmarrësi im dhe Atij i mbështetem.”**
- 3- Kur të hyjë mësuesi në klasë, duhet t'i përshëndesë nxënësit me dashuri e respekt dhe këtë dashuri e respekt t'i ruajë deri në fund të orës së mësimin. Çdo lëvizje dhe çdo qëndrim i tij në klasë të jenë sipas etikës së lartë islame. Ai duhet të mënjanojë çdo lloj lëvizjeje apo qëndrimi që nuk i shkon profesionit të mësuesit dhe që bëhen shkak i shpërqëndrimit të nxënësve nga tema e mësimin. Kjo ndihmon që nxënësit ta dëgjojnë me vëmendje të plotë si dhe ta përvetësojnë lëndën.
- 4- Mësuesi duhet ta fillojë mësimin me “Bismil-lah” (Me emrin e All-llahut xh. sh.) dhe ta mbyllë me falënderimin e Tij. Këtë duhet ta ushtrojë gjithmonë derisa edhe nxënësit ta thonë sa më shumë jo vetëm në klasë, por në çdo punë të mirë. Dijetarët e shkuar të moralit i kanë këshilluar mësuesit që të falnin dy rekatë namaz para se të fillonin mësim dhe t'i kërkonin All-llahut t'i ndihmonte në misionin e tyre. Me këtë veprim mësimi merr edhe ngjyrat e shenjtërisë e të lartësisë dhe i shtyn nxënësit që ta respektojnë mësimin dhe mësuesin. Ky veprim ndikon edhe në pastërtinë e qëllimit dhe në çiltërsinë e mësimin; kështu mësimi pëlqehet tek All-llahu (xh.sh.)
- 5- Duhet që metoda e mësuesit në mësim të jetë e frymëzuar me besim dhe çdo fjalë që thotë, të jetë e vërtetë. Përndryshe, mësimi i tij nuk do të gjejë rëndësinë e kërkuar te nxënësit. Prandaj, mësimi duhet të jetë serioz dhe larg çdo përcmimi. Sigurisht, serioziteti nuk e mohon butësinë dhe projektimin orientues. Serioziteti nuk do të thotë vjrenjte e fytyrës, përkundrazi gjatë

mësimi mësuesi duhet të ngjallë atmosferën e aktivizimit nëpërmjet buzëqeshjes së ëmbël.

- 6- Mësuesi duhet të jetë i mirwinformuar për metodën e mësidhënies. Ai duhet të zbatojë një metodë, e cila realizon qëllimin e duhur. Po ashtu, mësuesi duhet të zbulojë nivelet e dijes së nxënësve dhe t'i njohë ata që në orën e parë të mësimi me metodën dhe mënyrën e tij të mësimdhënies.
- 7- Mësuesi duhet të mos zgjatet shumë në mësimin, që ai të mos bëhet i mërzitshëm, sepse sa më shumë të zgjatet koha më shumë ç'është caktuar, aq më shumë pakësohet vëmendja në mësim. Mësuesi nuk duhet t'i kalojë pikat kyçe të mësimi pa u kushtuar interes, sepse përqendrimi në pikat kyçe të mësimi i mundësojnë nxënësit në ngulitjen e mësimi sa më shumë në mendjet e tyre. Ka shumë hadithe të Profetit (s.a.u.s.) dhe të Ehli Bejti (a.s.), që dëshmojnë rreth pikave kyçe të mësimi.
- 8- Mësuesi duhet të ketë parasysh interesimin e nxënësve në zgjedhjen e temës, në zgjedhjen e metodës, në zgjedhjen e kohës së përshtatshme dhe në renditjen e temave, me qëllim që nxënësit të përfitojnë sa më shumë. Po ashtu, mësuesi të ketë kujdes zërin e tij; të mos flasë me zë shumë të lartë, i cili mund të jetë i dëmshëm, e as të flasë me zë të ulët, të cilin nuk e dëgjojnë mirë.
- 9- Mësuesi duhet të mos lejojë që në klasë të bëhet zhurmë, sepse kjo mund të çojë në shkeljen e kufijve të shenjtërisë së mësimi; as debatin e zbrazët që mund të çojë në devijim mendor të nxënësve.
- 10- Mësuesi duhet t'i nxitë nxënësit të zbatojnë rregulat e moralit, të disiplinës dhe të repektimit të mësimi; t'i forcojë shpirtërat e nxënësve për të mbajtur përgjegjësinë morale e shoqërore, sepse ata ndodhen para hyrjes në portat e jetës së gjërë shoqërore; pra, duhet të jenë të aftë të marrin përgjegjësi kundrejt shoqërisë ku jetojnë.
- 11- Mësuesi duhet të jetë zemërgjerë dhe t'i dëgjojë pyetjet e nxënësve me vëmendje. Kjo është e rëndësishme sepse ndonjë nxënës mund të shtrojë pyetje për një synim të caktuar. Ndoshta, ndonjë prej tyre do të provokojë nervat e mësuesit dhe aftësitë e tij. Ndonjë prej tyre mund të përdorë fjalë të pazgjedhur në pyetje. Të tilla raste mësuesi duhet t'i përballë me zemërgjerësi e respekt dhe t'i përgjigjet me qetësi dhe duke u mbështetur në argumente të cilët janë në përshtatje me aftësitë e tyre.
- 12- Prej detyrave të mësuesit është që ai të thotë gjithmonë të vërtetën dhe ta dëshmojë atë para nxënësve të tij. Nëse e pyesin për ndonjë çështje dhe ai nuk ka njohuri për të, më mirë të thotë se nuk e di. Kjo nuk do të thotë se ai është i paditur dhe as nuk e ul sasinë e dijes, sepse të thotë nuk e di është më mirë se sa të japë përgjigje të gabuar. Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nëse iu pyesin për ato që nuk i dini largohuni.”** Atë e pyetën: **“Si të largohemi?”** Ai u përgjigj: **“Të thoni: “All-llahu e di.”**(114)

(114) (Sunen Ed Darimij, vëll. 1 dhe Munijetul Murijid, f.215.)

Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Për atë që e dini përgjigjuni, kurse për atë që nuk e dini, thoni: “All-llahu e di.”**

Ndoshta dikush mund të mendojë gabimisht se thënia “*nuk e di*” e përçmon dhe ia ul pozitën mësuesit para nxënësve të tij, por e kundërta është më e mirë, për shkak se kur nxënësit dëgjojnë mësuesin e tyre i cili thotë të vërtetën, do ta respektojnë më shumë dhe do ta besojnë çdo thënie të tij. Ky qëndrim e ka burimin tek devotshmëria, besnikëria, drejtësia dhe guximi. Nuk kërkohet që mësuesi të jetë i ditur për të gjitha fushat e dijes. Prandaj, mësuesi nuk duhet të hiqet sikur i di të gjitha dhe kur të pyetet për ndonjë çështje që nuk e di, të mos japë përgjigje të dyshimtë, sepse mund të akuzohet për çmenduri.

13- Para se të përfundojë mësimi, mësuesi duhet të bëjë përmbledhjen e temës dhe të përsërisë pikat më kryesore, me qëllim që të arrijë në rezultatin e synuar. Në këtë mënyrë kuptohen më mirë ato që u thanë dhe nguliten më shumë në mendjet e nxënësve. Po ashtu, mund të sqarohen disa paqartësi që mund të kenë patur nxënësit gjatë shpjegimit. Kur gabon, mësuesi duhet të zbulohet me zemërgjerësinë dhe me pohimin se ka gabuar dhe ta ndreqë sa më shpejt gabimin duke kërkuar ndjesë. Kjo pasqyron thjeshtësinë dhe besnikërinë e mësuesit dhe rrit dashurinë e nxënësve për të.

14- Dijetarët e shkuar i porositnin mësuesit që t'i këshillonin nxënësit në fund të mësimit, me qëllim që të pastrojnë zemrat dhe të forcojnë shpirtërat e tyre, sepse dija kërkon zemër të pastër e të qëndrueshme.

15- Mësuesi duhet të caktojë një kohë të veçantë. Në fund të çdo ore mësimi për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për diskutime të lira me nxënësit dhe të mos largohet me nxitim nga klasa.

16- Në fund të çdo mësimi, mësuesi duhet të falënderojë All-llahun (xh.sh.). Transmetohet nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.) kjo lutje: **“O Zot, na i fal gabimet! Na i fal ato që i bëmë me qëllim, fshehtas apo haptas! Na i fal të gjitha ato, për të cilat Ti je më i Dituri...”**(115)

(115) (*Biharul Annuar*, vëll. 2, f. 63.)

Përmbledhje

S'ka dyshim se kujdesja për veshjen, pastërtinë e rrobave e të trupit është prej etikës islame. Po ashtu edhe lutja kur dilet nga shtëpia, përshëndetja e nxënësve kur hyhet në klasë, fillimi i mësimit me Bismil-lah (Me emrin e All-llahut) dhe mbyllja e tij me falënderimin e All-llahut. Të gjitha këto janë prej etikës dhe rregullave të mësimdhënies.

Po ashtu, mbështetja në metodën e saktë të mësimdhënies, mënjanimi i temave mërzitëse dhe pasja parasysh e interesit të nxënësve, të gjitha këto janë prej detyrave të mësuesit. Prej detyrave të mësuesit janë edhe pranimi i gabimit, zemërgjerësia dhe thënia “*nuk e di*”, kur e pyesin për ato që nuk i di.

Pyetje

- 1- Cilat janë ato rregulla që duhet të zbatohen para fillimit të mësimit?
- 2- Përse duhet që mësuesi t'i shmanget debatit me nxënësit?
- 3- Si duhet të punojë mësuesi me ato tema që nuk hyjnë në profesionin e tij dhe për të cilat nuk zotëron njohuri të mjaftueshme?
- 4- Sqaroni mënyrën e saktë të fillimit dhe të përfundimit të mësimit.

Mësimi i 9 ^{-të}

DETYRAT E NXËNËSIT (1)

Në mësimet e shkuara përmendëm se detyrat e mësuesit ndaheshin në tri grupe.

Në këtë mësim do të paraqesim tri grupe të detyrave të nxënësit. Këto janë:

- 1- Detyrat individuale të nxënësit;
- 2- Detyrat e nxënëit ndaj mësuesit;
- 3- Detyrat e nxënësit në klasë;

Pasi të njihemi me këto detyra, do të flasim për rregullat që ka secili grup.

1- Detyrat individuale të nxënësit

- a- Duhet që nxënësi të jetë i parapërgatitur nga ana shpirtërore për studim dhe për përvetësimin e dijeve. Hapi i parë që duhet të hedhë për ta arritur këtë qëllim është pastrimi i shpirtit dhe i zemrës. Ky veprim është i ngjashëm me përgatitjen e tokës për ta mbjellë në stinën e caktuar. Rëndësia e këtij veprimi është se dija, në përgjithësi dhe dijet e fesë, në veçanti nuk mund të hyjnë në zemra të rënduara e të veshura nga ndryshku e papastërtitë e tjera. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Në trupin e njeriut ndodhet një copë mishi, nëse ajo priset, priset i gjithë trupi. Kjo është zemra.”**(116)

(116) *(Sabihu i Buhariut, kapitulli i besimit dhe Munijetul Murijd, f. 224 dhe Biharul Anuar, vëll. 58, f. 23.)*

Dijetarët e moralit gjithmonë këshillojnë për devotshmërinë dhe largimin nga mëkatet, me qëllim që kujtesa e njeriut të jetë gjithmonë e fuqishme. Mëkatet dhe gjynahet e dobësojnë kujtesën, e nuk mund të jetë e aftë të ruajë njohuritë që meson. Prandaj, nxënësi duhet ta mbrojë veten e vet dhe zemrën e vet nga mëkatet.

- 2- Duhet që nxënësi të mos e humbasë kohën e tij më të mirë të jetës së tij, e cila është mosha e rinisë. Në këtë moshë njeriu arrin në majat më të larta të fuqive e të aftësive mendore e trupore dhe kjo është koha më e përsosur për të studiuar e përfetësuar dije e njohuri. Veç kësaj, në këtë moshë njeriu nuk ka shumë përgjegjësi të tjera, të cilat e pengojnë mendjen e tij. Në hadithe thuhet: **“Ai që e mëson dijen në vegjëli është njësoj si të shkruash mbi gurë. Ai që e mëson dijen në moshë të madhe është njësoj si ai që shkruan mbi ujë.”** (117)

(117) *(El Xhamiu Sagjir, vëll. 2, shkronja “mijm” dhe Munijetul Murijd, f. 225.)*

Sa më shumë të rritet mosha e njeriut aq më shumë dobësohen aftësitë e tij. Në Kur'an thuhet: **“E atë të cilit i japim të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij. A nuk janë duke menduar?”** Edhe pse studimi dhe përfitimi i dijes mund të arrihet në çdo moshë të jetës së njeriut, mosha e vegjëlisë dhe e rinisë janë fazat themelore, sepse në këto faza kristalizohet personaliteti i njeriut. Por kjo nuk pengon që dija të fitohet edhe në moshë të rritur. Historia na tregon se ka pasur njerëz, të cilët e kanë filluar studimin e dijeve në moshë të madhe dhe kanë arritur të bëhen të njohur. Një ndër ata është edhe Sekkakij (gjuhëtar dhe letrar i shquar i arabishtes), i cili i filloi studimet e tij në moshën dyzetvjeçare. Edhe pse përjetoj shumë vështirësi, ai arriti të bëhej prej dijetarëve të shquar të kohës së tij.

- 3- Duhet që nxënësi t'u shmanget atyre veprimeve që ia largojnë mendjen nga studimi dhe përvetësimi i dijes. Ndër ato janë: të menduarit për veshje luksoze, të banuarit në vende luksoze, etj. Nëse mendja e tij do të përqendrohet në këto çështje, atëherë nuk do të ketë hapësirë që të studiojë. S'ka dyshim se studimi kërkon durim, qëndresë ndaj unit dhe të mos shikohet në kënaqësitë kalimtare të kësaj jete.

- 4- Duhet që nxënësi të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet e tij shoqërore. Ai duhet të shoqërohet me njerëz që i respektojnë dhe i vlerësojnë dijet dhe studiuesit e saj. Nëse ai do të shoqërohet me njerëz mënjanës (indeferentë), të papunë dhe që merren me gjëra të pavlefshme e të padobishme, ata do të ndikojnë negativisht tek ai dhe do ta pengojnë në rrugën e studimit e të njohjes.
- 5- Duhet që nxënësi të jetë shumë i interesuar për të mësuar dhe gjithmonë të mendojë që të arrijë majat më të larta të dijes e të njohjes. Nëse do të jetë i tillë, ai do të përparojë në studimet e tij. Ndryshe, bindja mashtruese dhe thënia “mjafton” do të jenë fortifikatë në arritjen e qëllimit.
- 6- Duhet që nxënësi të jetë optimist në studime dhe të mos lejojë që asnjë mendim a veprim t’ia ftojë optimizmin dhe t’ia dobësojë shpirtin.
- 7- Duhet që gjatë studimeve nxënësi të mbështetet në të mësuarit logjik, të hyjë në rrugën e studimeve me qetësi e pa nxitim. Nuk është mirë që ai të hyjë në kërkime të thella, nëse nuk është i parapërgatitur.

8- Detyrat e nxënësit ndaj mësuesit

- a- Detyra e parë e nxënësit ndaj mësuesit është që të zgjedhë mësuesin më të mirë, sepse mësuesi luan rol të madh në edukimin dhe në caktimin e drejtimit mendor e shpirtëror për nxënësin. Prandaj, mësuesi duhet të jetë i sjellshëm, i përkushtuar dhe shembull në thënie e në veprime. Po ashtu, të ketë kulturë të gjërë në lëmin e dijes.
- b- Nxënësi duhet të bashkëpunojë me mësuesit njësoj siç bashkëpunon me prindërit e vet, por edhe më shumë, sepse prindërit kujdesen dhe interesohem kryesisht për zhvillimin trupor të fëmijës së tyre, ndërsa mësuesi ka marrë mbi supet e tij misionin e edukimit shpirtëror e kulturor.
- c- Nxënësi duhet të jetë i thjeshtë ndaj mësuesit. S’ka dyshim se thjeshtësia para dijes dhe dijetarëve është kusht në studimin dhe përvetësimin e dijes: dija nuk mund të fitohet me mendjemadhësi.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Mësojeni dijen dhe bëhuni të thjeshtë ndaj atyre që ju mësojnë.”(118)**

(118) (*Kenzul Ummal, hadithi / 28717 dhe Munijetul Murijid, f. 243.*)

ç- Prej etikës së të mësuarit është që nxënësi të respektojë mendimin e mësuesit. Të mos e akuzojë atë se është i gabuar dhe i paditur. Gjithmonë të mendojë se mendimi i vet është i gabuar dhe mendimi i mësuesit të tij është më i drejtë. Kjo tregon më së miri respektin e thellë që ka nxënësi për mësuesin dhe e mundëson atë që të jetë më i përqendruar në bashkëbisedime deri në nxjerrjen e së vërtetës. Nëse nxënësi vë në dukje ndonjë gabim te mësuesi, nuk duhet t’ia thotë haptas, përpara nxënësve të tjerë. Sa të shumtë janë dijetarët që kanë arritur në shumë të vërteta dhe kanë sjellë teori të ndryshme, por, përse kohë që mësuesi i tyre ka qenë i gjallë nuk i kanë shfaqur ato. Këtë e bënin si respekt dhe nderim ndaj mësuesit.

- d- Prej etikës është që nxënësi ta kujtojë me respekt e nderim mësuesin e tij. Ta thërrasë me mbiemra që sqarojnë vlerat dhe pozitën e tij, qoftë me fjalë apo edhe në shkrime të ndryshme.
- e- Prej detyrave të nxënësit ndaj mësuesit të tij është që të mos i harrojë përpjekjet dhe mundimet e tij. Të bëjë lutje për atë që All-llahu ta mbarësojë në këtë jetë dhe ta mëshirojë në Jetën tjetër dhe të ecë në gjurmët e tij e të mbartë moralin e tij.
- f- Nxënësi duhet të jetë i sjellshëm para mësuesit. T’i flasë atij me qetësi e me fjalë që tregojnë respekt e nderim për mësuesin.
- g- Duhet të merret në konsideratë optimizmi i mësuesit. Ky optimizëm qëndron tek aktivizimi i nxënësve dhe vëmendshmëria e tyre ndaj tij. Për këtë duhet që nxënësit të

krijojnë atmosferë aktive dhe të jenë të përqendruar në fjalët e mësuesit dhe t'i shmangen çdo veprimi që e bën mësuesin të ndiejë se nuk ka vëmendje në klasë. Nxënësit duhet që të kryejnë gjithmonë detyrat që u jep mësuesi.

- h- Prej etikës së të mësuarit është që të mos shihen gabimet e mësuesit në thënie a në veprime. Është e natyrshme që çdo njeri gabon, por nxënësi të mos e turpërojë mësuesin nëse vëren diçka te mësuesi (p. sh., këmishë e zbërthyer, jakën e ngritur të xhakëtës pa dashje etj.). Në raste të tilla, nxënësi duhet t'ia vërë në dukje mësuesit por pa e fyer atë.
- i- Nxënësi të mos e shqetësojë mësuesin duke shkuar tek ai në kohë të papërshtatshme.

Përmbledhje

S'ka dyshim se përvetësimi i dijes, shfrytëzimi i moshës fëminore e rinore, largimi prej mendimeve që e çorientojnë mendjen, marrëdhëniet e fuqishme shoqërore, përpjekjet për të arritur shkallët më të larta të dijes dhe mbështetja në metodat logjike për fitimin e dijes, të gjitha këto janë prej detyrave të nxënësit para fillimit të mësimeve a studimeve. Po ashtu, përzgjedhja e mësuesit më të mirë, bashkëpunimi i prindërve me mësuesin, sjellja e mirë në prani të mësuesit, kujtimi i mundimeve dhe i përpjekjeve të tij janë prej detyrave të rëndësishme të nxënësit ndaj mësuesit.

Pyetje

- 1- Si të parapërgatitet nxënësi për të nxënë dije?
- 2- Cila është koha më e përsosur në jetën e njeriut për studim?
- 3- Cilat janë ato gjëra prej të cilave duhet larguar në kohën e studimit?
- 4- Cilat janë ato të veçanta që duhet të gjenden te mësuesi?
- 5- Cilat janë të drejtat e nxënësit ndaj mësuesit?
- 6- Sqaroni përgjegjësinë morale të nxënësit kundrejt mësuesit!

DETYRAT E NXËNËSIT (2)

9- Detyrat e nxënësit në klasë

a- Dijetarët e moralit i këshillojnë nxënësit që ta lexojnë e ta këndojnë Kur'anin dhe ta mësojnë atë përmendwsh, për disa arsye;

Së pari: S'ka dyshim se Kur'ani është burimi i jetës dhe i njohurive të fesë së All-llahut (xh.sh.). Nëse nuk mësohet Kur'ani, çdo dije e mësuar do të jetë e cunguar, e mangët.

a- Mësimi përmendësh i Kur'anit dhe leximi e këndimi i tij, i sjell njeriut mirësi dhe i pastron zemrën dhe e bën të aftë për të nxënë dije.

b- Nxënësi duhet t'i njohë aftësitë e tij me qëllim që të mësojë me aq mundësi sa ka. Sa më shumë të përparojë njeriu në dije, aq më shumë i hapen horizontet, i rriten aftësitë dhe i shtohen fuqitë.

- Nxënësi duhet të përdorë metodë të rregullt në lexim a këndim e në studim. Kur të mësojë, të mos kalojë nga tema e parë tek tjetra derisa të bindet se e ka përvetësuar të parën, sepse do ta ketë të vështirë të bëjë ndreqje nëse e ka mësuar gabimisht dhe i është ngulitur në mendje.

- Nxënësi duhet të ketë një program të sistemuar ditor, sepse kështu e shfrytëzon kohën në maksimum. Ai duhet ta programojë kohën e tij në atë mënyrë që ajo t'i mjaftojë për të gjitha mësimet a studimet. As të mos neglizhojë e as të jetë i skajshëm në studime. Të mos thellohet në një anë të caktuar e të lërë pas dore anët tjera.

- Është mirë që nxënësi të zgjedhë mëngjesin si më të përshtatshëm për mësim, sepse në këtë kohë njeriu është më i gjallëruar, më veprues dhe mendja e tij është më e kthjellët dhe e çlodhur.

- Në klasë nxënësi duhet të jetë i përgatitur shpirtërisht. S'ka dyshim se edhe ushtrimet fizike ia shtojnë atij gjallërinë dhe energjitë. Nxënësi të mos jetë i pavëmendshëm ndaj sendeve të shkollës, siç janë, fletoret, lapsat, etj. si dhe leximi paraprak i temës së mësimi.

- Nxënësi duhet të dëgjojë me vëmendje fjalët e mësuesit dhe të reagojë për temën gjatë shpjegimit të saj, që të arrijë kështu të njihet me të gjitha anët e temës. Nëse ka paqartësi, të pyesë mësuesin e të diskutojë me mësuesin për ta derisa t'i kuptojë. Të mos mendojë se vetëm vëmendja në dëgjimin e shpjegimit është e mjaftueshme për ta kuptuar temën. Edhe aftësitë e tij, shkrimi i paqartësive, pyetjet, etj ndikojnë në ngulitjen e temës në mendje.

- Nxënësi nuk duhet të mungojë pa pasur ndonjë arsye të fortë, sepse shumica e temave të lëndës janë të lidhura me njëra-tjetrën. Nëse do të mungojë një ditë a më shumë, temat e padëgjjuara do të jenë të pakuptueshme për të dhe do t'i duhet kohë shtesë nga ajo e planifikuara që t'i mësojë ato tema.

- Nxënësi duhet të përshëdesë shokët e tij të klasës. Kur mësuesi është në klasë, përshëndetja të jetë më e përsosur. Kur hyn mësuesi më klasë, nxënësit duhet të ngrihen në këmbë për ta respektuar dhe të ulen kur t'u thotë mësuesi.

- Kur nxënësi të hyjë në klasë, të mos zgjedhë për vete vendim më të mirë për t'u ulur; vetëm nëse është i detyruar, ta bëjë këtë. Është thjeshtësi që nxënësi të ulet në bankën që ndodhet më afër derës. Por, kjo të mos bëhet me qëllim që të mos interesohet për mësimin.

- Nxënësi duhet të respektojë të drejtat e shokëve të vet. Ai duhet të ulët në atë vend ku mund ta ndjekë mësuesin, me qëllim që të përfitojë sa më shumë prej shpjegimeve të tij. Është mirë që nxënësit më të gjatë të ulen në bankat e pasme dhe të shkurtrit dhe ata që mund të kenë probleme në dëgjim a në shikim, të ulen në bankat e përparme. Detyrë e nxënësve është që ta respektojnë kohën që i lihet në dispozicion një tjetri për të diskutuar dhe të mos ndërhyjnë.
- Respekti i ndërsjellë mes nxënësve është një tjetër anë e etikës, e cila duhet zbatuar. Nuk lejohej që nxënësi t'i fyejë a t'i shajë shokët për ndonjë keqkutim që mund të ndodhë. Nuk lejohej që një nxënës ta ndërpresë bisedën e një tjetri, apo ta emërtojë me nofkë fyese. Nxënësi nuk duhet të ulët në bankën e tjetrit pa leje. Nxënësi i dalluar e i zgjuar duhet të jetë gjithnjë i gatshëm për t'i ndihmuar shokët në sqarimin e ndonjë çështjeje të paqartë.

Etika e banimit në konvikte

Në fillim të mësimit u përmend se ka rregulla për nxënësit në konvikte. Ndër to janë:

1- Medresetë (shkolla) me konvikte, janë ngritur sipas qëllimit të personit. Disa i ngrenë konviktet që të edukojnë dijetarë të vërtetë, që t'i shërbejnë fesë së All-llahut (xh.sh.). Disa të tjerë kanë për qëllim që me anë të këtyre konvikteve të përhapin bidati dhe humbjen në mesin e njerëzve. Prandaj para së gjithash, nxënësi duhet të ketë kujdes para rregjistrimit, të pyesë dhe të vërtetojë qëllimin e asaj shkolle.

Ka shumë bamirës që ndërtojnë shkolla për shpërblime (sevape) dhe prej nxënësve e prindërve të tyre kërkojnë veç se përqëndrim në studime dhe lutje për mbarësi për të.

2- S'ka dyshim se disiplina është e domosdoshmeve në jetën në konvikte. Nxënësi duhet të zbatojë rregullat e vendosura nga përgjegjësi i konviktit. Sigurisht, disa kushte nuk përputhen me natyrën e disa nxënësve dhe e kufizojnë lirinë e tyre. Por, duhet pranuar se ato u sigurojnë të gjithëve ndjenjën e qetësisë.

3- Për nxënësit në konvikt është detyrë që të interesohen për pastërtinë dhe shëndetin. Prej detyrave të jetës shoqërore është ndarja e përgjegjësisë të nxënësit në atë mënyrë që të sigurohet bashkëpunimi mes tyre për një jetë të kënaqshme. Asnjë nxënës të mos jetë mënjanës (neglizhent) ndaj përgjegjësisë që i është dhënë. Nxënësi duhet të marrë pjesë në çdo punë e cila ka dobi e mirësi për të gjithë ata që jetojnë në konvikt.

4- Çdo nxënës konvikt, ka dinjitetin dhe personalitetin e tij. Nuk lejohej që nxënësi të pengohet në kohën e lirë të tij për të lexuar, për të pushuar ose për të lidhur marrëdhënie me të tjerët.

5- Nxënësi duhet të jetë shembull për të tjerët në moral të mirë dhe t'i largohet shoqërisë së atyre që kanë moral të keq e të zgjedhë miq e shokë që kanë moral të mirë dhe që bëjnë punë të dobishme për shoqërinë.

6- Është mirë që nxënësi të interesohet për problemet e shokëve të tij konviktore, të ketë marrëdhënie të mira me ta, kur mungojnë të pyesë e të interesohet për ta dhe t'i ndihmojë kur kanë nevojë.

7- Siç dihet, nxënësit nuk janë njëlloj në parapëlqimet dhe shijet e tyre për shkak të nivelit të edukatës që kanë marrë a marrin në mjediset ku banojnë etj. Prandaj kjo duhet të merret parasysh. Në këtë rast, prej këshillave të përgjithshme është durimi për gabimet e shokut.

Dihet se falja është prej virtyteve të njeriut të mirë dhe prej domosdoshmërive të jetës shoqërore.

8- Nxënësit duhet të zbatojnë rregullat e jetës konviktores: kohën e gjumit, kohën e zgjimit, sistemimi e rregullimin e dhomës, të mos e ngushtojnë dhomën me pajisjet e tyre etj.

Përmbledhje

Nxënësi duhet të bëjë një program të hollësishëm për jetën e tij studimore, dhe ta zbatojë atë, që të përfitojë sa më shumë nga koha.

Nxënësi duhet të zgjedhë vendin në klasë e të ruajë shenjtërinë e mësuesit dhe të mos i shqetësojë shokët e tij.

Prej etikës së jetës shoqërore në konvikte janë: zbatimi i kushteve të konviktit, interesimi për pastërtinë e shëndetit, respektimi i të drejtave të të tjerëve dhe marrëdhëniet e mira me të gjithë ata që banojnë në konvikt.

Pyetje

- 1- Cilat janë frytet dhe mirësitë që përfiton njeriu kur e lexon a e këndon Kur'anin dhe kur e mëson atë përmendsh?
- 2- Cilat janë kushte që nxënësi duhet t'i zbatojë kur mëson?
- 3- Cila është koha më e mirë për lexim dhe studim?
- 4- Cilat janë rregullat që duhet të zbatojë nxënësi kur hyn në klasë?
- 5- Si duhet ta zgjedhë nxënësi shkollën e tij?
- 6- Përmendni disa rregulla të jetës konviktores.

MARTESA

Martesa dhe krijimi i familjes janë prej etikës së popujve dhe prej zakoneve të hershme. Martesa nuk është vetëm për një popull; ajo është e përgjithshme, për të gjithë popujt gjatë gjithë historisë njerëzore dhe buron nga instikti i natyrës së lindur te njeriu. Sigurisht në këtë të përbashkët ka edhe dallime, të cilat rrjedhin si pasojë e ndryshimit të zakoneve familjare a shoqërore dhe e kulturës së çdo kombi. Sheriati islam interesohet shumë për ndërtimin e famijes, për jetën bashkëshortore dhe për marrëdhëniet e prindërve me fëmijët e tyre. Në këtë mësim dhe në mësimin e ardhshëm do të flitet për rëndësinë e martesës, për të drejtat bashkëshortore dhe për porositë e Sheriatit islam në zbatimin dhe në forcimin e rregullave të caktuara për martesën dhe familjen.

Pozita e martesës dhe vlera e saj

Në Sheriat, martesa zë vend të veçantë. Ai e quan martesën faktor kryesor për zhvillimin dhe përparimin e njeriut. Martesa është e pëlqyeshme dhe e pashmangshme, por ajo arrin gati në nivelin e uaxhib (detyrimit). Për këtë po përmendim disa ajete të Kur'anit dhe hadithet e Profetit Muhammed (s.a.u.s.).

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”** (Sure “Err Rrum”, ajeti 21)

Dhe: **“Dhe i martoni të pamartuarat (të pamartuarit), edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton me mirësitë e Tij. All-llahu është Bujar i madh, i Gjithëditur.”**

(Sure “En Nur”, ajeti 32)

Dhe: **“O ju njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burrra e shumë gra. Dhe, kijeni frikë All-llahun, që me emrin e të Cilit përбетoheni, ruajeni farefisn, se All-llahu është Mbikëqyrës mbi ju.”**

(Sure “En Nisa”, ajeti 1)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Martesa është synneti im. Ai që e kundërshton synnetin tim nuk është prej nesh.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 220.)

Dhe: **“Kush e kundërshton synnetin tim nuk është prej nesh. Prej synnetit tim është edhe martesa. Ai që më do mua, të zbatojë synnetin tim.”**

(Sabihu i Buhariut, 7.)

Dhe: **“Ai që nuk martohet prej frikës së varfërisë, nuk është prej nesh.”**

(Sabihu i Buhariut, 7.)

Po me këtë kuptim ka thënë: **“Ai që nuk martohet prej frikës së varfërisë, ka paramenduar keq për All-llahun.”**

(El Kafij, vëll. 5 f. 330.)

Dhe: **“Më të mirët e ymmetit tim janë të martuarit dhe më të këqijtë e ymmetit tim janë beqarët.”**

(Biharul Anuar, vëll. 103 dhe El Mustedrek, vëll. 14, f.156.)

Dhe: **“Të këqinjtë tuaj janë beqarët. Dy rekatë namaz që i fal i martuari janë më të dobishëm se sa shtatëdhjetë rekatë që i fal beqari.”**

(Kenzul Ummal, hadithi / 44448.)

Dhe: **“Më të këqijtë e të vdekurve tuaj kanë qenë beqarët.”**

(Biharul Anuar, vëll.100, f. 220.)

Dhe: **“Gjumi i të martuarit është më i mirë sesa ndenjqa zgjuar e beqarit duke u falur natën dhe duke agjëruar ditën.”**

(Biharul Anuar, vëll.100, f. 221.)

Dhe: **“Foleja më e dashur që ndërtohet në islam është martesë.”**

(El Mustedrek, vëll. 14, f. 152.)

Dhe: **“Ai që martohet, ka mbrojtur gjysmën e fesë së tij; prandaj t’i frikësohet All-llahut për gjysmën tjetër.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 219, kapitulli 1.)

Dhe; **“Kur një njeri martohet në moshë të re, djalli bërtet: “O i mjeri unë, ai e ruajti gjysmën e fesë.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /44441.)

Dhe: **“Ai që martohet, ka kryer gjysmën e adhurimit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 220, kap. 1.)

Dhe: **“Ai që dëshiron ta takojë të pastër e të pastruar All-llahun, të martohet.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 220, kap. 1.)

Dobitë e martesës

Pasi u njohëm me vlerën e martesës dhe rëndësinë e saj nëpërmjet teksteve të bekuara të Sheriatit, do të përmendim dobitë dhe frytet e martesës. Dijetarët e islamit kanë përmendur shumë të mira për martesën duke u përqendruar në tekstet e Sheriatit. Ndër to përmendim:

- 1- E mira e parë e martesës është vazhdimësia e llojit të njeriut dhe qëndrueshmëria e tij. All-llahu (xh.sh.) ka futur te mashkulli dhe te femra ndjenjën e marrëdhënieve seksuale për shumë dobi dhe një ndër to është shumimi. Dëshira e çdo mashkulli dhe femre është që të kenë fëmijë dhe të jenë të lumtur me ta. Në Kur’an përmendet edhe një lutje për këtë: **“Edhe ata që thonë: Zoti ynë, na bëj që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe të pasardhësve tanë e ne na bëj shembull për të devotshmit!”**

(Sure “El Furkan”, ajeti 74)

Kur’ani përmend historinë e Zekerijas (a.s.) për të treguar dëshirën e madhe të njeriut për të pasur fëmijë, ku thotë: **“Përkujto edhe Zekirijane kur iu lut Zotit të vet: Zoti im, mos më lër të vetmuar se Ti je më i miri trashëgues.”** Ne ia pranuan lutjen atij, i dhuruan atij Jahjanë dhe ia përmirësuan bashkëshorten. Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh.

(Sure “El Enbija”, ajetet 89-90)

Në suren Merjem përmendet e shtjelluar kjo dëshirë e njeriut: **“(Ky është) Përkujtim i mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të vet, Zekerijait. Kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët, e tha: Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar. Unë ua kam frikën pasardhësve të mi pas meje (kushërinjë, se do ta humbnin fenë), e bashkëshortja ime është sterile (shterpë). Pra, më fal nga ajo mirësia Jote një pasardhës (një fëmijë)!”**

(Sure “Merjem”, ajetet 2-5.)

All-llahu (xh.sh.) e përgëzoi Zekerijane për lindjen e Jahjait që të ishte vazhdues i gjenezës në jetë dhe të predikonte mesazhin te njerëzit.

- 2- Martesa i forcon njeriut ndjenjën e ndershmërisë, të pastërtisë, të turpit dhe e bën të përkushtueshëm në veten e tij për t’u mbrojtur prej pëshpëritjeve të shejtanit. Në moralin islam thuhet se djalli hyn te njeriu nëpërmjet dy rrugëve kryesore; nëpërmjet zemërimit, dhe epshit.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Rruga më kryesore e djallit është zemërimi dhe femrat.”**

(Gururul Hikem, f. 408.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ushtarët më të rreptë të djallit janë femrat dhe zemërimi.”**

(Biharul Anuar, vëll. 75, f. 246, kap. 23.)

Nëse do krahasojmë zemërimin me epshin, do të shohim se epshi është më i fortë, Pse? Sepse epshi dhe instinkti seksual janë të pranishëm; në ndërgjegje (subkoshiençë) tek të gjithë dhe më gjerë se zemërimi, prandaj epshi është rruga të cilën e përdor më tepër djalli për të mashtruar njerëzit. Sheriati islam e këshillon mashkullin që të mos rrijë në vende të fshehta me një femër që nuk e njeh, sepse djalli do të jetë i treti i tyre. E, martesë e ruan dhe e mbron njeriun prej pëshpëritjeve të djallit. Martesa është ajo që e shuan etjen seksuale të njeriut dhe shkatërron mjetet e djallit. Në një hadith thuhet: **“Ai që martohet, ka mbrojtur gjysmën e fesë së tij.”**

3- Ndjenja e përqendrimit shpirtëror. Lidhja mes dy gjinive dhe jeta e përbashkët nën hijen e Sheriatit i sigurojnë femrës dhe mashkullit qetësinë dhe ngopjen e anës së sentimentalit dhe e mbron njeriun prej mërzitjes, stresit, depresionit dhe vetmisë. Pse? Sepse mashkulli dhe femra kanë në anën e tyre ortakun dhe shokun e jetës dhe ndajnë së bashku të mirën dhe të keqen, gëzimin dhe zemërimin dhe ia lehtësojnë fatkeqësitë njëri-tjetrit. Në fillim të mësimin përmendëm ajetin e bekuar, i cili thotë se martesë është argument prej argumenteve të All-llahut (xh.sh.), sepse martesë mbart në vetvete dashurinë, respektin dhe marrëdhënie të përsosura shpirtërore mes burrit dhe gruas.

4- Nuk ka dyshim se shumica e problemeve të jetës kërkojnë ortakëri dhe bashkëpunim. Martesa e plotëson këtë kërkesë. Njeriu i vetëm nuk mund t'i kryejë të gjitha detyrat; prandaj vjen martesë e cila plotëson bashkëpunimin e përkryer, ndarjen e vështirësive dhe ndarjen e punëve. Burri nisat në sheshin e jetës, punon, sakrifikon e pastaj kthehet në shtëpi dhe e gjen atë si lulishte të gjelbër, të mbushur me ngrohtësi. Lulishtja është gruaja, e cila e pret burrin me buzëqeshje të ndritshme dhe i shtron atij tryezën me ushqimet që atij i pëlqejnë më shumë. Jo vetëm kaq, burri gjen një njeri që e çlodh, që e qetëson, me të cilin bisedon për të tashmen dhe për të ardhmen e jetës së tyre.

Duhet patjetër të kihet parasysh porositë e All-llahut (xh.sh.) për martesën dhe pasurinë. Sa njerëz kanë qenë të varfër para se të martoheshin dhe kur janë martuar, atyre u janë hapur dyert e mirësive të tokës e të qiellit.

5- Martesa është hap i rëndësishëm në rrugën e përsosurisë së njeriut. Jeta bashkëshortore, me që ka shumë përgjegjësi, e lodh më shumë njeriun; por nga ana tjetër, e edukon njeriun në të mira, në dashuri dhe sakrifica. Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“Ai që mundohet për familjen e tij është njësoj si që lufton në rrugën e All-llahut.”**

Dijetarët e Islamit thonë se All-llahu nuk i ka krijuar të plotë as mashkullin e as femrën dhe secili prej tyre është plotësues për tjetrin. Prandaj, nuk mund të arrihet plotësimi e përsosuria veçse nën hijen e martesës dhe me ndërtimin e marrëdhënieve të suksesshme bashkëshortore.

Përmbledhje

Islami e quan martesën dhe formimin e familjes njerëzishmëri, detyrë njerëzore. Martesa dhe familja sigurojnë qetësinë, dashurinë dhe pastërtinë. Martesa i mbron njeriut gjysmën e fesë së tij.

Pyetje

- 1- Përse Kur'ani Famëllartë e quan martesën argument prej argumenteve të All-llahut (xh.sh.)?
- 2- Si i quan Profeti (s.a.u.s.) beqarët e ymmetit të tij?
- 3- Sqaro shkurtimisht dobitë dhe frytet e martesës.
- 4- Cilat janë rrugët më ndikuese të djallit? Ilustrojeni me një hadith të Imam Sadikut (a.s.)
- 5- Përmendni një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.), i cili e lavdëron atë që punon dhe mundohet për familjen e tij.



Mësimi i 12^{-të}

TË DREJTAT BASHKËSHORTORE

Në jetën bashkëshortore ka të drejta dhe detyra të ndërsjellta, të cilat u garantojnë të dyja palëve jetën e përbashkët e të mbushur me lumturi e dashuri. Duhet që si mashkulli, ashtu edhe femra të njihen me të drejtat dhe detyrat e tyre.

Detyrat e gruas ndaj burrit

- a- Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: “Një grua shkoi te Profeti (s.a.u.s.) dhe e pyeti: **“Cilat janë të drejtat e gruas kundrejt burrit?”** Profeti (s.a.u.s.) iu përgjigj: **“Ta respektojë e të mos e kundërshtojë atë, të mos japë asgjë të shtëpisë pa lejen e tij, të mos agjërojë agjërim vullnetar vetëm me lejen e tij, të mos e ndalojë atë nga vetja e saj edhe nëse ndodhet mbi shpinën e **katb** dhe të mos dalë prej shtëpisë pa lejen e tij.”** Përsëri ajo e pyeti: **“O i dërguari i All-llahut, cilët janë njerëzit që kanë më shumë detyra ndaj mashkullit?”** Ai iu përgjigj: **“Prindërit e tij.”** Edhe një herë e pyeti: **“Cilët janë njerëzit, ndaj të cilëve burri ka më shumë detyra ndaj gruas?”** Ai u përgjigj: **“Bashkëshorti i saj.”** (*Mekarimul Ahlak i Tabarsij, f. 214.*)
- b- Prej të drejtave të gruas ndaj burrit të saj është që ajo të ketë mendim të njëjtë me të në dy çështje:

E para: Ana morale. Të zgjedhë për bashkëshort atë njeri i cili ka morale të pëlqyera, sepse, nëse burri do të jetë me moral të keq, atëherë jeta bashkëshortore do të bëhet shumë e vështirë. Përderisa këtu po flitet për të drejtat e gruas ndaj burrit, duhet që gruaja të përpiqet të krijojë harmoni me burrin e vet dhe të durojë në rast se ai ka moral të keq. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Atë grua, që duron ndaj moralit të keq të burrit të saj, All-llahu do ta shpërblejë me shpërblimin e Asijes, bijës së Muzahimit (gruaja e Faraonit).”**

(*Mekarimul Ahlak, f.213.*)

Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“S’ka dyshim se All-llahu (xh.sh.) e ka caktuar xhihadin si për burrin, ashtu edhe për gruan. Xhihadi i burrit është të japë pasurinë e tij, gjakun e tij dhe jetën e tij në rrugën e All-llahut. Xhihadi i gruas është të durojë ndaj moralit të keq të burrit të saj dhe ndaj xhelozisë së tij.”**

(*Mekarimul Ahlak, f. 215.*)

Dhe: **“Xhihadi i gruas është bashkëjetesa e mirë me burrin e saj.”**

(*Mekarimul Ahlak, f.215.*)

E dyta: Të marrë pjesë dhe ta përkrahë bashkëshortin në situata të vështira, të durojë në fatkeqësi dhe të mos i kërkojë burrit të saj tej mundësive të tij, pra, ta ndihmojë atë atë kur është në vështirësi dhe t’ia lehtësojë vuajtjet.

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Asaj gruaje, që nuk është zemërbutë me burrin e saj dhe e detyron në ato që ai nuk ka mundësi, nuk i pranohen punët dhe All-llahu do të jetë i zemëruar prej saj.”**

(*Mekarimul Ahlak*)

Dhe: **“Asaj gruaje, që e fyen burrin e saj me fjalë, All-llahu nuk ia pranon as barazinë, as drejtësinë, as punët e mira që bën, derisa ai ta falë e të jetë i kënaqur prej saj. Edhe nëse ajo falet gjithë natën e agjëron ditën, liron robër dhe i hipën kalit në rrugën e All-llahut, do të jetë e para që do të hyjë në Xhehenem.”**

(*Mekarimul Ahlak.*)

- c- Gruaja duhet të zbukurohet e të parfumoset vetëm për burrin e saj. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, të venë shamitë mbi krahatorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveçse burrave të vet...”**

(*Sure “En Nur”, ajeti 31.*)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Asaj gruaje, që parfumoset për të tjerët e jo për burrin e saj, nuk i pranohet namazi derisa ta pastrojë atë parfum, njësoj siç pastrohet prej xhynybit.”**

(*Mekarimul Ahlak, f. 215.*)

ç- Nuk lejohet që gruaja të largohet nga shtëpia e saj pa lejen e bashkëshortit. Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“Për atë grua që del nga shtëpia e saj pa lejen e bashkëshortit të vet, nuk ka shpenzime (nefekatu) derisa të kthehet.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 215.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ajo grua që shkon diku pa lejen e burrit të vet, është e mallkuar, derisa të kthehet.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 215.)

Detyrat e burrit ndaj gruas

Edhe burri ka detyra kundrejt gruas së tij. Një pjesë e tyre janë materiale, kurse pjesa tjetër, morale. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Xhebraili më ka porositur aq shumë për femrën, sa që mendoj se nuk duhet divorcuar, vetëm nëse kryen imoralitet të madh.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 216.)

Më poshtë po përmendim disa detyra të burrit ndaj gruas.

a- Burri duhet t'i sigurojë bashkëshortes së tij ushqim, veshmbathje, vendbanim etj. Për të drejtat e burrit ndaj bashkëshortes së tij Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ta ushqejë, ta veshë dhe nëse ajo bën diçka me pa vetëdije, ta falë.”** (*Mekarimul Ahlak*; f. 216.)

b- Në librin **“Risaletul Hukuk”** (Mesazhet e të drejtave), të Imam Zejnul Abidin (a.s.) thuhet: **“Përsa i përket së drejtës së bashkëshortes, duhet ta dish se All-llahu (xh.sh.) e ka bërë atë qetësim dhe shoqërim për ty. Dije se ajo është mirësi prej All-llahut Fuqiplotë për ty; prandaj respektoje e nderoje atë, tregohu i butë me të edhe nëse ti ke të drejtë. Të drejtat e saj kundrejt teje janë që ta mëshirosh, sepse ajo është amaneti yt. Ta ushqesh atë, ta veshësh atë dhe kur gabon, t'ia falësh gabimin.”**

(*Biharul Anuar*, vëll. 71, f.4, kap. 1.)

c- Burri duhet ta trajtojë bashkëshorten e tij me dashuri dhe respekt.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur bashkëshorti i thotë bashkëshortes së tij “unë të dua shumë”, kjo fjalë nuk i del kurrë nga zemra.”**

(*El Uesail*, vëll. 20, f. 23, kap. 3.)

Dhe: **“Atë, që duron ndaj moralit të keq të gruas së tij, All-llahu do ta shpërblejë njësoj siç shpërbleu Ejubin për sprovat e tij.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 213.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“S’ka dyshim se njeriu ka nevojë për tri gjëra në shtëpinë dhe familjen e tij dhe t’i zbatojë edhe nëse nuk janë në natyrën e tij: bashkëjetesa e mirë, zemërgjerësia në caktim dhe xhelozia që e mbron.”**

(*Biharul Anuar*, vëll. 75, f. 235, kap. 23.)

d- Bashkëshorti duhet të mos jetë i ashpër me bashkëshorten e tij.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Burrat më të mirë të ymmetit tim janë ata të cilët nuk e zemërojnë familjen e tyre, e duan atë, nuk i bëjnë padrejtësi asaj.”** Pastaj Profeti (s.a.u.s.) ka kënduar ajetin: **“Er rixhalu kauamune ala nisai.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 217.)

Në hadithet e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet se është e ndaluar që bashkëshorti ta keqtrajtojë bashkëshorten e tij e të sillet ashpër me të. Nëse e bën këtë All-llahu nuk do t'ia pranojë atij punët e mira. Ai (s.a.u.s.) ka thënë: **“...Po ashtu edhe burri, nëse është i padrejtë ndaj gruas.”**

(*Men la jehderuhul fakih*, f. 15.)

Përmbledhje

Islami ka caktuar të drejta dhe detyra për gruan dhe për burrin. Islami garanton jetën bashkëshortore, pastërtinë dhe përqendrimin e kërkuar. Po ashtu, ndarja e punës dhe detyrat e secilit janë një tjetër faktor forcues i marrëdhënieve bashkëshortore. Marrëdhëniet bashkëshortore sigurojnë qetësinë dhe lumturinë e familjes myslimane në këtë jetë dhe shpërblimin e premtuar për Xhennet nga All-llahu (xh.sh.) në Jetën tjetër.

Pyetje:

- 1- Cilat janë detyrat e gruas kundrejt burrit të saj?
- 2- Sqaroni shkurtimisht xhihadin e gruas.
- 3- Cilat janë detyrat e burrit kundrejt gruas së tij?
- 4- Cilët janë burrat më të mirë? Përgjigjuni duke përmendur një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.).



Në Sheriatin islam ka rregulla për punën dhe për përpjekjet për sigurimin e jetesës. Në këtë mësim do të trajtojmë vlerat e punës dhe në mësimin e ardhshëm do të sqarojmë rregullat e saj.

Për vlerën e punës dhe të përfitimeve jetësore, gjejmë dy grupe ajetesh dhe hadithesh. Grupi i parw lavdëron punën dhe punëtorët; grupi i dytë kritikon grumbullimin e pasurisë dhe që nuk shpenzohet aty ku duhet shpenzuar.

Grupi i parë

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim.”**

(Sure “En Nebe”, ajeti 11.)

Dhe: **“A nuk e kanë të qartë ata që e trashëguan tokën pas banorëve të saj (që u shkatërruan) se, nëse dëshirojmë Ne, i godasim (i dënojmë) për mëkatet e tyre, ua mbyllim zemrat e tyre dhe ata nuk dëgjojnë (këshillat)?”**

(Sure “El A’raf”, ajeti 100.)

Të dy ajetet përmbajnë mirësinë e All-llahut për robtë e Tij. Kjo mirësi është dita dhe toka - për të punuar dhe për të siguruar mjetet e jetesës.

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ka mëkate që mund të falen vetëm sepse kërkon dhe siguron mjetet e jetesës.”**

(Ihjaul Ulumi Dijn, kap. i rregullave të fitimit dhe të jetesës.)

Dhe: **“Në Ditën e Gjykimit, tregtari i vërtetë e i ndershëm, do të bashkohet me të drejtët dhe me dëshmorët.”**

(Sunenu Termidhij, vëll. 5.)

Dhe: **“Ai që e jeton këtë jetë me hallall e me ndershmëri, përpiket për familjen e vet dhe e do fqinjin e tij, do ta takojë All-llahun me fytyrë të ndritur si hëna e plotë.”**

(El Kafij, vëll. 5 dhe Mustedrekul Uesail, vëll. 13, f. 53.)

Në jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) tregohet se një ditë, ai së bashku me disa shokë të tij kaluan pranë një djali të ri e të fuqishëm; djali po punonte me zell e përkushtim. Shokët i thanë Profetit (s.a.u.s.): **“Mjerë ai! Sikur të ishte në luftë në rrugën e All-llahut (xh.sh.)!”** Profeti (s.a.u.s.) u tha: **“Mos flisni kështu! Ai përpiket për veten e tij, që mos ketë nevojë për njerëzit. Edhe ai është në rrugën e All-llahut (xh. sh.). Nëse ai punon e përpiket për prindërit dhe për familjen e vet, që t’i pasurojë e të mos ketë nevojë për njerëzit, është në rrugën e All-llahut. Nëse punon për t’u mburrur e për të gumbulluar pasuri, është në rrugën e shejtanit.”**

(Ihjaul Ulumi Dijn, kap. i rregullave të fitimit dhe të jetesës.)

Transmetohet se Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: “Në haxhin e Lamtumirës”, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, Xhebraili më frymëzoi në mendjen time se askush nuk do të vdesë pa iu plotësuar risku i tij. Prandaj, kijeni frikë All-llahun (xh.sh.) dhe bëhuni të ndershëm në kërkimin e riskut! Mos e kërkonit riskun duke bërë mëkat, sepse All-llahu i ka ndarë risqet në mesin e robve me hallall dhe nuk i ka ndarë me haram...”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 80)

Transmetohet se një ditë Muhammed ibn El Mukender kishte dalë në rrethinat e Medines. Ishte ditë shumë e nxehtë. Ai pa Ebu Xha’ferin, (Imam Bakirin) (a.s.), i cili po punonte në arën e vet. ibn Mukender tha me vete: **“Për All-llah, do ta këshilloj.”** U afrua dhe i tha: **“Zoti të udhëzoftë! Më i dituri i kurejshëve (për kohën e tij) po kërkon dynjanë në këtë orë?! A nuk ke frikë se të vjen meleku i vdekjes e të gjen në këtë gjendje?”** Imami iu përgjigj, ndërsa djersët i rridhnin si çurg: **“Për All-llah, sikur të më vijë meleku i vdekjes e të më gjejë në këtë gjendje, ai do të më gjejë duke iu përlur All-llahut se unë punoj për veten time dhe për familjen time, për të mos pasur nevojë as për ty e as për njerëzit e tjerë. Unë i frikësohem ardhjes së melekut të vdekjes dhe më gjen duke i bërë mëkat All-llahut (xh.sh.).”** Pasi dëgjoji fjalët e Imamit, ibn Mukenderi uli kokën dhe tha: **“Zoti të mëshiroftë, o Ebu Xha’fer, Desha të të këshilloja, por je ti që më këshillove.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 73.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Nëse një njeri është në vështirësi dhe punon në hallall për të siguruar kafshatën për veten dhe për familjen e vet, ai është njësoj si muxhahidi në rrugën e All-llahut.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 88.)

Dhe: **“Ai që përpiqet për familjen e tij është si muxhahidi në rrugën e All-llahut.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 88.)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“I mallkuar është ai që nevojat e tij i kërkon te njerëzit e tjerë.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 88.)

Grupi i dytë

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nuk më është shpallur e më thënë "grumbullo pasuri e bëhu prej tregtarëve", por më është thënë: lartësoje Zotin tënd dhe bëhu prej atyre që bien në sexhde dhe adhuroje All-llahun tënd derisa të të vijë vdekja!”**

(Biharul Anuar, vëll. 69, f. 47, kap. 94.)

Dhe: **“Shtojeni kërkimin e faljes, sepse kërkimi i faljes shton mirësitë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 21, kap. 1.)

Dhe: **“Vërtet, All-llahu e frymëzoi Daudin (a.s.) dhe i tha: “Atij që më adhuron Mua, Unë do t’i jap.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 22, kap. 2.)

Dhe: **“Vërtet, All-llahu e ka bërë dynjanë për të punuar për Ahiretin dhe nuk e ka bërë Ahiretin për të punuar për dynjanë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 25, kap. 2.)

Transmetohet se Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Risku është dy llojesh: kërkues dhe i kërkuar. Atë, që kërkon dynjanë, e kërkon vdekja, derisa të ikë nga kjo jetë. Atë, që kërkon Ahiretin, e kërkon dynjaja, derisa të mjaftohet me riskun e tij.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 38, kap. 2.)

Në këtë grup thëniesh, disa njerëz ndoshta mund të dalin në përfundimin se besimtarët duhet të bëjnë vetëm adhurim e lutje dhe ta lënë punën, tregëtinë dhe përpjekjet për të gjetur riskun. Disa mund të mendojnë; përderisa namazi është shkak i riskut, atëherë përse duhet puna? Ose: Kur lexojmë thënien e **Profetit Muhammed (s.a.u.s.) “All-llahu e jep dynjanë për Ahiretin.”**, përse mos bëjmë vetëm adhurim, e të mos punojmë, sepse për riskun sipërmarrësi është All-llahu Fuqiplotë. Por nëse këto tekste do t’i vendosim në anë të atyre teksteve që përmendëm në grupin e parë, do të shohim se Islami e lavdëron punën dhe përpjekjen në rrugën e sigurimit të mjeteve të jetesës për vete dhe për familjen. Edhe pse punët nëpër dikastere të ndryshme shpërblehen nga Bejtul Malë (thesarbajtësia), Sheriati e nxit njeriun që të ushqehet me dorën e tij.

Imam Sadiku (a.s.) na përcjell se Imam Aliu (a.s.), ka thënë: **“All-llahu e frymëzoi Daudin (a.s.) duke i thënë: “Nëse nuk ushqehesh prej Bejtul Malit dhe punon me duart e tua, vërtet do të jesh rob i mirë.” Daudi (a. s.) qau dyzet mwingjese. All-llahu (xh.sh.) e frymëzoi (urdhëroi) hekurin: Bëhu i butë për robin tim, Daudi! All-llahu i zbreti Daudit hekurin dhe Daudi prodhonte çdo ditë nga një mburojë dhe e shiste për 1000 derhem. Ai prodhoi treqind e gjashtëdhjetë mburoja dhe i shiti për treqind e gjashtëdhjetë mijë derhem. Kështu ai nuk kishte më nevojë për Bejtu Malin.”**

(El Kafij, vëll. 5, f.74.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) dhe Ehli Bejti, përveç përgjegjësisë që kishin për udhëzimin e njerëzve, punonin edhe në ara. Atë që e përbuz islami është:

E para; Tejkalmi jashtë kufijve, deri në atë masë, sa njeriu të humbasë ekuilibrin. Për këtë, Profeti (s.a.u.s.) i fton njerëzit që të jenë të vetëpërmbytur në kërkimin e riskut. Ai ka thënë: **“Më i miri i njerëzve është ai që merr nga dynjaja ato që i mjaftojnë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 27, kap. 2.)

E dyta: Grumbullimi i pasurisë mos jetë synimi i parë e i fundit i njeriut e të harrojë Ahiretin. E kanë pyetur Imam Sadikun (a.s.) për kuptimin e ajetit **“Rixhalun la tulhihim....”** e ai është përgjigjur: **“Ata ishin tregtarët, të cilët e linin tregtinë kur vinte koha e namazit. Ata kanë shpërblim më të madh sesa ata që tregtojnë (në kohën e namazit).”**

(El Kafj, vëll. 5, Biharul Anuar, vëll. 64, f. 274.)

Në jetëshkrimin e Profetit (s.a.u.s.) thuhet se kur zbriti ajeti: **“... E kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë dhe i jep prej nga nuk e kujton fare. Kush i mbështetet All-llahut, All-llahu i mjafton atij; All-llahu e përmbush dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin). (sure “Et Tallak”, ajetet 2 -3),** disa myslimanë u mbyllën në shtëpitë e tyre dhe filluan të bënin vetëm ibadete, duke thënë (na mjafton). Kur Profeti (s.a.u.s.) u vu në dijeni për këtë veprim të tyre, shkoi tek ata dhe u tha: **“Mjerë ju për atë që bëtë!”** Ata i thanë: **“O i dërguar i All-llahut, All-llahu e ka marrë përsipër riskun tonë dhe ne po e adhurojmë.”** Ai u tha: **“Atij që vepron kështu, nuk i pranohen lutjet; prandaj duhet të punoni.”**

(El Kafj, vëll. 5, f. 84.)

Përmbledhje

Sheriati islam e lavdëron punën, nxit për të punuar dhe i quan punën dhe përpjekjet për të siguruar jetesën xhihad, luftë në rrugën e All-llahut. Atyre që përpiqen për të siguruar bukën e gojës për veten e tyre dhe për familjen e tyre, All-llahu u ka premtuar shpërblim të madh në Ditën e Gjykimit.

Pyetje

- 1- Sqaroni vlerën e punës e të sigurimit të mjeteve të jetesës.
- 2- Çfarë kuptoni nga fjalimi i Profetit (s.a.u.s.) në Haxhin e Lamtumirës?
- 3- Çfarë do të thotë “ixhmali” në kërkimin e riskut? Sqarojeni shkurtimisht.
- 4- Çfarë roli luan devotshmëria kur kërkojmë jetesën?

Mësimi i 14^{të}

RREGULLAT E PUNËS E TË FITIMIT TË TË ARDHURAVE

Më parë mësuam se islami e lavdëron punën dhe punëtorët. Puna ka pozitën e xhihadit, të luftës në rrugën e All-llahut. Në këtë mësim do të njihemi me rregullat e punës dhe me kufijtë e saj.

Kjo njohje do të na japë mundësi të zbulojmë se punë e saktë është ajo në të cilën nuk ka haram e mëkat. Më pas do të njihemi me bazat e fitimit të të ardhurave hallall dhe çfarë dëshiron All-llahu prej robve të Tij kur përpiqen për të siguruar të ardhurave.

A- Fikhu i punës

E para që duhet të merret në konsideratë në tregti e në bashkëpunime të ndërsjellta janë rregullat e Sheriatit. Në Sheriatin islam ka tregti a bashkëpunime të ndërsjellta që janë të ndaluara. Ky Sheriat sqaron, gjithashtu më së miri të drejtat e shitësit e të blerësit. Është detyrë që të njihen rregullat e Sheriatit që kanë të bëjnë me çdo punë, nëpërmjet së cilës sigurohen të ardhurat. Po ashtu, është detyrë që këto rregulla të zbatohen, që të mos shkelen të drejtat e njerëzve e të mos veprohet harami.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai që tregon pa dituri, përballet me mëkatën.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 93, kap. 1).

Dhe: **“Ai që tregon pa i ditur rregullat e tregtisë, përballet me kamatën. Në treg të qëndrojnë ata që dinë të shesin e të blejnë.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 154.)

El Asbag ibn Nabateh ka transmetuar: **“E kam dëgjuar Imam Aliun në minber të thotë: “O tregtarë! Dija, pastaj tregtia; dija, pastaj tregtia. Për All-llah, kamata në këtë ymmet do të jetë më e ngadaltë se sa ecja e milingonës përmbi Safa. Mbroni pasuritë tuaja me sadeka! Tregtari i paditur ka devijuar dhe i devijuari do të hyjë në Zjarr, me përjashtim të atij tregtari që merr me drejtësi dhe jep me drejtësi.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 154.)

Pra, para se të fillohet tregtia a çfarëdolloj bashkëveprimi i ndërsjellë, është detyrë të njihen rregullat e Sheriatit që kanë të bëjnë me bashkëveprimet reciproke, të sqaruara më shumë në “Resail el Amelijeh” dhe në librat e jurisprudencës.

B- Largimi prej monopolit

Puna më e shëmtuar që bëjnë disa tregtarë është se ata blejnë disa mallra që janë parësore e të domosdoshme për t’u konsumuar nga njerëzit dhe i fshehin nëpër magazina a depo, me qëllim që të rritet vlefata e tyre dhe t’i nxjerrin në treg shkalë-shkallë. Duke përfutur nga nevoja e njerëzve për mallra të tilla, ata i shesin me çmim më të shtrenjtë e fitojnë kështu të ardhura kolosale.

Monopoli është agresion për njerëzit dhe ky është veprim i padrejtë dhe çdo padrejtësi është e ndaluar. Në shumë thënie të tij, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) e ka kundërshtuar monopolin dhe e ka ndaluar atë.

Profeti (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që e fsheh mallin dyzet ditë, është armik i All-llahut dhe All-llahu është armik i tij.”**

(Ihjaul ulumi dijn; rregullat e fitimit e të bashkëjetesës.)

Transmetohet se Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Atij, që e fsheh mallin dyzet ditë, i ngurtësohet zemra.”**

(Ihjaul ulumi dijn; rregullat e fitimit e të bashkëjetesës.)

Duke kundërshtuar këtë vepër të padrejtë,

Atëherë, tregtarët besimtarë duhet t’i largohen monopolit. Në disa rrëfime thuhet së një tregtar kishte një veqil në qytetin e Basras. Tregtari, herë pas here i dërgonte atij mallra që t’i shiste në tregjet e qytetit. Një here, tregtari i dërgoi veqilit një kamion me grurë dhe i shkroi që sa të mbërrinte gruri, ta nxirrte menjëherë në treg dhe ta shiste me çmimin e ditës. Kur mbërriti gruri, disa shokë i thanë veqilit: *“Sikur ta lësh për nesër shitjen e grurit, sepse nesër është e xhuma dhe fitimi yt do të jetë më i madh!”* Veqili i dëgjoi fjalët e shokëve të tij dhe e vonoi nxjerrjen e grurit në treg një ditë. Kur e shiti të gjithë grurin, fitoi shumë. Ai i shkroi tregtarit se si kishte vepruar dhe sa kishte fituar. Tregtarin, i cili ishte besimtar, e zemëroi shumë lajmi që i erdhi nga veqili dhe i shkroi:

“Vërtet, ti bindeshe me fitime të pakta dhe ishe besimtar i mirë. Çfarë dobie sjellin fitimet e shumta kur e pakësojnë besimin? Vërtet, i ke bërë padrejtësi vetes sate dhe më ke bërë padrejtësi edhe mua tek All-llahu. Prandaj, të gjitha ato para që fitove, shpërdaj tek të varfrit e Basras dhe te nevojtarët e saj, sepse, ndoshta me këtë veprim All-llahu na fal ty dhe mua.”

(Ihjaul ulumi dijn; rregullat e fitimit e të bashjëjetës.)

C- Lutja dhe përmendja e All-llahut (xh.sh.)

Në porositë dhe këshillat e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) dhe të Imamëve të Ehli Bejtit (a.s.) thuhet se kur të niset tregtari për në treg, të përmendë All-llahun (xh.sh.), ta fillojë punën me emrin e All-llahut dhe gjithmonë ta kujtojë All-llahun e të mos jetë i pavëmendshëm ndaj Tij. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që e përmend me çiltërsi All-llahun në treg, kur njerëzit janë të pavëmendshëm ndaj asaj që përmend Libri (Kur’ani), All-llahu do t’i japë atij një mijë të mira dhe do ta falë në Ditën e Gjykimit me atë falje që askush nuk e mendon.”**

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 102, kap. 1.)

Në një lutje të Imam Bakirit (a.s.) thuhet: **“O Zot, unë të drejtohem që të japësh të mirat e tregut e të tregtarëve.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 155.)

Kur të ulet për të lidhur ndonjë aktmarrëveshje tregtari të thotë: **“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, i Vetëm i Pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij dhe i dërguari i Tij. O Zot, unë të kërkoj Ty të më mirësosh me hallallin (të lejueshmen). Të kërkoj Ty që të mos bëj padrejtësi dhe të mos më bëhet padrejtësi. Të kërkoj mbrojtje Ty prej aktmarrëveshjes dëmprurëse e humbëse dhe prej betimit të rremë.”**

(El Kafij, vëll. 5, f. 155.)

S’ka dyshim se prej cilësive të rëndësishme të tregtarëve besimtarë është që profesioni i tyre a aktmarrëveshjet që lidhin, të mos e largojnë nga përmendja e All-llahut dhe nga kryerja e detyrave fetare. Në mësimin e shkuar u tha se All-llahu i bekon dhe i mbarëson ata, të cilët as tregtia e as ndonjë profesion tjetër nuk e shtynë që të harrojnë All-llahun (xh.sh.). Pa dyshim, islami e kundërshton betimin e rremë me qëllim që njëra palë të bindë palën tjetër, qoftë për shitje apo për blerje të mallit të ekspozuar. Betimi i rremë nuk është i ndaluar vetëm në shitblerje, por në të gjitha çështjet e jetës.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“E, mos e bëni All-llahun peng të betimeve tuaja (kur betoheni në Te), kur doni të bëni vepra të mira, të silleni mirë dhe të bëni pajtim ndërmjet njerëzve. All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di.”**

(Sure “El Bekare”, ajeti 224.)

Betimi për çështje materiale dhe për përfitime të kufizuara të kësaj jete është i palejueshëm.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që shet dhe blen të ruajë pesë cilësi, përndryshe as mos shesë e as mos blejë. Ato pesë janë; të mos marrë kamatë, të mos bëjë be, të mos fshehë të metat e mallit dhe të falënderojë All-llahun kur shet dhe të mos përbuzë kur blen.”**

(Biharul Anuar; vëll. 100, f. 95, kap. 1.)

Transmetohet se Imam Kadhimi (a.s.) ka thënë: **“Në Ditën e Gjykimit All-llahu nuk i sheh tre njerëz dhe njëri prej tyre është ai i cili e bën All-llahun mall në shitje. Ai nuk shet vetëm duke u betuar dhe nuk blen vetëm duke u betuar.”**

(El Kafij; vëll. 5, f. 162.)

Ç- Përmendja e të metave të mallit

Prej rregullave të shitjes është që të mos fshihen të metat e mallit të ekspozuar. Ai që e bën këtë, ka mashtruar në bashkëpunim. Sheriati islam e ka ndaluar rreptësisht mashtrimin në tregti. Në

jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: “Një ditë, Profeti (s.a.u.s.) kaloi pranë një tregtari që po shiste grurë. Kur e pa nga jashtë, Profeti (s.a.u.s.) i pëlqeu gruri. U afrua pranë tregtarit dhe kapi një dorë me grurë. Kur e kapi, vuri re se gruri ishte i lagur. Profeti (s.a.v.s.) e pyeti: **“Përse gruri është i tillë?”** Tregtari iu përgjigj: **“E ka lagur shiu.”** Profeti e ndaloj që ta shiste grurin e lagur. Pastaj tha: **“Kush mashtron nuk është prej nesh.”**

(Sabihu i Myslimit, vëll. 1.)

D- Drejtësia në shitblerje

Edhe kjo është prej rregullave dhe detyrave që duhet të zbatohet në tregti. Nuk lejohet të shfrytëzohet nevoja që ka blerësi për një mall që t’i shitet me çmim më të lartë. Po ashtu, nuk lejohet të shfrytëzohet nevoja që ka shitësi dhe malli t’i blihet me çmim më të ulët sesa vlefë reale. Kjo është padrejtësi dhe nuk lejohet në Sheriat, pra është haram.

Në jetëshkrimin e Imam Sadikut (a.s.) transmetohet: Një ditë, Imami e ftoi shërbyesin e tij, Musadefin dhe i tha: “Përgatitu të udhëtosh në Egjipt, sepse familja janë shtuar. Musadefi përgatiti mallin dhe u nis së bashku me tregtarët për në Egjipt.

Musadefi u kthye nga Egjipti. Në dorë mbante dy qese me derhemë. Në çdo qese ishin njëmijë derhemë. Musadefi i tha Imami: “U bëfsha fljëm për ty! Ky është kapitali i parave të tua dhe ky është fitimi. Imami, pasi u njoh me ngjarjen, i tha: “SubhanAll-llah (I lartësuar është All-llahu)!” Më pas, mori një qese dhe tha: “Këto janë paratë e mia dhe nuk kam nevojë për fitimin.” Pastaj shtoi: “O Musadef, vrasja me shpatë është më e lehtë sesa kërkimi i hallallit (i së lejueshmës).

(Biharul Anuar, vëll. 47, f. 59, kap. 4.)

DH- Toleranca me të varfërit

Prej rregullave islame të tregtimit është interesimi për të varfrit dhe nevojtarët e tolerance me ta. Hadithet e nderuara flasin për butësinë ndaj kësaj shtrese. Tregtarët duhet të bashkëpunojnë me të varfrit me atë mënyrë që të mos u thyhet zemra dhe të mos kthehen duarzbrazët në familjet e tyre. Të tolerohet me ta në çmime, ose t’u shitet atyre me këste, sipas mundësisë së tyre ekonomike.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“All-llahu e mëshiroftë atë njeri që toleron në shitje, lehtëson në blerje, lehtëson në gjykim dhe në kwrkimin e gjykimin.”**

(El Uesail, vëll. 17, f. 450, kap. 42.)

E- Largimi prej mashtrimit

Paraqitja e mallit falco, apo i skaduar, bashkëpunimi me para fallse janë tradhti, mashtrim dhe vjedhje. Prandaj, duhet t’i shmangemi mashtrimit në bashkëpunime.

Ata që e hedhin mallin e prishur dhe e pranojnë humbjen materiale, duke ruajtur kështu amanetin dhe për të mos mashtruar të tjerët, pa dyshim, janë njerëz zemërbardhë, të pastër, të çiltër dhe shpirtlartë.

Përmbledhje

Në Islam ka rregulla për punën, për përpjekjet dhe për fitimin e të ardhurave materiale. Është detyrë që këto rregulla të zbatohen nga çdo mysliman. Këto rregulla janë pasuese të parimeve morale e ligjore (Sheriatit). Edhe për blerësin, edhe për shitësin ka rregulla, të cilat secila palë duhet t’i zbatojë, me qëllim që bashkëpunimi i ndërsjellë të jetë në përputhje me moralin dhe Sheriatin.

Pyetje

- 1- Përse Imamët e nderuar e quajnë parësor fikhun para tregtisë?

- 2- Përse islami e quan monopolin veprim të shëmtuar e të ndaluar?
- 3- A lejohet betimi gjatë shitblerjes?
- 4- Sqaroni shkurtimisht detyrat e shitësit.



Mësimi i 15^{të}

PASTËRTIA (1)

Pastërtia është prej etikës kryesore në Sheriatin islam. Islami interesohet shumë për pastërtinë e trupit, të rrobave, të shtëpisë etj. Islami nxit të përdoret mis'uaku, të krihen dhe shkurtohen flokët, të priten thonjtë dhe të mbahet pastër mjedisi.

Nuk lejohet që mjediset të ndoten. Nuk lejohet neglizhenca për pastrimin vetjak, papastërtia e trupit tënd mund të shqetësojë të tjerët.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, All-llahu është i pastër dhe e do pastërtinë. All-llahu është i këndshëm dhe e do të këndshmen.”**

(Sunenu Termidhij, vëll. 10.)

Dhe: **“Pastërtia është pjesë e besimit.”**

(Kenẓul Ummal, hadithi / 25998.)

Dhe: **“E para gjë për të cilën njeriu do të japë llogari është pastërtia.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 25998.)

Dhe: **“Pastrohuni me sa të mundeni! Vërtet, All-llahu e ngriti islamin mbi pastërtinë dhe në Xhennet do të hyjnë vetëm të pastërtit.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 25998.)

Dhe: **“Islami është i pastër, prandaj pastrohuni, sepse në Xhennet do të hyjnë vetëm të pastërit.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 25998.)

Dhe: **“All-llahu e do adhurimin qw bwet me pastwrti e pastër.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 25998.)

Transmetohet se Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Prej moralit të të dërguarëve është pastërtia.”**

(Biharul Anuar, vëll. 75, f. 335, kap. 26.)

Një pjesë e pastërtive të myslimanit janë të detyrueshme, sepse ndryshe, nuk mund të kryhen adhurimet. Ato janë; abdesi, gusuli, tejemumi. Këto sqarohen në librat e fikhut.

Adhurimet nuk pranohen nëse nuk i zbaton detyrat e Sheriatit ashtu siç duhet. Për etikën dhe për rregullat e adhurimeve do të flitet në dy mësimet e ardhshme.

1- Pastërtia e trupit

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Pastrojini këta trupa, All-llahu ju pastroftë, sepse me njeriun e pastër qëndron meleku në sijarin e tij. Kur vjen nata, meleku i lutet Zotit: “O Zot, fale robin Tënd, sepse ai ka ndenjor i pastër.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 26003.)

Dhe: **“Mjerë njeriu i papastër!”**

(El Kafj, vëll. 6, f. 439.)

Dhe: **“Të papastërit janë të shkatërruar.”**

(Kenżul Ummal, hadithi / 7422.)

Transmetohet se Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Lahuni e hiqeni erën e keqe e neveritëse. Mbajini vetet tuaja pastër, sepse All-llahu nuk e do te robtë e Tij papastërtinë, e cila shqetëson të tjerët.”**

(Biharul Anuar, vëll. 10, f. 98, kap. 7.)

2- Rregullat e tualetit

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Lum ajo shtëpi që ka hammam! Në të kujtohet zjarri dhe largohen papastërtitë.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 53.)

Në një hadith të Imam Sadikut (a.s.) përmenden rregullat e hyrjes në hammam. Para se njeriu të hyjë në hammam të thotë: **“O Zot im, largoji prej meje ndyrësitë dhe papastërtitë! Ma pastro trupin dhe zemrën!”** Kur të hedhë ujë të ngrohtë mbi trupin të thotë: **“I kërkoj mbrojtje All-llahut prej zjarrit dhe i lutem Atij të më fusë në Xhennet.”** Pasi të lahet e të fshihet dhe fillon të vishet të thotë: **“O Zoti im, më vish devotshmërinë dhe ma largo Eridae.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 52.)

Prej rregullave të shkuarjes në hammam është mbulimi.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Askush prej jush të mos hyjë në hammam i zhveshur.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 69, kap. 3.)

Po ashtu, transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Prej rregullave është që i rrituri të mos hyjë me fëmijën e tij në hammam e t'i shohë pjesët e turpshme.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 53.)

Dhe: **“Ai që hyn në hammam i veshur, All-llahu do ta mbulojë me mbulesën e Tij.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 74, kap. 3.)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, All-llahu i Lartësuar e ka përbuzur për ju o ymmet të hyni në lumë të zhveshur.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 69, kap. 3)

Kjo do të thotë se mbulimi i pjesëve të turpshme është detyrë për të gjithë jo vetëm kur bëjmë dush, por kudo.

Prej etikës së pastrimit është edhe heqja e qimeve nga disa vende të trupit, si poshtë sqetullave dhe në pjesët e turpshme. Është mirë që këtë veprim njeriu ta kryejë çdo dy ose çdo katër javë. Po e bëri pas dyzet ditëve, për të nuk ka të mira.

3- Pastrimi i rrobave

Para se Islami të interesohet për formën, ngjyrën a llojin e veshjes, interesohet më së pari për pastërtinë e tyre.

Në jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet se një ditë Profeti kishte parë një burrë të veshur me rroba të papastra. Profeti (s.a.u.s.) tha: **“A nuk ka gjetur ujë ky njeri që të lajë rrobat e tij?”**

(Sunen Ebi Daud, vëll. 4.)

Në një hadith të Profetit (s.a.u.s.) thuhet: **“Ai që blen rroba, t’i lajë ato.”**

(El Kafij, vëll. 6, f. 441.)

Një ditë Profeti Muhammed (s.a.u.s.) i tha Aishes: **“Oj Aishe, laji këto dy rroba. A nuk e di se edhe rrobat lartësojnë (bëjnë tesbih) dhe kur janë të papastra ato e ndërpresin tesbihun?”**

(Kenzul Ummal, hadithi 26009.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Rrobat e pastra e largojnë hidhërimin dhe zemërimin dhe janë të vlefshme për namaz.”**

(El Kafij, vëll. 6, f. 444.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Rroba e pastër e zemëron armikun.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 103.)

Në disa hadithe të transmetuara nga Profeti (s.a.u.s.) dhe nga Ehli Bejti (a.s.) thuhet se rroba më e mirë është ajo me ngjyrë të bardhë. Në të shumtën e kohës Profeti (s.a.u.s.) ka veshur rroba të bardha. Për këtë ai i porosiste shokët e tij: **“Vishuni me rrobe të bardha, sepse ajo është më e pastër dhe qefinosini të vdekurit tuaj me të.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /41102 dhe El Kafij, vëll. 6, f. 445.)

Rrobat prej pambuku dhe lini janë më të mirat. Sheriati islam e ka ndaluar mëndafshin për meshkujt, por e ka lejuar për femrat.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Vishni rroba pambuku, sepse rrobat e pambukut kanë qenë veshje e të dërguarve.”**

(El Kafij, vëll. 6, f. 446.)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Është e ndaluar për meshkujt e ymmetit tim veshja e mëndafshit dhe mbajtja e floririt. Ato janë të lejueshme për femrat.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /41210.)

Dihet se qëllimi kryesor i veshjes është mbulimi dhe paraqitja me pamje të kënaqshme. Kësisoj, veshja për t’u mburrur nuk është e pëlqyeshme në Sheriat. Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Atë që vishet për t’u mburrur dhe për t’u dukur tek të tjerët, nuk do ta shohë All-llahu, derisa ai t’i zhveshë ato rroba.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /41203.)

Përmbledhje

Islami thotë: **“Pastërtia është prej besimit.”** Është detyrë e myslimanëve që të zbatojnë rregullat e Sheriatit për pastërtinë. Ata duhet të pastrojnë trupin, rrobat, të krehin flokët dhe t'i shkurtojnë ato.

Pyetje

- 1- Sqaroni rëndësinë e pastërtisë në Islam sipas haditheve të Profetit (s.a.u.s.)
- 2- Cilët njerëz nuk i do All-llahu (xh.sh.)? Argumentojeni me hadith të transmetuar nga Ehli Bejti (a.s.)
- 3- Sqaroni shkurtimisht rregullat e hammamit (banjës).
- 4- Përse Profeti Muhammed (s.a.u.s.) i këshillonte shokët e tij për të veshur rroba të bardha?
- 5- Cilat veshje ka ndaluar Islami?



Mësimi i 16^{-të}

PASTËRTIA (2)

4- Mis'uaku dhe pastrimi i dhëmbëve

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Xhebraili gjithmonë më porosiste për përdorimin e mis'uakut derisa mendova se përdorimi i tij do të bëhet farz.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f.126, kap.18.)

Dhe: **“Po të mos ishte e vështirë, unë do ta bëja farz përdorimin e mis'uakut pas marrjes së abdesit.”**

(Sunen ibn Maxbah, hadithi 28 dhe Biharul Anuar, vëll. 73, f. 137, kap. 18.)

Dhe: **“Namazi, para të cilit përdoret mis'uaku është më i mirë se shtatëdhjetë namaze, ku nuk përdoret mis'uaku.”**

(Biharul Anuar, vëll. 77, f.344, kap. 7.)

Profeti e ka porositur vasijin e tij Imam Aliun (a.s.): **“Përdore mis’uakun në çdo namaz.”** (kuptimi është para ose pas çdo namazi, sepse dibet që në namaz nuk lejon lëvizje shtesë. P) (Biharul Anuar, vëll. 73, f. 132, kap. 18.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Mis’uaku është pjesë e abdesit dhe abdesi është pjesë e besimit.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2699 dhe Biharul Anuar, vëll. 73, f. 140, kap. 18.)

Dhe: **“Vërtet, gojët tuaja janë rrugët e Kur’anit. Pastrojini ato me mis’uak!”**

(Sunen ibn Maxhab, hadithi 29 dhe Biharul Anuar, vëll. 81, f. 230.)

Dhe: **“Pastrojini gojët tuaja, sepse ato janë rrugët e Kur’anit.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2804 dhe Mustedrekul Uesail, vëll. 1, f. 367.)

Dhe: **“Pastrojeni rrugën e Kur’anit!”** I thanë: **“Cila është rruga e Kur’anit?”** Ai u përgjigj: **“Gojët tuaja.”** E pytën: **“Me çfarë t’i pastrojmë?”** Ai u përgjigj: **“Me mis’uak.”** (Biharul Anuar, vëll. 73, f. 133, kap. 18.)

Dhe: **“Gojët tuaja janë rrugë prej rrugëve të All-llahut. Më e dashura e tyre tek All-llahu është ajo më e aromatizuara; prandaj, pastrojini ato me çfarë të mundeni.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 131, kap. 18.)

Profeti i ka qortuar disa prej shokëve të tij: **“Çfarë keni që hyni tek unë me dhëmbë të nxirë e me flokë të pakrehur. Përse nuk e përdorni mis’uakun?”**

(El Kafij, vëll. 6 dhe Biharul Anuar, vëll. 73, f. 132, kap. 18.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Prej moralit të të dërguarve ka qenë mis’uaku (përdorimi i tij).”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 131, kap. 18.)

Profeti (s.a.u.s.) i përbuzte dhëmbët e nxirë! Prandaj i ka porositur myslimanët që të përdorin mis’uakun për pastrimin e gojës e të dhëmbëve.

Dobitë e mis’uakut

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) i ka thënë Imam Aliut (a.s.): **“O Ali, mis’uaku ka dymbëdhjetë të mira: ai është prej synnetit, pastron gojën, kthjellon shikimin, përdorimi i tij e kënaq Mëshirbërësin, zbardhon dhëmbët, largon gurëzat tek dhëmbët, forcon mishin e dhëmbëve, shton oreksin, largon këlbazën, shton mbrojtjen (ruajtjen), shton mirësitë dhe i gëzon melekët.”**

(Biharul Anuar, vëll. 77, f. 346, kap. 7.)

Transmetohet se Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mis’uaku është prej mirësive të All-llahut (xh.sh.), është synnet i Profetit (s.a.u.s.) dhe aromatizues për gojën.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 129, kap. 18.)

Dhe: **“Mis’uaku pastron shikimin.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 134, kap. 18.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Përdoreni mis’uakun sepse ai largon pëshpëritjet e gjoksave.”** (Biharul Anuar, vëll. 73, f. 139, kap. 18.)

Ali ibn Musa Riza (a.s.) ka thënë: **“Mis’uaku pastron shikimin, rrit flokët dhe largon lotët.”** (Biharul Anuar, vëll. 73, f. 137, kap. 18.)

Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) përmendet edhe një tjetër e mirë e mis’uakut. Ai ka thënë: **“Mis’uaku i shton njeriut gojëtarinë (elokuencën).”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 135, kap. 18.)

5- Shkurtimi i flokëve dhe rregullimi

Prej etikës islame është shkurtimi i flokëve, i mustaqeve dhe i mjekrës.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Çdo kush duhet t’i shkurojë mustaqet dhe qimet në hundë. Këtë ta bëjë çdoherë sepse ky veprim ia shton bukurinë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 109, kap. 12.)

Dhe: **“Askush prej jush të mos i zgjasë mustaqet sepse djalli i merr ato vend për t’u fshehur.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 112, kap.13.)

Dhe: **“Shkurtojini mustaqet, lëshojini mjekrat dhe mos u shëmbëlleni me jahudinjtë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 112, kap.13.)

Imam Sadiku (a.s.): **“Heqja e qimeve të hundës zbukuron fytyrën.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 109, kap.12.)

Dhe: **“Ai që nuk i shkurton mustaqet, nuk është prej nesh.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 109, kap.13.)

Ali ibn Xha’fer e pyeti të vëllanë e tij Imam Musa ibn Xha’fer (a.s.) për hukmin (rregullin në Sheriat) e atij që heq mjekrën. Ai iu përgjigj: **“Nëse heq (rruan) anësoret e saj nuk ka gjë. Mos e rruaj nga përpara.”**

(Biharul Anuar, vëll. 76, kap.13 dhe Mekarimul Ablak, f. 68.)

Në një hadith të Imam Sadikut (a.s.) përcaktohet kufiri i mjekrës ku duhet rruajtur. Ai ka thënë: **“Kape mjekrën me dorë dhe ajo pjesë që del jashtë dorës preje.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 116, kap.14.)

Dhe: **“Ajo që është e tepërt prej mjekrës kur e kap me dorë, do të hyjë në Zjarr.”** *(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 112, kap.13.)*

Për kujdesin për t’u qethur e rregulluar, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Bukuria e flokëve është prej mbulesë nga All-llahu, prandaj respektojeni atë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 116, kap.14.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Krehja e flokëve largon varfërinë dhe sëmundjen.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 113, kap.14.)

Imam Rizai (a.s.), për kuptimin e ajetit 31 të sures A’raf: **“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).”**, ka thënë: **“Prej atyre bukurive është edhe krehja për çdo namaz.”**

(Mekarimul Ablak, f. 70.)

Imam Sadiku (a.s.) kur e ka cilësuar Profetin (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur i zgjateshin flokët deri te maja e veshit, i shkurtonte.”**

(Mekarimul Ablak, f. 70.)

6- Prerja e thonjve

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Atij që i pret thonjtë ditën e xhuma, All-llahu do t’ia nxjerrë prej gishtave të tij sëmundjen dhe do t’i futë shërimin.”**

(Mekarimul Ablak, f. 64.)

Një burrë i kërkoi Imam Sadikut (a.s.) që t’i mësonte një lutje për shtimin e mirësive. Imami i tha: **“Shkurtoji mustaqet dhe thonjtë! Këtë bëje ditën e xhuma!”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 110, kap.13.)

Dhe: **“Prerja e thonjve ditën e xhuma të mbron prej sëmundjes së gërbullës (lebër) dhe verbërisë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 110, kap.13.)

Dhe: **“Atij që i shkurton flokët dhe pret thonjtë ditën e xhuma dhe për çdo prerje apo shkurtim thotë: Me emrin e All-llahut dhe në synnetin e Muhammedit e të familjes së tij, do të shpërblehet me shpërblimin e lirit të një robi prej bijëve të Ismailit.”**

(Biharul Anuar vëll. 73, f. 110, kap.13.)

Kjo dëshmi për ditën e xhuma tregon rëndësinë e pastërtisë; por, kjo nuk do të thotë se nuk duhet të pastrohemi, nuk duhet t’i presim thonjtë, a nuk duhet të shkurtojmë flokët në ditët e tjera.

Imam Kadhimin (a.s.) e kanë pyetur: **“Disa nga shokët tanë thonë se shkurtimi i flokëve dhe prerja e thonjve ditën e xhuma është i detyrueshëm.”** Ai (a.s.) është përgjigjur: **“SubhanAll-llah! Kur të duash, ditën e xhuma ose në një ditë tjetër.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 64.)

Disa hadithe dëshmojnë se është e pëlqyeshme të bëhen punët në ditën e xhuma, për arsye të madhështisë së kësaj dite.

Imam Sadikun (a.s.) e kanë pyetur për shpërblimin e shkurtimit e të prerjes së thonjve në këtë ditë. Ai (a.s.) është përgjigjur: **“Ai vazhdon të jetë i pastër deri në ditë e xhuma që do të vijë.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 65.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që i pret thonjtë ditën e shtunë dhe ditën e enjte dhe i shkurton mustaqet në këto ditë, është i shëruar prej dhimbjes së dhëmballës dhe prej dhimbjes së syrit.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 65.)

Për mënyrën e prerjes së thonjve, në një hadith të Imam Sadikut (a.s.) thuhet: **“Ai që do të presë thonjtë e tij ditën e xhuma, të fillojë te gishti i vogël i dorës së majtë dhe të mbarojë te gishti i vogël i dorës së djathtë.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 66.)

Përmbledhje

Islami e pëlqen pastërtinë. Sheriati islam i nxit besimtarët ta përdorin mis'uakun çdo ditë. Islami na mëson t'i shkurtojmë flokët dhe t'i presim thonjtë për çdo javë.

Pyetje

- 1- Përmendni një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.), i cili sqaron vlerën e namazit kur përdoret mis'uaku.
- 2- Cilat janë dobitë dhe frytet e përdorimit të mis'uakut? Argumentojeni me një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.)!
- 3- Si duhet të jenë mustaqet, flokët dhe mjekra? Përmendni një hadith rreth kësaj çështjeje.
- 4- Cila është rëndësia e krehjes? Përmendni një hadith!
- 5- Sqaroni mënyrën e prerjes së thonjve dhe kohën e përshtatshme për këtë veprim.

Mësimi i 17^{-të}

PARFUMIMI

Në hadithe përmenden parfumimi dhe erzinat e këndshme.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Përdorimi i erërave të këndshme forcon zemrën.”**

(El Kafj, vëll. 6, f. 510.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Parfumimi është synnet i të dërgurave.”**

(El Kafj, vëll. 6, f. 510.)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Vënia e erërave të këndshme është prej moralit të të dërguarve.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 40.)

Për paraqitjen sa më të mirë të njeriut, Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, All-llahu e do bukurinë dhe zbukurimin. Ai (xh.sh.) nuk e do varfërinë e as të qëniti i varfër. S'ka dyshim se nëse All-llahu e mirëson një rob të Tij, Ai dëshiron t'i shohë gjurmët asaj mirësie.”** Imamin e pyetën: **“Si janë ato gjurmë?”** Ai (a.s.) u përgjigj: **“Të pastrojë rrobat e**

tij, të përdorë erëra të këndshme, të pastrojë shtëpinë e tij dhe të fshijë oborrrin e shtëpisë. Edhe ndriçimi i fenerëve para perëndimit të diellit largon varfërinë dhe shton mirësitë.”

(*Mekarimul Ahlak*, f. 41)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Gjërat më të dashura për mua në këtë dynja janë martesë, erërat e këndshme kurse drita e syve të mi është namazi.”**

(*Biharul Anuar*, vëll. 73, f. 142, *kap.19.*)

Dhe: **“Mos i lini erërat e këndshme sepse, melekët e nuhasin erën e këndshme që vë besimtari. Përdorini erërat e këndshme çdo të xhuma.”**

(*El Kafij*, vëll. 6, f. 511.)

Dhe: **“Ai që vë erë të këndshme në fillim të ditës do të ketë mendje të qëndrueshme deri në darkë.”**

(*El Kafij*, vëll. 6, f. 510.)

Imam Musa Kadhim (a.s.) ka thënë: **“Njeriu duhet të përdorë erëzinë (parfum) çdo ditë. Nëse nuk mundet, një ditë po dhe një ditë jo. Nëse nuk mundet, atëherë një herë në javë (ditën e xhuma).”**

(*El Kafij*, vëll. 6 f. 510.)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Shpenzimet që bëhen për të blerë parfum nuk janë të tepërta.”**

(*Mekarimul Ahlak*, f. 41.)

Dhe: **“Profeti (s.a.u.s.) shpenzonte për blerjen e erërave të këndshme më shumë se për të blerë ushqim.”**

(*El Uesail*, vëll. 2, f. 146.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Profeti Muhammed (s.a.u.s.) nuk i refuzonte parfumin dhe ëmbëlsirën.”**

(*El Kafij*, vëll. 6, f. 513.)

Enes ibn Malik ka transmetuar: **“Kur i sillnin Profetit erë të këndshme, nuk e refuzonte.”**

(*Sunen ibn Maxhab*, vëll. 8.)

Një burrë i tha Imam Sadikut (a.s.): **“Një njeriu i dhuruan një shishe me parfum dhe ai nuk e pranoi.”** Imami i tha: **“Ai nuk duhet t’ia refuzonte bujarinë.”**

(*El Uesail*, vëll. 2, f. 147.)

Pastrimi i shtëpisë dhe i mjedisit

Sheriati islam, ka vendosur rregulla për pastërtinë e trupit e të rrobave. Po ashtu, edhe për pastrimin e shtëpisë e të mjedisit. Pra, islami e dëshmon dhe e do pastërtinë, bukurinë dhe pamjen e jashtme. Prandaj, myslimani duhet të jetë shembull për të tjerët në veprime, në virtyte, në pastërtinë vetjake, në pamjen e jashtme, etj. Kështu, luftohet papastërtia dhe pakësohen sëmundjet e ndryshme.

Disa dijetarë kanë mendimin se fjala *“shejtani”* që përmendet në disa transmetime, ndoshta ka kuptimin e mikrobeve e të viruseve. Për këtë transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Askush prej jush të mos i zgjasë mustaqet sepse shejtani i përdor për t’u fshehur.”**

(*El Kafij*, vëll. 6 f. 488.)

Është më se e vërtetë se zbatimi i porosive të Profetit (s.a.u.s.) dhe të Imamëve të nderuar prej familjes së tij çojnë në një jetë të kënaqshme, në një mjedis të pastër e pa sëmundje. Hadithet e nderuara ndahen në dy grupe.

Grupi i parë dëshmon për rëndësinë e pastërtisë e të mjedisit.

Grupi i dytë i cakton myslimanit rregullat për to.

Pastërtia e shtëpisë ka lidhje të fortë me pastrimin e mjedisit. Sa më shumë të shtohet interesimi për pastërtinë e shtëpisë, aq më shumë shtohet interesimi për pastrimin e mjedisit, që do të thotë: respektimi i të drejtave të të tjerëve për të jetuar të kënaqur në mjedis të pastër.

Imam Bakir (a.s.) ka thënë: **“Fshirja e shtëpive largon varfërinë.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 317.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Larja e enëve dhe pastrimi i oborrit sjellin mirësi.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 317.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“....Mos i lini pluhurat pas dere sepse bëhen vend për shejtanin.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 174, kap. 36.)

Dhe: **“Mos i lini mbeturinat natën në shtëpitë tuaja, por nxirrini ato jashtë ditën sepse ato janë vendi ku rri shejtani.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 318.)

Imam Aliu (a.s.) ka transmetuar se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “

Dhe: **“Shtëpitë e shejtanit në shtëpitë tuaja janë foletë e merimangave.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 322.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Pastrojini shtëpitë tuaja prej foleve të merimangave sepse lënia e tyre në shtëpi sjell varfërinë.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 318.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Profeti Muhammed e ka ndaluar të hyhet në banesat e errëta, pa pishtar.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 322.)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Ndriçimi i fenerëve para perëndimit të diellit largon varfërinë dhe shton mirësitë.”**

(El Uesail, vëll. 3, f. 573.)

Pastrimi i mjedisit

Hadithet islame përmbajnë dëshmi të qartë për ndalimin e disa veprimeve në mjediset publike a në rrugët kryesore, në rruginat, në ujërat rrjedhëse, nën hijen e drurëve e të pemëve, në lulishte e në parqe, pas mureve të ndërtesave e të banesave, etj.

Imam Sadiku (a.s.) ka transmetuar nga Imamët paraardhës (a.s.): **“Profeti Muhammed (s.a.u.s.) e ka ndaluar urinimin mbi grykën e puseve, në lumë dhe nën pemët frutore.”**

(El Uesail, vëll. 1, f. 325.)

Po ashtu Imam Sadiku ka transmetuar se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nëse dikush i bën këto tre veprime, do të jetë i mallkuar. Ato janë; urinimi nën hijen e pemëve (q w nw tw shumtwn e rasteve), ndalimi i ujit tw pwrдорshwm dhe bllokimi i rrugës.”**

(El Uesail, vëll. 1, f. 325.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Profeti Muhammed (s.a.u.s.) e ka ndaluar urinimin nën pemën frutdhënëse dhe në anët e rrugës.”**

(El Uesail, vëll. 1, f. 325.)

Imam Sadiku (a.s.) ka transmetuar nga Imamët paraardhës (a.s.) se: **Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ju ka ndaluar ju, o ymmet njëzet e katër veprime, deri sa tha: urinimin në breg të lumit, kontaktin seksual nën pemën frutore, frutat e së cilës janë pjekur, a nën hurmën, fruta e së cilës janë pjekur.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 328.)

Një burrë e ka pyetur Imam Zejnul Abidin (a.s.) për vendin ku njeriu të kryejë nevojën e tij. Ai (a.s.) është përgjigjur: **“T’u frikësohet brigjeve të lumenjve, rrugëve ku ecet, pemëve frutdhënëse dhe vendeve të mallkimit.”** Përsëri burri e ka pyetur: **“Cilat janë vendet e mallkimit?”** Ai (a.s.) është përgjigjur: **“Dyert e banesave.”**

(El Uesail, vëll. 5, f. 324.)

Përmbledhje

S'ka dyshim se erzinat dhe pastërtia e shtëpisë dhe e mjedisit janë prej porosive të Islamit, sepse ruhet shëndeti e sigurohet jetë e këndshme për individin dhe për shoqërinë.

Pyetje

- 1- Përmendni një hadith nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.) për lyerjen me erë të këndshme.
- 2- Sa duhet të shpenzojë myslimani për blerjen e erërave të këndshme?
- 3- Përmendni dy hadithe që flasin për pastërtinë e shtëpisë dhe për rëndësinë e saj.
- 4- Si sigurohet mjedisi prej ndotjes?



Mësimi i 18 -të

RREGULLAT E TAHALIJUT

Pasi u njohëm me etikën dhe me porositë e Sheriatit islam për pastrimin e shtëpisë e të mjedisit. Në këtë mësim do të flasim për porositë e Islamit për tahalijun dhe për kushtet e tij.

1- Mbulimi

Njeriu duhet t'i kryejë nevojat e tij larg syve të njerëzve; prandaj edhe ndërtimi i tualeteve bëhet në atë mënyrë që mos shihet nga brenda. Nëse një njeri ndodhet në një ambjent të jashtëm dhe kërkon të kryejë nevojën, ai duhet të shkojë në një vend të padukshëm nga njerëzit.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ai që kërkon të urinojë, le të fshihet.”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 305.*)

Dhe: **“Llukmani i tha djalit të tij: “Nëse udhëton i shoqëruar me të tjerë, këshillohu me ta... Nëse do të kryesh nevojën (të urinosh ose të defekosh), shko në një vend të largët!”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 305.*)

Dhe: **“Llukmanit nuk iu dha urtësia për arsye të prejardhjes familjare, as prej pasurisë, as prej fuqisë trupore e as prej bukurisë. Atij iu dha urtësia sepse ishte i guximshëm në zbatimin e urdhrave të All-llahut, i kuptueshëm në çështjet e All-llahut, i heshtur dhe**

heshtës. Askush nuk e ka parë as duke urinuar e as duke u larë, sepse ai ka qenë i ashpër në punë të të mbulimit e të fshehjes dhe interesohej për problemet e tij.”

(*El Uesail, vëll. 1, f. 305.*)

2- Ruajtja e aurretit (pjesëve të turpshme)

Myslimani duhet të ruajë aurretin e tij prej shikimit të njerëzve. Në hadithin e njohur të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) i cili njihet me emrin “El Menhij”, thuhet: **“Nëse dikush prej jush lahet në mjedise të hapura, të kujdeset për aurretin tij! Pastaj tha: “Askush të mos hyjë i zhveshur në banjë. All-llahu e ka ndaluar që një njeri të shikojë aurretin e vëllait të tij mysliman. Atë e mallkojnë shtatëdhjetë mijë melekë. E ka ndaluar femrën që të shohë aurretet e një femre tjetër. Ai ka thënë: “Kushdo që shikon aurretet e vëllait të tij mysliman apo të ndonjë tjetri me qëllim, All-llahu do ta bashkojë me dyfytirakët të cilët shohin aurretet e njerëzve. Nëse pendohet, ai nuk del nga kjo jetë pa e skandalizuar All-llahu..”**

(*El Uesail, vëll.1, f. 299.*)

3- Mënyra e tehalijut

Sheriati islam e ndalon drejtimin kah kiblja, qoftë nga përpara apo nga prapa, kur ulemi për të kryer nevojën ose për t’u pastruar. Ata që bëjnë këtë veprim, Sheriati i quan gabimtarë dhe mëkatarë.

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur doni të urinoni, mos u drejtoni kah kiblja.”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 302.*)

Dhe: **“Kur të hysh për të kryer nevojën, mos u drejto kah kiblja, as nga përpara e as nga prapa, por kthehu nga lindja ose nga perëndimi.”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 302.*)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“I dërguari i All-llahut e ka ndaluar drejtimin nga kiblja, kur kryhen nevojat.”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 300.*)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Mos u drejtoni kah kiblja, as nga përpara e as nga prapa dhe mos qëndroni përballë erës.”**

(*Biharul Anuar, vëll. 77, f. 182, kap. 2.*)

4- Heshtja

Nuk lejohet të folurit e as të lexohe a të këndohet Kur’ani në tualet.

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“I dërguari i All-llahut e ka ndaluar që një njeri t’i përgjigjet tjetrit kur ndodhet në tualet. Të flasë me të kur të dalë nga tualeti.”**

(*El Uesail, vëll. 1, f. 309.*)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Në shtatë raste njeriu nuk lexon e nuk këndon Kur’an: kur është në ruku (përkulje), kur është në sexhde, kur është në **keuijf**, kur është në tualet, kur është xhynyb, kur gruaja është me të përmuajshme dhe kur është lehonë (pas lindjes).”**

(*Biharul Anuar, vëll. 77, f. 174, kap. 2.*)

5- Etika të tjera

Prej etikës që ka të bëjë me tahalijun janë: hyrja në tualet me këmbën e majtë, dalja me këmbën e djathtë dhe moskryeja e nevojës dhe e urinimit me këmbë.

Imam Sadiku (a.s.) transmeton nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.) i cili ka thënë: **“Urinimi më këmbë pa asnjë arsye, është **xhefa**. Po ashtu, pastrimi me dorën e djathtë pa pasur arsye për mospërdorimin e së majtës është **xhefa**.”**

(*Biharul Anuar, vëll. 77, f. 190, kap. 2.*)

Prej etikës është që të mos urinohet mbi vende të larta dhe as në ujërat e rrjedhshme.

Imam Kadhimi (a.s.) ka transmetuar nga Imamët paraardhës të cilët kanë transmetuar nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.) i cili ka thënë: **“Urinimi në ujin rrjedhës është xhefa.”** (Biharul Anuar, vëll. 77, f. 188, kap. 2.)

Imam Bakir (a.s.) ka thënë: **“I dërguari i All-llahut e ka ndaluar që njeriu të urinojë mbi vende të larta** (siç janë taracat e shtëpive.)”

(Biharul Anuar, vëll. 77, f. 188, kap.2.)

Për mënyrën e pastrimit prej papastërtive e ndytësive dhe gusulin, këto do t'i paraqesim në mësimet e ardhshme.

Përmbledhje

Prej etikës së tehalijut në Sheriatin islam është mbulimi, fshehja, ruajtja e aureteve nga shikimet e të tjerëve, mosdrejtimi kah kiblja dhe heshtja.

Pyetje

- 1- Përmendni disa argumente për urtësinë që All-llahu i dhuroi Llukmanit.
- 2- Përmendni një hadith nga Profeti Muhammed (s.a.u.s.), i cili flet për atë që shikon aurret e vëllait të tij mysliman.
- 3- Cilat janë drejtimitet e ndaluara kur urinohet?
- 4- A është i lejueshëm të folurit gjatë urinimit?
- 5- Sqaroni shkurtimisht rregullat e tehalijut.

Mësimi i 19^{të}

RREGULLAT E NGRËNIES (1)

Ngrënia dhe pirja janë prej veprimeve të rëndësishme të njeriut që i kryhen çdo ditë. Sheriati islam i kushton shumë vëmendje etikës, siç u pa edhe në mësimet e mëparshme. Etika islame i siguron individit dhe shoqërisë islame jetë të këndshme. Sipas pikëpamjes islame, jeta e këndshme përfshin plotësimin e nevojave materiale e shpirtërore të njeriut. Në këtë mësim dhe në mësimin e ardhshëm do të njihemi me etikën islame në ngrënie e në pirje.

1- Pastërtia dhe lejueshmëria (hallall) e ushqimit

Së pari: Ushqimi të jetë i lejueshëm (hallall.) Sheriati islam e ka ndaluar rreptësisht përdorimin e ndytësive, siç janë: mishi i dërrit dhe pijet alkoolike. Myslimani duhet të jetë i vetëdijshëm për llojin e mishit që ha. Po ashtu, edhe për mënyrën e therjes, ku duhet, patjetër të zbatohen rregullat e Sheriatit.

Së dyti: Ushqimi të jetë i pastër, të mos jetë i përzier me lëndë të ndaluara (haram) kur gatuhet. Kjo, sepse lëndët haram në ushqim ndikojnë në pastërinë e zemrës e të shpirtit dhe pengojnë lëvizjet e njeriut drejt përsosurisë. Për këtë, Sheriati islam i këshillon njerëzit që të jenë të kujdesshëm kur përdorin ushqimin e tregjeve, sepse disa tregtarë nuk interesohen për rregullat e Sheriatit në përgatitjen e ushqimeve. Sheriati nuk e ndalon përdorimin e ushqimeve në rrugë, por ai porosit me qëllim që të forcohet pastërtia morale në personalitetin e njeriut. Porosia themelore për ushqimet në tregjet islame është pastërtia dhe lejueshmëria.

Së treti: Burimi i ushqimit të jetë i lejueshëm (hallall). Sheriati i dallon fitimet e lejueshme (hallall) dhe ato të palejueshme (haram). Po ashtu, ai ka caktuar khumsin (1/5 e pasurisë) dhe zeqatin për

pastrimin e pasurisë. Prandaj, është detyrë e çdo myslimani që të sigurohet për burimin e të ardhurave të tij, përndryshe puna e tij do të jetë pjesë e bashkëpunimeve të ndaluara (haram) ose tregti me mallra të ndaluara (haram).

2- Larja e duarve

S'ka dyshim se në veprimtaritë dhe punët e tij të përditshme njeriu më shumë përdor duart e tij. Kjo do të thotë se duart e tij prekin gjëra të shumta dhe bëhen pis. Për këtë, myslimani duhet t'i lajë duart e veta para ushqimit.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Abdesi para ushqimit largon varfërinë, mjerimin dhe shëron shikimin.”**

(Mekarimul Ahlak, f.139.)

Në disa tekste thuhet largon pikëllimin.

Dhe: **“Ai që do t'i shtohen mirësitë, të marrë abdes para ushqimit.”**

(Mekarimul Ahlak, f.139.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kush i lan duart para dhe pas ushqimit (ngrënies), do t'i bekohet fillimi dhe fundi, do t'i shtohen mirësitë dhe do të jetë i shëruar prej sëmundjeve trupore.”**

(Mekarimul Ahlak, f.139.)

Dhe **“Kush lan duart para ngrënies dhe nuk i fshin me peshqir, begatia e ushqimit do të qëndrojë për të derisa duart janë të lagura.”**

(Mekarimul Ahlak, f.139.)

Një burrë pa Imam Kadhimin (a.s.) që po merte abdes para ushqimit dhe nuk e përdori mendilin (peshqirin) për të tharë duart. Kur i lau duart pas ushqimit e përdori mendilin.

(Mekarimul Ahlak, f.139.)

3- Mënyrat e uljes në tryezë

Myslimani duhet të ulet në tryezë me thjeshtësi për hir të All-llahut (xh.sh.) dhe të hajë në atë mënyrë ku të duket adhurimi i tij për All-llahun Fuqiptotë, duke e falënderuar Atë për mirësitë që ia ka dhënë.

Enes ibn Malik ka transmetuar: **“Profeti Muhammed (s.a.u.s.) nuk ka ngrënë as në shesh e as në pjatë të madhe.”** Atë e pyetën: **“Ku hani ju?”** Ai u përgjigj: **“Në sofër.”**

(Thja ulumi dijn, kapitulli i etikës së të ngrënit.)

Në një hadith të Profetit thuhet: **“Unë nuk ha i mbështetur. Unë jam rob dhe ha ashtu siç hanë robtë dhe ulem ashtu siç u takon robve.”**

(Sunen ibn Maxhab, hadithi / 3262.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nëse dikush prej jush do të ulet për të ngrënë, le të ulet ashtu siç ulen robtë. Asnjë prej jush të mos ulet këmbë mbi këmbë, sepse All-llahu e përbuz këtë lloj uljeje dhe zemërohet prej atij njeriu.”**

(El Kafij, vëll.6, f.272.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Profeti Muhammed (s.a.u.s.) nuk ka ngrënë i mbështetur që kur e ka dërguar All-llahu e deri kur ka ndërruar jetë. Ai hante siç hanë robtë dhe ulej siç ulen robtë.”** Atë e pyetën: **“Përse vepronte kështu?”** Ai u përgjigj: **“Si thjeshtësi ndaj All-llahut (xh.sh).”**

(El Kafij, f.270.)

4- Fillimi me “Bismil-lah”

Prej atyre që Profeti ia mësoi vasijjtit të tij, Imam Aliut (a.s.) ishte: **“O Ali! Kur ha, thuaj “Bismil-lah” dhe kur të mbarosh së ngrëni thuaj “Elhamdulillah”, sepse dy melekët që të mbrojnë, i shënojnë të mira për ty.”**

(Mekarimul Ahlak, f.142.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Unë jam garant se ai që e fillon ushqimin me “Bismil-lah” nuk do të ankohet prej atij ushqimi.”**

(El Kafj, vëll. 6, f. 295.)

Edhe dijetarët e moralit porositnin shumë që njeriu të thotë “Bismil-lah” në çdo kafshatë që ha, sepse kjo është pjesë e adhurimeve të Tij.

5-Nijeti

Është mirë që nijeti i myslimanit kur ha të jetë për forcimin e trupit, që të kryejë vepra, me të cilat All-llahu është i kënaqur. Myslimani nuk ha vetëm që të kënaqet dhe të mbushë barkun. Thelbi i të ngrënit të myslimanit është që ai ta jetojë jetën duke iu përlurur All-llahut dhe jo të jetojë me qëllim që të hajë.

Në porosinë e Imam Aliut (a.s.) për djalin e tij, Imam Hasanin (a.s.) thuhet: **“O biri im, mos ha ushqim as të nxehtë e as të ftohtë. Kur të pish e të hash, më parë të thuash: “O Zot, unë të kërkoj Ty shëndet e fuqi prej ushqimit tim dhe prej pirjes sime, që të të adhuroj Ty, të të përmend Ty e të të falënderoj Ty në jetën time. Të më forcosh, që me fuqinë e atij ushqimi të të adhuroj vetëm Ty dhe të më mbrosh e përsosurisht që të mos bëj mëkate.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 143.)

6- Mënyra e fillimit të ushqimit

Pasi njeriu të ulet në tryezë dhe të përmendë All-llahun, është mirë që të fillojë me dorën e djathtë dhe me kripë.

E kanë pyetur Imam Sadikun (a.s.) për etikën e të ngrënit dhe ai (a.s.) është përgjigjur: **“Të mos hahet me dorën e majtë e as të mos pihet me dorën e majtë dhe të mos kapet asgjë me të.”**

(Uesail, vëll.24, f. 258.)

Dhe **“Mos ha me dorën e majtë kur nuk ke arsye.”**

(El Uesail, vëll.24, f. 259.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Fillojeni ngrënien me kripë. Sikur ta dinë njerëzit se çfarë dobish ka te kripa, do ta zgjidhnin si ilaçin e sprovuar.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 142.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, ta fillojnë me kripë dhe ta mbarojnë me uthull.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 142.)

Përmbledhje

Nuk ka dyshim se ushqimi i jep energji njeriut. Për ngrënien dhe për pirjen ka rregulla në Sheriatin islam. Disa prej tyre janë uaxhib (të detyrueshme), kurse disa janë porosi morale që njeriu besimtar të përsoset sa më shumë. Ushqimi hallall, i pastër, larja e duarve, thjeshtësia në tryezë dhe përmendja e All-llahut (xh.sh) janë prej etikës islame në haje.

Pyetje

1- Çfarë duhet të ketë parasysh myslimani kur ha?

2- Cila është etika islame kur ulemi në tryezë.

3- Si duhet

filluar

ngrënia?

4- Cili është nijeti i myslimanit kur të hajë?

Mësimi i 20^{-të}

RREGULLAT E USHQIMIT (2)

7-Mënyra e ngënies

Njeriu duhet të hajë atë që është para tij dhe të mos e zgjatë dorën në atë që është para të tjerëve. Kafshata të jetë e vogël, që të përçapet e të përtypet sa më shpejt, sepse kjo ndihmon edhe procesin e tretjes. Kafshata e madhe, jo vetëm që është e vështirë të përtypet, por nuk i shkon sjelljes së myslimanit. Është mirë që njeriu të hajë në anët e pjatës dhe jo në mesin e saj. Nuk futet kafshata tjetër pa u përtypur e para. Është mirë që të mos shihen të tjerët, nëse mundet dhe të mos hahet me nxitim, por ngadalë e me qetësi, edhe nëse zgjatet qëndrimi në tryezë. Nëse njeriu shikon në tryezë ndonjë ushqim që nuk i pëlqen, të mos e shfaqë pakënaqësinë e të mos flasë keq për të.

Imam Hasani (a.s.) ka thënë: **“Për tryezën ka dymbëdhjetë rregulla, të cilat çdo mysliman duhet t’i njohë. Katër prej tyre janë të detyrueshme (uaxhib), katër janë synnet dhe katër janë të pëlqyeshme (mustehab). Katër të detyrueshmet janë: njohja e burimit të ushqimit, kënaqësia, thënia “Bismilah” dhe thënia “Elhamdulil-lah.” Katër synnetet janë: abdesi para ushqimit, ulja në anën e majtë, të ngrënët me tre gishta dhe lëpirja e gishtave. Katër të pëlqyeshmet janë: të ngrënët e ushqimit që të pëlqen, zvogëlimi i kafshatës, përçapja e saj dhe pakësimi i shikimit tek të tjerët.”**

(Mekrimul Ahlak, f.141.)

Imam Sadiku (a.s.) ka transmetuar se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur dikush do të hajë, të hajë ato që pasojnë.”**

(El Uesail, vëll. 24, f. 369.)

Dhe: **“Për çdo gjë ka kufi, tek i cili përfundon. Atij i sollën një sofër dhe i thanë: “Cili është kufiri i kësaj?” Ai u përgjigj: “Kur të zgjasë dorën, të thotë “Bismilah” dhe kur të mbarojë, të thotë “Elhamdulillah.” Të hajë pranë vetes dhe të mos hajë në atë që ndodhet para të tjerëve.”**

(El Uesail, vëll. 24, f. 370.)

Dhe: **“Qëndroni gjatë në tryezë, sepse ato janë çaste që nuk ju llogariten në moshën tuaj.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 141.)

Dhe: **“Lëreni ushqimin e nxehtë derisa të ftohet, sepse All-llahu nuk na ushqen me zjarr dhe se mirësia është tek ushqimi i ftohtë.”**

(El Uesail, vëll. 24, f. 399.)

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku (a.s.) thuhet: **“I Dërguari i All-llahut e ka ndaluar t’i fryhet ushqimit a pijes së nxehtë.”**

(El Uesail, vëll. 24, f. 401.)

8- Mënjanimi i hajes së tepërt

Duhet mënjanuar ngrënia e tepërt sepse, ndryshe, ka shumë ndikime negative për trupin dhe për shpirtin e njeriut. Hadithet islame e pohojnë këtë.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Mos i vdisni zemrat tuaja duke ngrënë e duke pirë tepër, sepse zemra thahet si ajo bima së cilës i hidhet shumë ujë.”**

(Mekarimul Ahlak, f. 149.)

Dhe: **“Nuk hynë në melekutin e tokës e as atë të qiellit ai që e mbush barkun e tij.”**

(Mizānūl Hikme, kap. 99.)

Dhe: **“Nuk ka gjë më të përbuzur tek All-llahu se sa barku i mbushur.”**

(El Uesail, vëll. 25, f. 24.)

Dhe: **“Mjerë ju prej hajes së tepërt! Ajo të ngurtëson zemrën, të dobëson gjymtyrët e s’bën dot adhurim dhe të bën të painteresuar për dëgjimin e këshillës.”**

(Biharul Anuar, vëll. 74, f. 184, kap. 7.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ushqimi i tepërt dhe gjumi i tepërt shkatërrojnë shpirtin dhe sjellin dëme.”**

(Mustedrekul Uesail, vëll. 16, f. 214.)

Dhe: **“Atij që e shton të ngrënë, i pakësohet shëndeti dhe i rëndohet personaliteti.”**

(Mustedrekul Uesail, vëll. 16, f. 214.)

Dhe: **“Mjerë ju që e mbushni plot barkun! Ajo të ashpëron zemrën, të bën përtac për namazin dhe të shkatërron trupin.”**

(Gurerul Hikem, f. 360.)

Dhe: **“Tejngopja shkatërron të menduarit.”**

(Gurerul Hikem, f. 360.)

Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: **“Kush e pakëson hajen, do të ketë trup të shëndetshëm dhe zemër të pastër. Kush e tepron hajen, do të ketë trup të sëmurë dhe zemër të ngurtë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 59, f. 268, kap. 88.)

Në një tjetër hadith thuhet: **“Ai që e pakëson hajen do t’i lehtësohet gjykimi.”**

(Biharul Anuar, vëll. 59, f. 268, kap. 88.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ngrënia pak është më e pastër për shpirtin dhe më e garantuese për shëndetin.”**

(Gurerul Hikem, f. 320.)

Dhe: **“Kur All-llahu (xh.sh.) ia do të mirën robit të Tij, i frymëzon atij të folurit e rrallë, hajen e paktë dhe fjetjen e paktë.”**

(Gurerul Hikem, f. 360.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ha kur ke oreks dhe ndale hajen kur ke oreks!”**

(Biharul Anuar, vëll. 59, f. 290, kap. 89.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ngrihu nga tryeza edhe pse të hahet prapë. Nëse vepron kështu, ti e shijon më shumë ushqimin.”**

(Biharul Anuar, vëll. 74, f. 219.)

9- Haja me xhemat

S'ka dyshim se ngrënia bashkrisht (me xhemat), me familjen, me shokët, me miqtë, është prej etikës islame dhe Sheriati nxit për këtë.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Bashkohuni kur hani ushqim, sepse All-llahu e bekon atë.”**

(Sunen ibn Maxhab, hadithi 3286.)

Imam Sadiku (a.s.) ka transmetuar se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nëse tek ushqimi janë katër karakteristika ai është i plotë: të jetë prej hallallit, të shtohen duart në të, të thuhet “Bismil-lah” në fillim dhe “Elhamdulillah” në fund.”**

(El Kafj, vëll. 6, f.273.)

10- Etika e ngrënies bashkërisht

Më të vegjëlit në moshë të mos fillojnë të hanë para më të mëdhenjve; por edhe të mëdhenjtë të hanë në kohën e duhur dhe të mos vonohen. Kur hahet, veçanërisht gjatë përçapjes së ushqimit pakësohet të folurit. Sheriati islam e përbuz përçapjen me zë. Në tryezë të mos bëhen veprime që çenojnë të drejtat e të tjerëve. Mikpritësi duhet të veprojë me mikun në atë mënyrë, që ai të hajë me shije ushqimin e përgatitur për të.

Nuk duhet të shihen të tjerët gjatë hajes sepse, mund të turpërohen dhe mund ta lënë uhqimin para se të ngopen.

Mikpritësi duhet të hajë ngadalë sepse, po të hajë shpejt, t'i detyrojë të tjerët të ngrihen nga tryeza pa u ngopur. Nuk duhet të bëhen lëvizje a veprime neveritëse, siç mund të jetë përçapja me zë, mospërdorimi i pecetave për të fshirë buzët etj.

Përgatitësi i ushqimit dhe mikpritësi duhet të fillojnë të parët dhe të mbarojnë të fundit. Në këtë mënyrë të gjithë të pranishmit do të kenë kohën e mjaftueshme për të ngrënë e për t'u ngopur.

Prej etikës islame në haje është që miku të mos e ngarkojë ftuesin jashtë mundësive të tij. Në disa transmetime thuhet se vëllai më i keq është ai që e detyron tjetrin më shumë se mundësitë e tij. Është e pëlqyeshme të fillohet haja sapo të vijë buka, e të mos pritët derisa të vijnë gatesat e tjera.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nderojeni bukën!”** E pyetën: **“Si ta nderojmë?”** Ai u përgjigj: **“Nëse buka vihet në tryezë, të mos pritët derisa të vijnë të tjerat.”**

(El Kafj, vëll. 6, f. 303.)

Përmbledhje

Prej etikës së të ngrënit është që njeriu të hajë ato që ndodhen para tij, të zvogëlojë kafshatën, ta përçapë atë mirë, të mos nxitojë dhe të falënderojë All-llahun pas mbarimit

Prej etikës së të ngrënit është pangopësia. Sheriati e pëlqen që ushqimi të hahet bashkërisht.

Është mirë që të hahet bashkërisht. Kur hahet duhet respektuar të mëdhenjtë. Biseda të larmishme mund të bëhen para ardhjes së ushqimit; kur të vijë koha për të ngrënë, është mirë që njeriu të pakësojë të folurit. Gjatë hajes, nëse mundet, njeriu të mos i shohë të tjerët.

Pyetje

- 1- Flisni shkurtimisht për etikën islame kur hahet.
- 2- Shpjegoni dymbëdhjetë karakteristikat që përmenden për tryezën në hadithin e Imam Hasanit (a.s.)
- 3- Çfarë ka thënë Profeti Muhammed (s.a.u.s.) për ngrënien pa përkore?
- 4- Kur është e pëlqyer që njeriu të çohet nga tryeza e ngrënies?
- 5- Flisni shkurtimisht për etikën e ngrënies bashkërisht!

Mësimi i 21 -të

ADHURIMI (IBADETI)

Që nga lindja e jetës njerëzore, adhurimi ka luajtur rol të vazhdueshëm në veprimtaritë e njerëzve. Çdo shoqëri ka bërë adhurimet sipas një mënyre të caktuar. Kjo tregon se shoqëria kishte nevojë për adhurimin dhe njerëzit anonin kah adhurimi.

Adhurimi e ka burimin te natyra e lindur e njeriut (fitretu) dhe shpreh nevojën e njeriut për Krijuesin e tyre. Nuk është adhurimi ai që e devijon njeriun, është padituria e tij për të vërtetat e kësaj jete ajo që e përplas njeriun nga një shkëmb në një tjetër e së fundi, i hedh në humnerat e humbjes.

Thirrja për ibadet është prej Fuqisë, ndaj të së Cilës njeriu nuk mund të qëndrojë i pavetëdijshëm, edhe nëse ndodhet në pikën më të largët të botës. Prandaj, njerëzit gjatë historisë kanë kërkuar atë, që u shuan etjen e tyre të natyrës së lindur (fitretit).

Adhurimi i All-llahut të vetëm e të pashoq ka qenë edhe mesazhi i të gjithë të dërguarve. Ata kanë ftuar popujt e tyre të adhuronin All-llahun dhe të mos adhurojnë idhujt, dukuritë natyrore, tiranët e diktatorët.

Në këtë mësim do të flasim për rëndësinë e adhurimit, për pozitën e tij në jetën e njerëzve dhe për rolin e tij në formimin e personalitetit njerëzor.

1- Adhurimi, qëllimi i krijimit dhe mesazhi i të dërguarve

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Unë nuk i krijova xhindet dhe njerëzit për tjetër përveçse të më adhurojnë.”**

(Sure “Edb Dharijat”, ajeti 56.)

Është më se qartë se All-llahu (xh.sh.) nuk ka nevojë për adhurimet tona dhe as nuk përfiton prej tyre. All-llahu (xh.sh.) është i Vetëmjaftueshëm dhe i Pasur. Në Kur'an thuhet: **“Nëse ju nuk besoni, All-llahu nuk është nevojtar për ju; megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robwreve të Vet. E, nëse jeni mirënjohës ndaj Tij, Ai e pëlqen atë për ju. Ndërkaq, nuk do ta bartë asnjë mëkatar barrën e tjetrit. Pastaj, e ardhmja juaj është vetëm te Zoti juaj, e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni vepruar. Vërtet, Ai e di shumë mirë se çfarë mbajnë zemrat.”**

(Sure “Ez Zumer”, ajeti 7.)

Mesazhet e të dërguarve kanë qenë drita e së vërtetës, me të cilën ndriçohej rruga e të tjerëve. Të dërguarit kanë qenë model për adhurimin dhe i kanë ftuar njerëzit për adhurim.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: “Adhuroni vetëm All-llahun, e iu largoni djajve (adhurimit të tyre)!” Por, pati nga ata që All-llahu udhëzoi dhe pati nga ata që ishte i gjykuar me humbje; pra, udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte fundi i gënjeshtarëve!”**

(Sure “En Nabl”, ajeti 36.)

Nga këtu kuptojmë se njeriu i vjel frytet e adhurimit për veten e vet; ato janë parapërgatitore për vazhdimin e rrugës së përsosurisë, e cila është afrimi tek All-llahu (xh.sh.). Rruga e vetme e cila e siguron këtë afrim është adhurimi.

All-llahu thotë në Kur'an: **“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju edhe ata që ishin para jush, që të jeni të devotshëm (të shpëtuar).”**

(Sure “El Bekare”, ajeti 21.)

Për mirësinë dhe rëndësinë e namazit, Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Namazi është kurbani i çdo të devotshmi.”**

(Men la jehderubul fakih, vëll. 1, f. 2101)

2- Mirësitë e adhurimit

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Adhurimi është fitore.”**

(Gurerul Hikem, f. 198 / 3932)

Dhe: **“Denjësia e të mirëve është adhurimi i përkryer.”**

(Gurerul Hikem, f. 199 / 3937)

Dhe: **“Nëse All-llahu e do një rob të Tij, i frymëzon atij adhurimin.”**

(Gurerul Hikem, f. 198 / 3935)

Dhe: **“Vazhdimësia në adhurim është argument i fitimit të lumturisë.”**

(Gurerul Hikem, f. 198 / 3936)

Dhe: **“Askush nuk afrohet tek All-llahu, veçse duke e adhuruar Atë.”**

(Gurerul Hikem, f. 199 / 3942)

3- E vërteta e adhurimit dhe e nënshtrimit ndaj All-llahut (xh.sh.)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: “E para punë e adhurimit të All-llahut është njohja e tij dhe themeli i njohjes është Njësishmëria (Teuhidi) i Tij.”

(Biharul Anuar, vëll. 4, f.227, kap. 4)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: “Nënshtrimi është pesë; **khala** e të ngrënit, leximi a këndimi i Kur'anit, namazi i natës, lutja në mëngjes dhe të qarët prej frikës ndaj All-llahut (xh.sh..)”

(Mustedrekul Uesail, vëll. 11, f. 244)

4- Adhurimi me vetëdije

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Dijeni mirë se fillimi i adhurimit të All-llahut është njohja e Tij.”**

(Ammalij i Tusit, f. 526 dhe Biharul Anuar, vëll. 77, f. 47)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nuk ka mirësi në adhurimin, i cili kryhet pa vetëdije.”**

(Biharul Anuar, vëll. 2, f. 49)

Dhe: **“Jini të vetëdijshëm në atë që adhuron, që edhe lëvizja e gjymtyrëve t'u sjellë dobi prej adhurimit që bëni.”**

(Tehful Ukul, f. 223 dhe Biharul Anuar, vëll. 78, f. 63)

Dhe: “**Adhuruesi i pavetëdijshtëm është si gomari, i cili rrotullohet pa lëvizur nga vendi i tij.**”

(Gurerul Hikem, vëll. 2, f. 125)

5- Qëllimi i adhurimit

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: “(Nehxhul Belaga, urtësia 237)

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: “**Vërtet, njerëzit e adhurojnë All-llahun në tri mënyra; disa e adhurojnë Atë duke dëshiruar shpërblimin e Tij. Ky është adhurimi i hurasu dhe kjo është lakmia. Disa të tjerë e adhurojnë All-llahun për t’iu larguar Zjarrit. Ky është adhurim i robërve. Kurse unë e adhuroj Atë për dashurinë ndaj Tij. Ky është adhurim i fisnikëve dhe ajo është siguria, siç thotë edhe Kur’ani: “Kush ka bërë vepër të mirë, do t’i takojë (shpërblim) edhe më i mirë se ajo dhe ata do të jenë të sigurve prej tmerrit të asaj Dite.”** (Sure “En Neml”, ajeti 89). Ai që e do All-llahun, edhe All-llahu e do atë dhe atë të cilin e do All-llahu, do të jetë prej të sigurtëve.”

(Biharul Anuar, vëll. 67, f. 204, kap. 53)

6- Llojet e adhurimit

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “**Adhurimi është në shtatëdhjetë pjesë, ai më i miri është kërkimi i hallallit.**”

(Biharul Anuar, vëll. 100, f. 17, kap. 1)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: “**Meditimi në madhësinë e All-llahut (xh.sh.) është adhurimi më i mirë.**”

(Gurerul Hikem, f. 56)

Dhe: “**Të menduarit për krijimin e qiejve e të Tokës është adhurim i të çiltërve.**”

(Gurerul Hikem, f. 56)

Dhe: “**Vërtet, prej adhurimit janë fjalët e buta dhe përhapja e paqes.**”

(Gurerul Hikem, f. 215)

Nga këto tekste kutojmë se adhurimi nuk nuk është i kufizuar vetëm me kryerjen e disa riteve; ai përfshin edhe mënyrën e të folurit si dhe përhapjen e paqes. Edhe të shikuarit është adhurim.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “**Të shikuarit e fytyrës së dijetarit është adhurim, të shikuarit e fytyrës së prijësit të drejtë është adhurim, të shikuarit e prindërve me dashamirësi e dhembshuri është adhurim, të shikuarit e vëllezërve në fe për hir të All-llahut është adhurim.**”

(Biharul Anuar, vëll. 71, 278)

Kërkimi i dijes së dobishme dhe zhdukja e dijes së pavlefshme është një lloj adhurimi, gjithashtu.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “**Kush del për të kërkuar një kapitull të dijes, me të cilën do të shndërrojë të pavlefshëm në të dobishme, humbjen në udhëzim, është njësoj sikur ka bërë adhurimi për dyzet vjet.**”

(Biharul Anuar, vëll. 1, f. 181.)

Në disa transmetime të tjera thuhet se Xhebraili i ka thënë Profetit Muhammed (s.a.u.s.): “**O Muhammed, sikur adhurimi ynë të bëhej në Tokë, do të kryenim tri vepra të mira; do t’u jepnim ujë myslimanëve, do të përkrahnim familjet nevojtare dhe do të mbulonim gjynahet.**”

(Mizanul Hikmeti, kap. 249.)

Në mbyllje të këtij mësimi duhet thënë se librat e moralit e kanë ndarë dhe e kanë sqaruar temën e adhurimit dhe dobitë e tij. Ajo që u paraqit në këtë mësim ishte vetëm rëndësia e adhurimit në jetën e njeriut.

Përmbledhje

Qëllimi i krijimit të njeriut është arritja e përsosurisë. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet fitimit të kënaqësisë dhe dashurisë së All-llahut (xh.sh.). Sipas Sheriatit islam qëllimi i krijimit të njeriut është që të bëjë adhurim. Adhurimi luan rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut.

Pyetje

- 1- Përse Kur'ani thotë se qëllimi i krijimit të njeriut është që të bëjë ibadet?
- 2- Cili është roli i adhurimit në jetën e njeriut? Sqarojeni me hadithe të bekuara.
- 3- Ç'është ubudijeti (nënshtimi ndaj All-llahut (xh.sh.)?)
- 4- Si duhet të jetë adhurimi?
- 5- Numëroni qëllimet e adhurimit duke i sqaruar shkurtimisht.



Shoqata

Flladi

Mësimi i 22 -të

MIRËSITË E NAMAZIT

Namazi (falja) zë vendin më të lartë ndër adhurimet në Islam. Ai është shtylla e fesë dhe mi'raxhi i besimtarit. Në Ditën e Gjykimit, njeriu do të japë llogari në fillim për namazin. Nëse ai pranohet, do të pranohen të gjitha punët e tjera; nëse nuk do të pranohet, nuk do të pranohen punët e tjera.

Po të hulumtohen ajetet dhe hadithet që flasin për kushtet e namazit, për etikën e tij, për farzet e tij, për detyrat e falësit etj., do të duheshin me dhjetra libra për t'u sqaruar. Në këtë mësim do të flitet për pozitën e lartë që ka namazi duke u mbështetur në ajete e në hadithe.

Namazi në ajetet e Kur'anit

All-llahu (xh. sh.) thotë në Kur'an:

“E, meqenëse ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singertë, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.”

(Sure “El Bejjine”, ajeti 5)

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin; vërtet, namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di ç'punoni ju.”

(Sure “El Ankebut”, ajeti 45.)

“(Ai ndihmon) Ata, të cilët, kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej së keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.”

(Sure “El Haxhxh”, ajeti 41.)

“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz! Vërtet, ajo është e madhe (e vështirë), por jo edhe për ata që e kanë frikë (Zotin).”

(Sure “El Bekare”, ajeti 45.)

“Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat për sa të jem gjallë!”

(Sure “Merjem”, ajeti 31)

“O Zoti im! Më bëj mua e edhe prej pasardhësve të mi nga ata që falin namazin dhe pranoje lutjen time o Zoti ynë!”

(Sure “Ibrahim”, ajeti 40.)

“Kur të kryeni namazin (e frikës), përmendeni All-llahun, kur jeni në këmbë, ulur, të mbështetur. E, kur të qetësoheni (nga lufta), atëherë faleni namazin në mënyrë të rregullt, pse namazi është detyrim (për kohë) i caktuar për besimtarët.”

(Sure “En Nisa”, ajeti 103.)

Namazi në hadithet e Profetit (s.a.u.s.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“All-llahu m’i kënaq sytë me namaz dhe e ka bërë namazin të dashur për mua njësoj si ushqimin të dashur për të uriturin dhe ujin të dashur për të eturin. S’ka dyshim se kur i urituri ha, ngopet dhe kur i eturi pi, e shuan etjen, kurse unë nuk ngopem me faljen e namazit.”**

(Biharul Anuar; vëll. 74, f. 80, kap. 4.)

Dhe: **“Namazi është shtylla Islamit. Ai që e lë namazin me dashje, i është pakësuar besimi. Ai që i lë kohët e namazit (nuk i fal në kohën e vet), hyn në uejl, që është një luginë në Xhehenem, siç thotë All-llahu në Kur’an. Pra, shkatërrim është për ata që falen dhe të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.”**

(Sure “El Maun”, ajetet 4-5.)

Dhe: **“Mos i lini namazet tuaja! Atë që e lë namazin, All-llahu do ta bashkojë me Karunin, Faraonin dhe Hamanin (All-llahu i mallkoftë!). Po ashtu, ai që e lë namazin, e ka plotësuar argumentin që All-llahu ta fusë në Zjarr me dyftytrakët. Mjerë ai që nuk kujdeset për namazin e tij!”**

(Biharul Anuar; vëll. 79, f. 202, kap.1.)

Dhe: **“Kujdesuni për namazin, sepse në Ditën e Gjykimit për të parën gjë që All-llahu i Lartëmadhëruar do ta pyesë robin e Tij, do të jetë a e ka falur namazin të plotë; përndryshe, do ta fusë në Zjarr.”**

(Biharul Anuar; vëll. 79, f. 202, kap.1.)

Dhe: **“Kur të çohesh për të falur namazin e ti drejtohesh kah kiblja, pastaj i bën të gjitha veprimet e namazit duke filluar nga nijeti, leximi a këndimi i sures Fatiha dhe i një sureje tjetër, e kështu me radhë derisa jep selam, ty të janë falur të gjitha gabimet dhe gjynahet derisa të vijë namazi i ardhshëm.”**

(Biharul Anuar; vëll. 79, f. 205, kap.1.)

Dhe: **“Për sa kohë që je në namaz, ti troket në derën e Sunduesit e Xhebbarit. Sunduesi do t’ia hapë atij që i shton trokitjet e derës.”**

(Biharul Anuar; vëll. 74, f. 8, kap. 4.)

Dhe: **“Kur vjen koha e namazit, meleku u thotë njerëzve: Çohuni prej zjarreve tuaja që i keni ndezur mbi shpina dhe fikini ato me faljen e namazeve!”**

(Biharul Anuar; vëll. 79, f. 231, kap.1.)

Namazi në hadithet e Ehli Bejtit (a.s.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Namazi të mbron prej ndikimeve të djallit.”**

(Gurerul Hikem, f. 175, 3343.)

Dhe: **“Namazi zbret mëshirën.”**

(Gurerul Hikem, f. 175, 3313.)

Dhe: **“Betohem në All-llahun, faleni namazin, sepse ai është shtylla e fesë.”**

(Nehxhul Belaga, kap. 47, f. 421.)

Dhe: **“All-llahu e ka bërë besimin pastrues prej politeizmit dhe namazin pastrues prej mendjemadhësisë.”**

(Nehxhul Belaga, urtësia 512.)

Dhe: **“Sikur ta dijë njeriu që fal namazin se çfarë madhështie e All-llahut e mbulon atë, nuk do ta ngrejë kokën prej sexhdes.”**

(Biharul Anuar; vëll. 79, f. 207, kap.1.)

Imam Muhammed Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Kur falësi i namazit drejtohet kah kibla për të falur namaz, Rrahmani (i Gjithmëshirshmi) e sheh në fytyrë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 79, f. 219, kap.1.)

Dhe: **“E para punë për të cilën njeriu do të japë llogari (Ditën Gjykimit), do të jetë namazi. Nëse i pranohet, do t'i pranohen edhe punët e tjera.”**

(Biharul Anuar, vëll. 80, f. 25, kap 6.)

Dhe: **“Për çdo gjë ka ballinë dhe ballina e fesë suaj është namazi.”**

(Biharul Anuar, vëll. 79, f. 227, kap 1.)

Dhe: **“Kush e fal namazin dhe i njeh të drejtat e tij, atij do t'i falen mëkatet.”**

(Biharul Anuar, vëll. 79, f. 207, kap.1.)

Dhe: **“Ai që e lë namazin, nuk ka pjesë në Islam.”**

(Biharul Anuar, vëll. 79, f. 232, kap 1.)

Dhe: **“Dije se namazi është siguria e All-llahut në Tokë. Ai që do të dijë se çfarë fiton prej namazit, të shohë se nëse ai namaz që fal, a e ka siguruar prej të këqijave? Nëse është i tillë, ai e ka kuptuar se dobia e tij është për aq sa është siguruar.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 263, kap.16.)

Përmbledhje

Namazi është prej adhurimeve më të rëndësishme në Sheriatin islam. Ai është i ngjashëm me shtyllat e banesës. Namazi është themeli i adhurimeve. Në hadithe thuhet se e para punë, për të cilën myslimani do të japë llogari Ditën e Gjykimit, do

të jetë namazi. Nëse ai i pranohet, do t'i pranohen edhe punët e tjera; nëse nuk pranohet, nuk do t'i pranohen punët e tjera.

Pyetje

- 1- Cila është pozita e namazit në Islam?
- 2- Sqaroni lidhjet e Profetit (s.a.u.s.) me namazin, siç thuhet në hadithet e bekuara.
- 3- Me çfarë e ka ngjasuar Profeti Muhammed (s.a.u.s.) namazin?
- 4- Si e cilësojnë Imamët e nderuar namazin?



RREGULLAT E NAMAZIT

1- Zbatimi i kushteve të namazit

E para punë që duhet të kryejë falësi i namazit është të interesohet për kushtet e namazit dhe për farzet e tij: abdesi, pastërtia e rrobave, vendi i faljes, koha e tij e saktë etj.

Të interesuarit për leximin a këndimin e rregullt, të thënit e dhikreve të detyrueshme e të tjera veprime, të gjitha këto përmenden të shtjelluara në librat e “Resailul amelijeti”.

Është detyrë e çdo falësi që të njihet sa më shumë me rregullat e namazit. Nëse nuk i njeh ato ose e shpërfill njohjen e tyre, namazi i tij do të jetë i parregullt.

2- Etika e pranisë në namaz

Kur njeriu të drejtohet për të falur namazin, para se të fillojë faljen, duhet të jetë i vetëdijshëm për atë që do të bëjë.

Ai duhet të jetë i vetëdijshëm se në ato çaste ndodhet përpara All-llahut të Lartmadhëruar. Për këtë, falësi të mos bëjë lëvizje të tepërta, të cilat nuk kanë të bëjnë me namazin dhe që e prishin përkushtimin në namaz.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Adhuroje Zotin tënd sikur ti e sheh Atë! Nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”**

(Biharul Anuar, vëll. 74, f. 75, kap.4.)

Në jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: Një ditë, kur Profeti hyri në xhami, pa Enesin birin e Malikut që po falej dhe po shikonte përqark. Profeti (s.a.u.s.) i tha: **“O Enes! Fale namazin në atë mënyrë, sikur të mendosh se ti nuk do të mundesh të falësh më namaz pas tij. Shikimin përqendroje te vendi i suxhudit dhe mos shih se kush është në anën e djathtë e as në anën majtë! Dije se ti ndodhesh para Atij që të sheh, kurse ti nuk e shikon Atë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 264, kap.16.)

Një ditë, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) pa një burrë që po luante me mjekrën e tij kur po falej. Profeti (s.a.u.s.) tha: **“Sikur zemra e tij të ishte e frikësuar, do të frikësoheshin edhe gjymtyrët.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 228, kap. 16.)

Ai (s.a.u.s.) ka thënë: ***“Vërtet, All-llahu jua ka përbuzur juve gjashtë veprime:.... Deri sa tha; mospërqëndrimin në namaz.”***

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 227, kap. 16.)

Imam Muhammed Bakiri (a.s.) duke cilësuar namazin e babait të tij, Imam Zejnul Abidinit (Sexhadi) (a.s.), ka thënë: ***“Kur çohet për të falur namazin, ishte si pema e palëvizshme, përveçse të asaj (gjetheve) që ia lëvizte era.”***

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 284, kap. 16.)

3- Gjallëria dhe dashuria

Është detyrë që falësi ta falë namazin me gjallëri, energji dhe dashuri. Ta largojë gjendjen e përtacisë, e cila e zbeh dëshirën për namazin.

Kur’ani Famëlartë i cilëson dyfytyrakët përtacë ndaj namazit. Ai thotë: ***“Dyfytyrakët përpiqen të mashtrojnë All-llahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por All-llahu i mbizotëron dinakëritë e tyre. Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin All-llahun.”***

(Sure “En Nisa”, ajeti 142.)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: ***“Më i miri ndër njerëzit është ai që ka mallëngjim për namazin, e kryen atë, e do me gjithë zemër, e fillon me trupin e tij dhe e fal në kohën e tij. Ai nuk do t’ia dijë për ato që i ndodhin në këtë jetë, qofshin vështirësi apo lehtësi.”***

(Biharul Anuar, vëll. 67, f. 253, kap. 55.)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: ***“Mos e fal namazin me përtaci, as me përgjumësi e as në gjendje të rëndomtë, sepse këto janë prej shenjave të dyfytyrësisë. Vërtet, All-llahu i ndalon besimtarët që të çohen për ta falur namazin kur janë të përgjumë.”***

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 231, kap. 16.)

4- Frika

All-llahu i cilëson besimtarët të frikësuar, kur ata falin namazin. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: ***“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit.”***

(Sure “El Mu’minun”, ajetet 1-2)

E kanë pyetur Profetin (s.a.u.s.) për frikën në namaz. Profeti (s.a.u.s.) është përgjigjur: ***“Ajo është thjeshtësia në namaz dhe rob i jetë plotësisht i pranishëm me zemër para Zotit të vet.”***

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 246, kap. 16.)

Dijetarët e moralit e kanë ndarë frikën në dy pjesë:

- a- **Frika e zemrës.** Kjo do të thotë që zemra të jetë e zbrazët prej të gjitha çështjeve të kësaj jete si dhe prej atyre që e pengojnë njeriun të afrohet tek All-llahu (xh.sh.)

b- **Frika e trupit.** Kjo do të totë që të ruhet dhe njeriu të mos bëjë lëvizje të tepërta, të cilat nuk kanë lidhje me namazin. Shikimi të jetë i përqendruar te vendi i suxhudit dhe ta mbulojë qetësia.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, namazi është përqendrim, thjeshtësi, përvuajtje, frikë, pendim dhe bindje. Kur të ngresh duart për t’u lutur, thuaj: “O Zot... O Zot...! Ai që nuk e bën këtë, është i dështuar.”**

(Ihjaul Ulumi Dijn; kreu, sekretet e namazit.)

5- Prania e zemrës

Falësi duhet të jetë i pranishëm me zemër kur të falë namazin. Kur të bëjë nijetin e faljes, të mos mendojë për gjëra, të cilat ia çorientojnë mendjen; të jetë i vëmendshëm se ai po qëndron para All-llahut Fuqiptotë, Krijuesit të gjithësisë dhe të mos mendojë për çështjet e dynjasë, por të jetë i përqendruar në lutjet që i bën Zotit (xh.sh.)

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“All-llahu nuk ia pranon namazin atij njeriu, zemra e të cilit nuk është e pranishme me gjymtyrët e tij.”**

(Bihaul Anuar, vëll. 81, f. 242, kap. 16.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Askush prej jush mos jetë përtac në faljen e namazit. As i përgjumët e as të mendojë për veten e vet, sepse ai ndodhet para All-llahut (xh.sh.) Njeriu fiton prej namazit aq sa zemra e tij është e pranishme në namaz.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 239, kap. 16.)

Hamze ebu Themalij na përcjell: **“Një ditë pashë Imam Zejnul Abidin (a.s.) duke u falur. Në ato çaste atij i rrëshqiti xhybja në tokë. Kur Imami mbaroi së faluri namazin, u afrova dhe i thashë: “Përse nuk e rregulove xhyben?” Ai mu përgjigj: “I mjeri ti! Para kujt ndodhesha unë? S’ka dyshim, se rob i pranohet ai namaz, kur zemra ka qenë e pranishme.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 237, kap. 16.)

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Atij robi që falet, nuk i shkruhet as 1/6 -ta as 1/10 -ta e namazit, por i shkruhet ai namaz që e ka kuptuar.”**

(Biharul Anuar, vëll. 81, f. 249, kap. 16.)

6- Nderimi i namazit

Besimtari duhet ta nderojë e ta respektojë namazin. Namazi të jetë synimi kryesor në jetën e tij. S’ka dyshim, se nënvleftësimi i namazit është prej gjynaheve të mëdha.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) dhe Imamët e Ehli Bejt (a.s.) paralajmërojnë për pasojat e nënvleftësimit të namazit.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nuk është prej meje ai që e nënvleftëson namazin. Ai nuk do të takohet me mua në burimin e Keutherit. Jo, për All-llah!”**

(El Uesail, vëll. 4, f. 23, kap. 6.)

Imam Muhammed Bakiri (a.s.) ka thënë: ***“Mos e nënvlefëso namazin, sepse Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: “Nuk është prej meje ai që e nënvlefëson namazin e tij.”***

(Biharul Annuar, vëll. 79, f. 224, kap.1.)

7- Koha e përkryer

Është mirë që myslimani ta falë namazin në fillim të kohës së tij dhe të mos e vonojë faljen. Për këtë nxit edhe Sheriati islam. Falja e namazit në kohën e tij tregon se njeriu e do dhe e nderon namazin.

Imam Xha'fer Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Mirësia e kohës së faljes së namazit në fillim të saj me fundin e kohës së faljes së namazit, është njësoj si mirësia e Ahiretit mbi dynjanë.”***

(Mustedrekul Uesail, vëll. 3, f. 102, kap. 3.)

Dhe: ***“S’ka dyshim se mirësia e faljes në fillim të kohës me mirësinë në fund të kohës është më e mirë për besimtarin sesa pasuria e tij dhe fëmijët e tij.”***

(Biharul Annuar, vëll. 82, kap.5.)

8- Zbukurimi

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: ***“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz...!”***
(Sure “El A'raf”, ajeti 31)

Nga ky ajet kuptojmë se kur njeriu të bëhet gati për të falur namazin, duhet të jetë me pamjen më të mirë: të veshë rroba të pastra, sepse në ato çaste ai ndodhet para All-llahut (xh.sh.).

9- Falja e namazit me xhemat

Është mirë që besimtari ta falë namazin me xhemat, nëse ka mundësi. Shkuarja në xhami për të falur namazin ka shpërblim të madh, të cilin e di vetëm All-llahu (xh.sh.). Në hadithet e nderuara thuhet se kur xhemati arrin në dhjetë veta, melekët nuk arrijnë të shkruajnë shpërblimin e atij namazi.

Përmbledhje

S’ka dyshim se interesimi për kushtet e namazit, si prania e zemrës, gjallëria dhe optimizmi, frika ndaj All-llahut (xh.sh.) etj: janë prej etikës së namazit.

Po ashtu, falja e namazit në kohën e tij konsiderohet prej etikës, e cila duhet zbatuar nga çdo mysliman.

Pyetje

- 1- Sqaroni mënyrën e pranisë para All-llahut (xh.sh.) në namaz?
- 2- Si e cilëson Kur'anë namazin e dyfytyrakëve?
- 3- Cilët janë njerëzit më të mirë? Sqarojeni duke përmendur një hadith të Profetit (s.a.v.s.).
- 4- Çdo të thotë fraza “frika ndaj All-llahut (xh.sh.)”?

5- Shpjegoni shkurtimisht mirësinë e faljes së namazit në kohën e caktuar.



Mësimi i 24^{-tw}

MIRËSITË E AGJËRIMIT

Për nga rëndësia, pas namazit vjen agjërimi. Edhe agjërimi zë vend të lartë në Sheriatin islam dhe është detyrë për besimtarët.

All-llahu e ka bërë detyrë agjërimin që të bëhet në muajin e bekuar të Ramazanit. Në librat e Fikhut sqarohen të gjitha rregullat e këtij adhurimi.

Agjërimi është mënyrë e përkryer për edukimin e shpirtit, për pastrimin e zemrës, për forcimin e vullnetit dhe për frenimin e epsheve. Ai lartëson shpirtin, forcon dashurinë për All-llahun (xh.sh.) dhe fitimin e kënaqësisë së Tij, të cilën e pason hyrja në Xhennet.

Në këtë mësim do të flitet për rëndësinë e agjëritit dhe për frytet e tij, siç thotë Kur'ani, siç thonë hadithet e Profetit Muhammed (s.a.u.s.) dhe të Ehli Bejtit (a.s.). Po ashtu, do të flitet për rregullat dhe kushtet e agjëritit.

1- Agjërimi është për Mua...

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: *“All-llahu (xh.sh.) ka thënë: Çdo e mirë shpërblehet me dhjetëfish e deri në shtatëdhjetëfish, përveç agjëritit, sepse Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të.”*

(Sunen Nisai, vëll. 4)

Për kuptimin e fjalës (sabr) *“durim”* që përmendet në ajetin: *“isteinu bi sabri ue bi salati”*, Imam Xha'fer Sadiku (a.s.) ka thënë: Ai është *“agjërimi.”* Ky hadith sqaron edhe kuptimin e ajetit 45 të sures *“El Bekare”*: ***Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz...***

(El Kafij, vëll. 4)

Edhe Zbulesa e All-llahut (xh.sh.), ***“Thuaj: “O robtë e Mi që kenë besuar, kijen frikë Zotin tuaj! Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjerë, ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”*** (Sure *“Ez Zummer”*, ajeti 10), ka kuptimin: adhurimet që bën njeriu kanë shpërblim të caktuar, përveç agjëritit, sepse vetëm All-llahu (xh.sh.) është Ai i Cili e di shpërblimin e agjëritit. Nga këtu kutojmë se agjërimi ka vlerësim të lartë. Në një hadith të Profetit Muhammed (s.a.u.s.) thuhet: ***“All-llahu (xh.sh.) ka thënë: Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjëritit, sepse agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë për njeriun në Ditën e Gjykimit. Era që del nga goja e agjëruetit është më e këndshme tek All-llahu (xh.sh.) sesa era e miskut (lloj erzine). Për agjëruetin ka dy gëzime: njëri kur çel iftarin dhe tjetri kur të më takojë Mua dhe Unë e fus atë në Xhennet.”***

(Biharul Anuar, vëll. 93 f. 249, kap.30.)

Po ashtu, përcillet se Profeti (s.a.u.s.) ka thënë: ***“Beto hem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im se era e gojës së agjëruetit është më e këndshme tek All-llahu (xh.sh.) sesa era e miskut. All-llahu Fuqplotë thotë: “Ai (agjërueti), për hirin Tim u largohet epsheve të tij, lë të ngrënë të pirët. Prandaj, agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të.”***

(Sahihu i Buhariut, vëll. 3)

2- Agjërimi është mburojë

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Agjërimi është mburojë prej Zjarrit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 126, kap. 14.)

Dhe: “Agjëroni, sepse ai është mburojë prej Zjarrit! Nëse ke mundësi që vdekja të të gjejë me barkun bosh (duke agjëruar), bëje!”

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 258, kap. 30.)

Arsyea që Profeti (s.a.u.s.) e quan agjërimin mburojë prej Zjarrit, është se agjërimi prangos epshet dhe zemërimin. Dihet që këto dy instinkte luajnë rol të madh në shmangjen e njeriut.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Agjërimi është mburojë prej Zjarrit, nëse nuk e bën të pavlefshëm atë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 296, kap. 36.)

3- Arsytet e agjërimin

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“All-llahu e ka bërë detyrë agjërimin për të sqaruar çiltërsinë e njerëzve.”**

(Nehxhul Belaga, urtësia 252.)

Zonja Fatime Zahra (a.s.) ka thënë: **“All-llahu e ka bërë agjërimin detyrë dhe përforcues për çiltërsinë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 368, kap. 46.)

Imam Xha'fer Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Arsyea e agjërimin është që me anë të tij të barazohet i pasuri me të varfrin. Kjo, sepse i pasuri nuk e ka provuar të preket nga uria; kështu, kur të agjërojë, të mëshirojë të varfrin. Kur i pasuri do diçka, ai ka mundësi ta sigurojë. Prandaj, All-llahu do që i pasuri të jetë i njëjtë me të varfrin dhe i pasuri të shijojë urinë dhe lëndimin, me qëllim që të bëhet zemërbutë ndaj të paafteve dhe të mëshirojë të varfrit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 371, kap. 46.)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Nëse dikush do të thotë: Përse janë urdhëruar për të agjëruar?, atij i thuhet: “Që të njohin dhimbjen e urisë e të etjes, të faktojnë varfrinë në Ahiret dhe agjëruesi të jetë i frikësuar, të shpërblehet, të durojë dhe ta njohë urinë e etjen. Agjërimi të jetë këshillues për ata në meditime dhe stërvitës për kryerjen e detyrave të ngarkuara; të jetë tregues për Ahiretin; me anë të tij të njohin vështirësitë e të varfërve e të nevojtarëve në këtë jetë dhe t'u japin atyre të drejtat që All-llahu u ka ngarkuar në pasuritë e tyre.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 369, kap. 46.)

4- Ndikimet shpirtërore të agjërimin

Agjërimi ka shumë ndikime shpirtërore dhe forcon solidaritetin mes individëve të shoqërisë

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Gjumi i agjëruetit është adhurim dhe frymëmarrja e tij është lartësim (tesbiih).”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 258, kap. 30.)

Dhe: **“Vërtet, All-llahu i ka ngarkuar melekët të bëjnë lutje për agjëruesit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 253, kap. 30.)

Dhe: **“Ai që e agjëron një ditë vullnetarisht, është sikur t’i jetë dhënë pasuria e gjithë Tokës. Shpërblimi më i madh për të do të jetë në Ditën e Gjykimit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 252, kap. 30.)

Dhe: **“Agjëruesi është gjithmonë duke e adhuruar All-llahun (xh.sh.), edhe kur është duke fjetur mbi shtratin e tij dhe nuk i përgojon myslimanët.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 247, kap. 30.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Gjumi i agjëruesit është adhurim, heshtja e tij është lartësim, dua ja e tij është e pranueshme dhe punët e tij janë të shpërbllyera.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 255, kap. 30.)

Dhe: **“S’ka dyshim se lutja e agjëruesit në iftar është e pranueshme.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 255, kap. 30.)

5- Kufijtë e agjërimit

Nëse agjërimi ka kaq shumë rëndësi, atëherë cilët janë kufijtë e tij?

Imam Xha’fer Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Agjërimi nuk është vetëm të mos hash e të mos pish. Kur të agjërosh, le të agjërojë syri yt, veshi yt, gjuha jote, barku yt dhe auresi ose nderi yt! Ruaje dorën tënde dhe auresin tënd, shtojë heshtjen, bëj vetëm mirësi dhe bëhu i butë me shërbyesin tënd.”**

(El Uesail, vëll. 10, f. 165, kap. 11)

Imam Rizai (a.s.) ka thënë: **“Kur të agjëroni, le të agjërojnë të shikuarit tuaj, të dëgjuarit tuaj, lëkura jote dhe floku yt.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f. 291, kap. 36.)

Përmbledhje

Agjërimi zë vend të lartë në adhurimet islame. Ai është mënyra më e përsosur për edukimin e shpirtit, për forcimin e vullnetit dhe për frenimin dhe prangosjen e epsheve. Vërtet, All-llahu i Lartësuar i ka premtuar agjëruesit shpërblim të madh, të cilin askush nuk e përfytyron dot.

Pyetje

- 1- Përse All-llahu (xh.sh.) ka thënë: “Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të?”
- 2- Në hadithe thuhet se për agjërimin gjenden dy gëzime. Cilët janë ato?
- 3- Çfarë kuptimi ka hadithi: **“Agjërimi është mburojë prej Zjarrit.”?**
- 4- Cila është arsyeja që agjërimi është bërë detyrim?
- 5- Sqaroni ndikimet shpirtërore të agjërimit!
- 6- A është i kufizuar agjërimi vetëm me largimin prej ngrënies e pirjes? Sqarojeni shkurtimisht!



Mësimi i 25^{-të}

MIRËSITË E KUR'ANIT FAMËLARTË DHE POZITA E TIJ

1- Mirësitë e Kur'anit

S'ka dyshim se Kur'ani Famëlartë është lidhja e fortë e zgjatur nga qielli në tokë. Ai është njëri prej dy të çmueshmeve që Profeti Muhammed (s.a.u.s.) na e ka lënë amanet deri në Ditën e Kijametit.

Profeti Muhammd (s.a.u.s.) ka thënë: **“Mirësia e Kur'anit mbi thëniet e tjera është njësoj si mirësitë e All-llahut mbi robtë e Tij.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 17, kap. 1)

Dhe: **“Kur'ani është pasuri mbi pasuritë dhe nuk ka varfëri pas saj.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 17, kap. 1)

Dhe: **“Thënia më e vërtetë, këshilla më e lartë dhe tregimi më i përsosur është Libri i All-llahut.”**

(Biharur Anuar, vëll. 74, f. 116, kap. 6)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Zbatojeni Kur'anin dhe merreni atë për udhërrëfyes dhe prijës.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /4029)

Dhe: “Nehxhul Belaga, fjalimi 176)

2- Mirësitë e leximit të këndimit të Kur'anit

Rreth mirësisë së leximit a të këndimit të Kur'anit, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë:

- **“Adhurimi më i mirë i ummetit tim (bashkësisë islame) është leximi a këndimi i Kur'anit.”**

(Sunenu Darimij, vëll. 2.)

- **“Studiuesit dhe zbatuesit e Kur'anit janë më të mirët dhe të veçantë tek All-llahu.”**

(Sunenu ibn Maxhah, hadithi /251.)

- **“Vërtet, zemrat ndryshken njësoj siç ndryshket hekuri,”** - tha Profeti (s.a.u.s.). E pyetën: **“O i dërguari i All-llahut! Cili është pastruesi i tyre?”** Ai iu përgjigj: **“Leximi a këndimi i Kur'anit dhe kujtimi i vdekjes.”**

(Ihjau ulumi dijn, kapitulli i etikave dhe Mustedrekul Uesail, vëll. 2, f. 104.)

- **Nëse dikush prej jush dëshiron të flasë me Zotin e tij, le të lexojë a të këndojë Kur'anin!”**

(Kenzul Ummal, kreu leximi i Kur'anit, hadithi /2257.)

- **Zbatoje leximin a këndimin e Kur'anit, sepse leximi a këndimi i tij shlyen gjynahet, është mbulim prej zjarrit dhe siguri prej dënimit.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 17, kap. 1)

- **Mos u bëj i pavëmendshëm ndaj leximit a këndimit të Kur'anit, sepse Kur'ani ringjall zemrën dhe ndalon nga të këqijat dhe imoraliteti.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /4032.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Atë, që gjithmonë e lexon a e këndon me vëmendje e përqendrim Kur'anin, nuk e frikëson (mërzit) vetmia.”**

(Gurerul Hikem, f. 112, 1993.)

Dhe: **“Pjalmimi i imanit (besimit) është leximi (këndimi) i Kur'anit.”**

(Gurerul Hikem, f. 112, 1992.)

Imam Xha'fer Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ai që e lexon a e këndon Kur'anin kur është në moshë të re, Kur'ani i është përzier me gjakun dhe me mishin e tij.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 187, kap. 20.)

3- Mirësia e mësimit dhe e të mësuarit të Kur'anit

Edhe për këtë temë ka mjaft hadithe të përcjella nga profeti Muhammed (s.a.v.s.). Ne do të përmendim disa prej tyre.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Vërtet, Kur’ani është tryeza e All-llahut, prandaj ushqehuni (mësoni) sa të mundeni nga tryeza e Tij.”**

(Kenzul Ummal, vëll. 1, f. 526, hadithi /2357.)

Në porositë e tij drejtuar Meadhut, Profeti (s.a.v.s.) i ka thënë: **“O Meadh! “Nëse dëshiron jetesë (si ajo) e të lumturve, vdekje (si ajo) e dëshmorëve, shpëtim në Ditën e Gjykimit, freskinë e hijes në ditën më të nxehtë (Ditën e Gjykimit) dhe udhëzim prej humbjes, atëherë mësoje Kur’anin, sepse ai është fjala e Mëshiruesit dhe mbrojtje prej djallit. Ai (Kur’ani) shton mirësitë në peshoren e të mirave.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2439)

Dhe: **“Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kur’anin dhe ua mëson atë të tjerëve.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2351.)

Dhe: **“Kush ia mëson një tjetri një ajet nga Libri i All-llahut, është kujdestar i tij. Nuk duhet ta poshtërojë e as nëse e bën këtë e ka këput një lidhje prej lidhjeve të Islamit.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2320.)

Dhe: **“Kur disa njerëz mblidhen në një prej shtëpive të All-llahut dhe në të lexojnë a këndojnë Kur’an dhe e studiojnë atë, atyre u zbret qetësia, i mbulon mëshira dhe janë të rrethuar nga melekët.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2330.)

Dhe: **“Kushdo që ia mëson Kur’anin fëmijës së vet, i ka varur atij një gjerdan, me të cilin do të habiten të gjithë prej tij Ditën e Gjykimit.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /2386.)

Dhe: **“Kur’ani do të jetë shërues dhe udhërrëfyes për në Xhennet për këdo që e mëson Kur’anin, ua mëson atë të tjerëve dhe i zbaton ato që gjenden në të.”**

(“Kenzul Ummal”, Hadithi 2376).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“E drejta e fëmijës ndaj prindërve të tij është ta quajë me emër të bukur, ta edukojë me edukatë të lartë dhe t’i mësojë atij Kur’anin.”**

(Nehxhul Belaga, urtësia 399.)

Dhe: **“Mësojeni Kur’anin, sepse ai është thënia më e përkryer! Thellohuni në kuptimin e tij, sepse ai është pranvera e zemrave! Shërohuni me dritën e tij, sepse ai është shërues për gjoksat! Lexojeni (këndojeni) sa më mirë atë, sepse ai përmban tregime të dobishme.”**

(Nehxhul Belaga, fjalimi 110.)

Imam Xha’fer Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtari duhet të mos vdesë pa e mësuar Kur’anin ose të jetë duke e mësuar atë.”**

4- Mirësitë e zbatimit të Kur'anit dhe e hifzit (mësimi përmendësh) të tij

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: ““Më fisnikët e ummetit tim janë mbartësit e Kur'anit dhe falësit e namazit të natës.”

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 189, kap. 20.)

Dhe: “Mbartësit e Kur'anit janë më të njohurit e banorëve të Xhenetit.”

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 177, kap. 19.)

Dhe: “All-llahu nuk e dënon atë zemër, e cila e ka kuptuar Kur'anin.”

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 175, kap. 19.)

Dhe: “Ka njerëz që e lexojnë (a e këndojnë) Kur'anin që të tjerët të thonë se filani është lexues a këndues i Kur'anit. Ka të tjerë që e lexojnë (a e këndojnë) atë për të fituar të mirat e kësaj jete. Për të dy këto grupe nuk ka mirësi. Ka njerëz që e lexojnë a e këndojnë Kur'anin që të përfitojnë prej tij në namaze dhe ta zbatojnë atë në jetën e tyre.”

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 175, kap. 19.)

5- Heshtja dhe dëgjimi me vëmendje

Edhe për këtë temë nuk mungojnë hadithet e profetit Muhammed (s.a.v.s.). Ndër ato janë:

“Ai që ka mall për All-llahun, të dëgjojë me vëmendje fjalët e Tij!”

(Kenzul Ummal, hadithi /2472.)

“Atij që dëgjon me vëmendje një ajet nga Kur'ani, ky dëgjim i shkruhet e mirë e shumëfishuar. Për atë që lexon a këndon një ajet nga Kur'ani, ajeti do të jetë dritë në Ditën e Gjykimit.”

(Kenzul Ummal, hadithi /1316.)

Dhe: “Lexuesit a kënduesit të Kur'anit i largohen fatkeqësitë në këtë jetë dhe dëgjuesit me vëmendje të Kur'anit i largohen fatkeqësitë në Ditën e Gjykimit.”

(Kenzul Ummal, hadithi /4031.)

Përmbledhje

S'ka dyshim se Kur'ani është udhëzues e drejtues për mbarë njerëzimin. Ai tregon rrugën e lumturisë. Prandaj, leximi a këndimi i tij, zbatimi i kuptimeve që ai përmban dhe ndriçimi me dritën e tij janë zbulues të rrugës që të çon në lumturinë e kërkuar. Hadithet e profetit Muhammed (s.a.v.s.) dhe të Ehli Bejt (a.s.) ftojnë për të lexuar a kënduar Kur'ani, për ta mësuar përmendsh, për ta dëgjuar me vëmendje atë dhe për të zbatuar kuptimet që ai përmban, sepse ai është drita e vërtetë dhe e pashuar.

Pyetje

- 1- Sqaroni pozitën dhe rëndësinë e Kur'anit famëlartë siç thuhet hadithet e nderuara!
- 2- Cilat janë ndikimet shpirtërore të studimit të Kur'anit?
- 3- Shpjegoni rëndësinë e mësimit dhe të të mësuarit të Kur'anit!

- 4- Çfarë shpërblimi ka ai njeri që e dëgjon me vëmendje e në heshtje leximin (a këndimin) e Kur'anit?
- 5- Cila është mënyra me të cilën mund të nderohen hafëzat e Kur'anit famëlartë?



Mësimi i 26 të

ETIKA E LEXIMIT A E KËNDIMIT TË KUR'ANIT

Kur'ani Famëlartë është fjala e All-llahut (xh.sh.) dhe libri i Tij udhëzues. Ai ndryshon nga librat e tjerë. Prandaj, ka rregulla për leximin a këndimin e tij.

Është detyrë e çdo myslimani që të interesohet për këto rregulla, sepse një pjesë e tyre kanë të bëjnë me respektin dhe shenjtërinë e Kur'anit dhe një pjesë tjetër kanë të bëjnë me kuptimin dhe zbatimin e tij, që të përfitohet prej mirësive e dobive që gjenden në Kur'an.

Më poshtë do të flitet për disa nga këto rregulla.

1- Etikë e jashtme

Kur njeriu dëshiron të lexojë a të këndojë Kur'anin, është mirë që të marrë abdes, të jetë i pastër, të ulet para Kur'anit me respekt e me disiplinë, të jetë i thjeshtë para tij, në këmbë apo ulur, të largojë prej vetes së tij mendjemadhësinë dhe të mos i shtrijë këmbët kur është i ulur, me një fjalë, duhet t'u shmanget veprimeve që e prishin etikën e leximit a të këndimit të këtij libri madhështor. Përveç këtyre që përmendëm, është mirë që lexuesi a kënduesi i Kur'anit të pastrojë gojën dhe dhëmbët.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Pastrojeni rrugën e Kur'anit.”** I thanë: **“O i dërguari i All-llahut, cila është rruga e Kur'anit?”** Ai u përgjigj: **“Gojët tuaja.”** E pyetën prapë: **“Me çfarë t'i pastrojmë?”** Ai (s.a.v.s.) u përgjigj: **“Me siuak.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 213, kap. 26.)

Dhe: **“Vërtet, gojët tuaja janë rrugët e Kur'anit, prandaj mermëzojini (aromatizojini) ato me siuak!”**

(Kenzul Ummal, hadithi / 2751 dhe Biharul Anuar, vëll. 81, f. 330, kap. 20.)

2- Vendi i leximit a i këndimit të Kur'anit

Është detyrë e çdo myslimani të ruajë shenjtërinë e Kur'anit. Nuk lejohet që myslimani të lexojë Kur'an a të këndojë në tualet a në vende të tjera të papastra e të ndyta. Myslmani duhet të zgjedhë vendin më të pastër e më të shenjtë, siç janë xhamitë. Sigurisht, myslimani e lexon a e këndon Kur'anin edhe në shtëpinë e tij.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ndriçojini shtëpitë tuaja me këndimin e Kur'anit, sepse, asaj shtëpie kur këndohet shpesh Kur'ani, i shtohen mirësitë dhe banorët e saj janë të lumtur. Ata u japin dritë banorëve të qiellit ashtu siç japin dritë yjet për banorët e kësaj dynjaje.”**

(El Kafij, vëll. 2, f. 610.)

Dhe: **“Ai person, brenda të cilit nuk gjendet asgjë prej Kur'anit, është si banesa e shkatërruar (rrënoja).”**

(“Kenzul Ummal”, Hadithi / 2487)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Në atë shtëpi ku lexohet a këndohet Kur'an dhe përmendet All-llahu (xh.sh.), shtohen mirësitë e saj, melekët janë të pranishëm, largohen djajtë dhe ndriçohen banorët e qiellit njësoj siç ndriçohen banorët e Tokës nga yjet. Në atë shtëpi ku nuk lexohet a nuk**

këndohet Kur'an e as nuk përmendet All-llahu (xh.sh.), pakësohen mirësitë, largohen melekët dhe janë të pranishëm djajtë.”

(*El Kafij, vëll. 2, f. 610.*)

3- Sasia e leximit a e këndimit të Kur'anit

Hadithet thonë se sasia e leximit a e këndimit të Kur'anit në çdo ditë është pesëdhjetë ajete.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kur'ani është besa e All-llahut për krijesat e Tij. Myslimani duhet të shohë në besën e tij dhe të lexojë a të këndojë pesëdhjetë ajete.”**

(*El Kafij, vëll. 2, f. 609.*)

Por, është e natyrshme që njeriu të lexojë a të këndojë Kur'an, sa më shumë me lexim të rregullt dhe ta kuptojë atë.

E kanë pyetur Imam Sadikun (a.s.) për hatmen (leximn a këndimin e plotë) të Kur'anit në çdo ditë e ai është përgjigjur: **“Nuk më pëlqen që ta lexosh a ta këndosh për më pak se një muaj.”**

(*El Kafij, vëll. 2, f. 617.*)

Është më se e qartë se ai që do të lexojë gjithë Kur'anin brenda ditës, nuk i del kohë që të përqendrohet në kuptimin e ajeteve të tij.

Profet Muhammed (s.a.v.s.) ka thënë: **“Ai që e lexon Kur'anin për më pak se tri ditë, nuk e ka kuptuar atë.”**

(*Sunen ibn Maxbah, hadithi / 1347.*)

4- 5- Istiadh-ja dhe besmel-ja

Prej etikës së leximit a të këndimit të Kur'anit është që të thuhet “Eudhu bil-lahi mine shejtani rrahim”, që do të thotë “Mbrohemi nga All-llahu prej djallit të mallkuar.” All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Kur të lexosh a të këndosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e All-llahut prej djallit të mallkuar.”**

(*Sure “En Nahl”, ajeti 98.*)

Pastaj thuhet “Bismil-lahi rrahmani rrahim” që do të thotë “Me emrin e All-llahut të Gjthmëshirshmit Mëshirplotit.” Pas tyre fillon e lexon a këndon Kur'anin.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Mbyllini dyert e mëkateve me istiadhen dhe hapini ato me besmelen.”**

(*Biharul Anuar, vëll. 89, f. 216, kap. 26.*)

Në jetëshkrimin e Imam Musa Kadhimit (a.s.) thuhet: **“Sa herë që Imami sillte për argument një ajet Kur'ani, para se të lexonte ajetin thoshte “eudhu bil-lahi mine shejtani rrahijm bismil-lahi rrahmani rrahijm, pastaj lexonte ajetin.”**

(*Biharul Anuar, vëll. 89, f. 210, kap. 26.*)

6-Tertili i Kur'anit

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Ose shto diçka prej saj dhe Kur'anin lexoje me vëmendje.”**

(Sure “El Muzemmil”, ajeti 4)

7- Zëri i bukur

Është mirë që myslimani ta këndojë a lexojë Kur'anin me zë të bukur.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Zbukurojeni Kur'anin me zërat tuaj.”**

(Sunen Darimij, vëll. 2.)

Dhe: **“Zëri i bukur është zbukurim për Kur'anin.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 190, kap. 21.)

Dhe: **“S'ka dyshim se çdo gjë ka bukurinë e saj dhe bukuria e Kur'anit është zëri i bukur.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 190, kap. 21.)

8- Frika dhe trishtimi

Prej etikës së leximit a këndimit të Kur'anit është që gjatë leximit a këndimit njeriun ta mbulojë ndjenja e frikës dhe e trishtimit.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan, të zbuten me këshillat e All-llahut dhe me atë të Vërtetën që zbriti (me Kur'an) e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë Libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës.”**

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Lexojeni a këndojeni Kur'anin me trishtim se i tillë ka zbritur.”**

(Kenzul Ummal, hadithi / 2777.)

Dhe: **“Lexojeni Kur'anin dhe qani, nëse nuk qani tebakuu (mundohuni të qani).”**

(Sunen ibn Maxhah, hadithi 4196.)

Dhe: **“Ata sy që lotojnë prej leximit a këndimit të Kur'anit, do të kënaqen në Ditën e Gjykimit.”**

(Kenzul Ummal, hadithi 2824.)

9- Zbatimi i Kur'anit

Prej detyrave më parësore, e cila duhet të zërë vendin më kryesor te lexuesi a kënduesi i Kur'anit është zbatimi i tij, sepse qëllimi i leximit a i këndimit të Kur'anit është zbulimi i kuptimeve që përmbajnë ajetet dhe zbatimi i tyre në jetën e përditshme.

Leximi a këndimi sipërfaqësor, i cekët nuk mund t'ia arrijë këtij qëllimi. Prandaj duhet që lexuesi a kënduesi të thellohet në Kur'an dhe të përqendrohet në ajetet e tij. Për ato ajete që nuk i kupton, të lexojë librat e komentimit.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.”**

(Sure “Sad”, ajeti 29.)

Dhe: **“A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!”**

(Sure “Muhammed”, ajeti 24.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nuk ka mirësi në atë lexim a këndim që nuk bëhet me thellim e me kuptim.”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 210, kap. 26.)

10-Leximi a këndimi duke parë në Kur'an

Leximi a këndimi i Kur'anit mund të bëhet përmendsh (pa e hapur Kur'anin) dhe duke parë në të. Ka hadithe që thonë se leximi a këndimi i Kur'anit duke parë në të është më i mirë.

E kanë pyetur Imam Sadikun (a.s.) për një njeri që e këndonte Kur'anin përmendsh. Ai është përgjigjur: **“Lexoje (këndoje) Kur'anin dhe shiko në të, sepse është më mirë. A nuk e di se shikimi në Kur'an është adhurim (ibadet)?”**

(Biharul Anuar, vëll. 89, f. 196, kap. 22.)

Përmbledhje

Prej etikës së leximit a të këndimit të Kur'anit famëlartë është që njeriu të kujdeset për pastërtinë, të zgjedhë vendin e përshtatshëm, t'i kërkojë mbrojtje All-llahut prej të këqijave të djallit, të lexojë besmele-në, ta lexojë Kur'anin ngadalë dhe me zë të bukur, të thellohet në ajetet dhe t'i zbatojë kuptimet e tyre, dhe të gjitha këto t'i bëjë me ndjenjën e dashurisë e të mallëngjimit.

Pyetje

- 1- Si duhet të jetë gjendja e lexuesit a e kënduesit të Kur'anit?
- 2- Cilat vende janë më të mira për të lexuar a kënduar Kur'an?
- 3- Cila është sasia më e paktë në leximin a këndimin e Kur'anit?
- 4- Ç'do të thotë fjala “tertijl”?
- 5- Sqaroni vlerën e thellimit në ajetet e Kur'anit famëlartë.

Mësimi i 27-të

VLERAT E LUTJES (DUASË) E TË VIZITËS

Në këtë mësim, së pari do t'i përgjigjemi pyetjes: Cila është vlera e lutjes ndaj All-llahut (xh.sh.) në Islam?

Pasi të njihemi më këtë, do të qartësohet mirësia dhe rëndësia e lutjes. Më pas do të flitet për vlerën e vizitimit të eulijave (të mirëve) të All-llahut (xh.sh.).

1- Vlerësimi i lutjes

Për rëndësinë e lutjes hadithet thonë:

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Lutja është kreu i adhurimit dhe askush nuk lodhet prej lutjes.”**

(Biharul Anuar, vëll. 90, f. 300, kap. 16.)

Dhe: **“Lënia e lutjes është mëkat.”**

(Miżanul Hikmeti, kreu. 1189.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Puna më e dashur tek Allau është lutja.”**

(El-Kafij, vëll.2 f.467.)

Reth thënies së All-llahut në suren “El Gafir”, ajeti 60, **“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem”**, Imam Bakiri ka thënë: **“Ajo është lutja dhe adhurimi me i mirë është lutja.”**

(El-Kafij, vëll.2 f.466.)

Një njeri e ka pyetur Imam Bakirin (a.s): **“Cili është adhurimi më i mirë?”** e është përgjigjur: **“Nuk ka punë më të mirë se t’i kërkosht All-llahut atë që ka. Ai që bëhet mëndjemadh ndaj adhurimit të All-llahut dhe nuk i lutet Atij, e zemëron më shumë All-llahun (xh.sh).”**

(El-Kafij, vëll.2 f.466.)

Nëpërmjet këtyre thënieve të ndritshme, zbulojmë vlerën e lartë të lutjes. Është vullneti i All-llahut që qëllimi i njeriut të jetë përsosuria e tij, e cila përmbushet vetëm duke adhuruar All-llahun (xh.sh.), sepse edhe qëllimi i krijimit është adhurimi.

All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Unë nuk i krijova xhindet dhe njerëzit për tjetër përveç që të më adhurojnë.”**

(Sure “Edh Dharijatë”, ajeti 56.)

Çdo njeri duhet të mendojë se është i varfër dhe se gjithçka që ka është prej All-llahut (xh.sh.). Kur’ani thotë: **“O ju njerëz, ju keni nevojë për All-llahun e All-llahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i Falënderuari.”**

(Sure “El Fatir”, ajeti 15.)

Nëse njeriu e kupton këtë të vërtetë, ai do t’i drejtohet adhurimit dhe do t’i lutet All-llahut, i Cili është i Vetëmjaftueshëm. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Thuaj: “Zoti im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj (kur gjendeni në vështirësi, ose sikur të mos ishit të thirrur të besoni), e ju përgënjeshtrohet, prandaj dënimi do t’ju jetë i pandërprerë.”**

(Sure “El Furkan”, ajeti 77.)

S’ka dyshim se lutja është ajo që i rregullon lidhjet mes njeriut dhe Krijuesit të tij, mes të varfrit e të Vetëmjaftueshmit. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“Mos bëni çrregullime në Tokë pas rregullimit të saj (me ardhjen e pejgamberëve) dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën)! S’ka dyshim se mëshira e All-llahut është pranë atyre të mirëve.”**

(Sure "El A'raf", ajeti 56.)

Dhe: **"Pra, adhurojeni All-llahun me një adhurim të çiltër, edhe pse jobesimtarët e urrejnë atë (adhurimin)!"**

(Sure "El-Gafir", ajeti 14.)

Dhe: **"Zoti juaj ka thënë: "Më thërrisni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem".**

(Sure "El-Gafir", ajeti 60.)

Lënia e duasë është baras me mëkatën. Lutjen përkthen më së miri gjendjen e nënshtrimit të njeriut ndaj All-llahut, Zotit të gjithësisë. Robtë më të mirë janë ata që i luten All-llahut (xh.sh.). All-llahu i cilëson këta duke thënë: **"Prandaj shijoni këtë (dënim) për shkak se ju e patët harruar takimin tuaj në këtë Ditë! E, edhe Ne tani ju harruam ju, prandaj, për shkak të asaj që keni vepruar, shijoni dënimin e përjetshëm."**

(Sure "Es Sexhde", ajeti 14.)

2-Vlerat e lutjes dhe ndikimet e saj

Profeti Muhammed (s.a.v.s) ka thënë: **"Lutja është e besimtarit, shtylla e fesë dhe drita e qiejve dhe e Tokës."**

(El- Kafij, vëll.70, f.468.)

Dhe: **"Shërojeni të sëmurët tuaj me sadeka dhe largojeni fatkeqësinë me lutje."**

(Biharul Anuar, vëll.190 f. 288, kap.16.)

Dhe: **"Nuk ka gjë më të mirë tek All-llahu sesa lutja."**

Imam Aliu (a.s) ka thënë: **"Më i njohuri i njerëzve për All-llahun (xh.sh.) është ai që lutet më shumë."**

(Gurerul Hikem f. 192, 3734.)

Dhe: **"Lutja është çelësi i mëshirës dhe ndriçuesi i errësirës."**

(Biharul Anuar, vëll 90, f. 300, kap.16.)

Dhe: **"Ai që troket në derën e All-llahut, All-llahu do t'ia hapë atij."**

(Gurerul Hikem, f. 193.)

Dhe: **"Lutja është më depërtuese se semani."**

(Biharul Anuar, vëll.90, f. 295, kap.16.)

3-Vizitat e eulijave

Dihet që njerëzit kanë marrëdhënie shoqërore. Ata e vizitojnë njëri-tjetrin, takohen me njëri-tjetrin. Kjo ndodh se marrëdhëniet miqësore të ngritura mbi bazën e dashurisë e të respektit, i bënë ata që të jenë të kënaqur me njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie sigurojnë më së miri mirëkuptimin mes tyre dhe botëkuptimin në çështje të përbashkëta. Ka marrëdhënie të cilat, i bashkon mendimi i përbashkët, politika etj. Këtu mund të përkufizojmë edhe qëllimet prej vizitave.

1-Të shprehurit e dashurisë, miqësisë dhe respektit.

2-Sistemi i lidhjeve mendore, partiake.

3-Përfitim shpirtëror e material.

Në kulturën e fesë islame ka marrëdhënie, të cilat lidhin njerëzit me udhëheqësit e tyre shpirtërorë, me dijetarët e tyre të përkushtuar. Kjo, për shkak se ata janë më të diturit e njerëzve për çështjet e fesë. Dhe ata janë më të afërt tek All-llahu (xh.sh.).

Kur njerëzit shprehin dashurinë e tyre për ta, në të vërtetë, shprehin dashurinë ndaj All-llahut (xh.sh.) dhe fesë së Tij. Kur njerëzit i vizitojnë ata, këtë e bëjnë që të shuajnë etjen e tyre shpirtërore. Kur ndodh në takimin e të mirëve dhe të dashurve të All-llahut (xh.sh.), quhet zijaret. Zijareti i të mirëve dhe i dijetarëve të fesë në çdo kohë është e rëndësishme, mirëpo më e rëndësishme dhe më madhështore është zijareti Profetit (s.a.v.s) dhe i imamëve të Ehli Bejtut të tij. Profeti Muhammed (s.a.v.s) ka thënë: **“Për atë që më bën zijaret mua në këtë jetë dhe pas kësaj jete Unë do të jem ndërmjetësues në Ditën e Kijametit.”**

(Biharul Anuar, vëll.98, f.139, kap.1.)

Dhe: **“Ai që më çon selam mua kudo që të jetë, kur jam gjallë, selami do të më mbërrijë. Ai që më çon selam kur jam në varr, unë e dëgjoj atë.”**

(Biharul Anuar, vëll.97, f.182, kap.3.)

Imam Sadiku (a.s) ka thënë: **“Kush shkon në Haxh, ta përfundojë atë me zijaretin tonë, sepse kjo është prej plotësimit të Haxhit.”**

(Biharul Anuar, vëll.97, f.139, kap. 1.)

Dhe: **“Ai që na bën neve zijarete, pas kësaj jete është njësoj sikur të na ketë bërë zijaret kur ishim të gjallë.”**

(Biharul Anuar, vëll.97, f.124, kap.2.)

Prandaj, është mirë që besimtari në cilindo vend të kësaj bote që të ndodhet, të drejtohet me zemrën dhe me shpirtin e tij e të përshëndesë Profetin (s.a.v.s), dhe imamët e familjes së tij, të shprehë dashurinë ndaj Tij dhe ndaj familjes së tij të besuar, si edhe armiqësinë ndaj armiqve të tyre.

Përmbledhje

Përderisa qëllimi i krijimit të njeriut është të arrijë përsosurinë, atëherë lutja (duaia) dhe të shprehurit e njeriut se është i varfër dhe All-llahu është i Pasur, i Vetëmjaftueshëm, është mishërim i bindjes e i adhurimit. Duaia luan rol në njohjen e fesë islame. Po ashtu, edhe zijareti i të dashurve të All-llahut, më së pari, i Profetit Muhammed (s.a.v.s.) dhe i udhëheqësve prej familjes së tij, luan një rol të madh e të rëndësishëm me arritjen e shkallës së përsosurisë.

Pyetje

- 1- Përse hadithi i Profetit (s.a.v.s.) e quan lutjen “kreu i adhurimit”?
- 2- Cila është lidhja e varfërisë me bindjen dhe adhurimin?
- 3- Sqaroni ndikimet e lutjes, siç thonë hadithet e nderuara!
- 4- Cilat janë qëllimet e njeriut në takimet dhe vizitat e të tjerëve?
- 5- Cilat janë frytet e zjaretit të të dashurve të All-llahut (xh.sh.)?



Mësimi i 28-të

RREGULLAT E LUTJES DHE TË VIZITËS

Për lutje dhe vizitën (zijaretin) ka kushte dhe rregulla, të cilat duhet t'i ketë parasyshë çdo njeri që lutet dhe bën zijaret. Në këtë mësim do të njihemi me ato më kryesoret.

1-Njohja e All-llahut

Ai njeri, i cili i lutet All-llahut (xh.sh.), duhet të jetë i vetëdijshëm se All-llahu (xh.sh.) është i Plotfuqishëm për gjithçka se Ai është burimi i gjithçkaje.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Unë do t'i përgjigjem lutjes së atij, që më lutet Mua dhe e di që Unë i sjell dobi.”**

(Biharul Anuar, vëll. 11, f. 305, kap.17.)

Transmetohet se Imam Kadhimi (a.s.) ka thënë: Disa njerëz e pyetën Imam Sadikun (a.s.): **“Si është gjendja jonë? Ne lutemi por lutja nuk na pranohet.”**

Ai u përgjigj: **“Ju i luteni Atij që nuk e njihni.”**

(Sherh Nehxhul Belaga, vëll.11, f.230.)

2-Shpresa në All-llahun (xh.sh.)

Në suren “El A'raf”, ajeti 56 thuhet: **“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me ardhjen e pejgamberëve) dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën)! S'ka dyshim se mëshira e All-llahut është pranë atyre të mirëve.”**

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Lutuni All-llahut dhe jini të bindur se Ai do t'ju përgjigjet.”**

(Biharul Anuar, vëll.2, f.472.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kur të lutesh, të mendosh se nevoja jote është tek dera.”**

(El-Kafij, vëll.2, f.472.)

3-Shpresimi tek askush tjetër përveçse tek All-llahu

4-Prania e zemrës

Prej kushteve të lutjes është prania e zemrës. Para se lutja të dalë nga goja duhet patjetër ta ketë burimin në thellësi të zemrës.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“All-llahu (xh.sh.) nuk i përgjigjet lutjes së atij që lutet pa zemër. Kur të lutesh, zemra jote të jetë e pranishme, pastaj bindu se lutja do të të pranohet.”**

(El-Kafij, vëll.2, f.472.)

5-Përmbajtja dhe butësia

S'ka dyshim se përmbajtja dhe butësia, shprehin ndjenjën e nevojës. Për këtë duhet që njeriu të lutet që ta mbulojë kjo gjendje.

6-Fillimi me emrin e All-llahut

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ajo lutje që fillon me bismilah, nuk kthehet.”**

(Biharul Anuar, vëll. 90, f.313, kap.17.)

Jo vetëm lutjen, por çdo punë myslimani duhet ta filloj me “bismilah”.

7-Falënderimi dhe lavdërimi

Është mirë që myslimani ta fillojë lutjen me kujtimin e All-llahut. Ta falënderojë e ta lavdërojë madhështinë e All-llahut.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Lutja, që nuk ka falënderim, është e cunguar.”**

(Biharul Anuar, vëll.90, f.317, kap. 17.)

8-Salavati mbi Profetin dhe familjen e Tij

Pas falënderimit të All-llahut (xh.sh.), të thuhet salavati mbi Profetin dhe familjen e Tij.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Salavati juaj për mua është një përgjigje për lutjen tuaj dhe zeqat për punët tuaja.”**

(Biharul Anuar, vëll.91, f.54, kap.29.)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Lutja qëndron e bllokuar në qiell derisa të thuhet salavati për Profetin (s.a.v.s.) dhe familjen e Tij.”**

(Biharul Anuar, vëll.90, f.313, kap.17.)

9-Pohimi i gjynaheve

Para se njeriu të paraqesë nevojat e tij, të pranojë e të pohojë dobësinë e tij dhe gjynahet që ka bërë, pastaj të shfaqë pendimin për atë dobësi e për ato gjynahe.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Betohem në All-llah, se rob i del prej mëkatit nëpërmjet pranimit (pohimit) të tij.”**

(El- Kafij vëll.3, f.484).

10-Pastërtia dhe haja hallall

Në një hadith kudsij thuhet: **“Nga ti lutja dhe nga Unë përgjigjja. Lutja që nuk arrin tek Unë, është e atij që ka ngrënë haram.”**

(Nexhdetu Daij, f.139).

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Atij që do t’i pranohet lutja, të hajë e të fitojë hallall.”**

(Biharul Anuar, vëll.90, f. 372 kap.24).

11-Këmbëngulja

Duhet që lutësi të mos mërzhitet, por gjithmonë të këmbëngulë sa të ketë mundësi. Këmbëngulja tregon se ai e ka kuptuar që All-llahu është i Vetmi, të Cilit i kërkohet mbështetje dhe përmbushja e nevojave.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“All-llahu i do këmbëngulësit në lutje.”**

(Biharul Anuar, vëll.90 f. 366, kap. 16).

12- Lutja me xhemat

Nëse dikush dëshiron t’i kërkojë diçka All-llahut, është mirë që të mbledhë familjen e tij e pse jo, edhe shokët e tij, pastaj t’i lutet All-llahut (xh.sh.).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kur e zemëronte diçka babanë tim, ai tubonte familjen, pastaj lutej dhe sigurohej.”**

(El-Kafj, vëll.2, f. 487.)

13-Shoqërimi i veprës me lutjen

Ka dallim mes mbështetjes tek All-llahu (tevekul) dhe të (teuaakul). Teuekul (mbështetja) tek All-llahu (xh.sh.) do të thotë; *besimi në vullnetin e Tij dhe të punohet*. Teuaakul do të thotë që njeriu t’i lutet Zotit për zgjidhjen e një problemi e më pas nuk përpiket e as nuk punon. Duhet që lutësi edhe të përpiket sa më shumë, dhe të mbështetet tek All-llahu (xh.sh.).

Imam Aliu (a.s) ka thënë: **“Lutësi që nuk punon, është si shigjetari që nuk ka hark.”**

(Nehxhul Belaga, urtësia 337).

14- Lutjet me’ture

Nëse lutësi dëshiron t’i lutet All-llahut, duhet të zgjedhë lutje të transmetuara nga Profeti (s.a.v.s.) dhe nga Ehli Bejti (a.s.), të cilat kanë etikën, sqarimin, vlerën morale, pastërtinë për shpirtin. Ndër ato është *“Lutja e Kumejlit”*, *“Lutja e Sabahul”*, lutja e njohur me emrin *“Ebi Hamze Thumajli”*, *“Munaxhutet e muajit Sha’ban.”*

Ka edhe rregulla te tjera për lutjen, siç janë pastërtia, abdesi, drejtimi kah kiblja, zgjedhje e vendit të përshtatshëm dhe e kohës së përshtatshme.

Përmbledhje

Duhet që lutësi ta njohë Atë të Cilit i lutet dhe i beson në përgjigjen e saj dhe ky është All-llahu. Të shpresojë tek Ai për çdo gjë, ta shoqërojë lutjen me përvuajtësi, dhe t'i drejtohet All-llahut me zemër të plotë. Ta fillojë lutjen me përmendjen e All-llahut, me salavat për Profetin dhe Ehli Bejtin (a.s.). Të mos mërzitet, të jetë këmbëngulës, të pranojë dobësinë e vet, nevojat e tij dhe çfarë ka bërë prej mëkateve dhe të vendosë të largohet prej mëkateve.

Pyetje

- 1-Cila është rëndësia e njohjes së All-llahut në lutje?
- 2-Si duhet të jetë gjendja e lutësit?
- 3-Çfarë duhet të bëjë njeriu para lutjes?
- 4-Cilët janë ata njerëz që nuk u pranohet lutja? Sqarojeni këtë me hadithe të nderuara.

Mësimi i 29-të

UDHËTIMI, QËLLIMI DHE TË MIRAT E TIJ

Arsyet dhe qëllimet e udhëtimit janë të ndryshme te njerëzit. Qëllimet mund të jenë të gabueshme ose të sakta. Udhëtimi është marrëdhënie me të tjerët. Islami e sheh udhëtimin në dy anë: a- nga ana e sheriatit; b- Nga ana e moralit.

Nga ana e sheriatit: A është i ligjshëm udhëtimi, apo i paligjshëm? Pastaj, ka rregulla në lidhje me namazin dhe agjërimin e udhëtarit.

Nga ana morale: udhëtimi hyn në rrethin e marrëdhënieve shoqërore, siç është shoqëruesi në udhëtim. Ka rregulla që kanë të bëjnë me udhëtarin dhe me të tjerët që udhëtojnë bashkë me të. Në këtë mësim do të paraqesim arsyet dhe qëllimet e udhëtimit sipas Sheriatit; pastaj do të flasim për dobritë e udhëtimit, duke u mbështetur në hadithe. Për etikën e udhëtimit do të flitet në mësimin e ardhshëm.

Arsyet e udhëtimit sipas Sheriatit

1-Përfitimi i dijes dhe i njohjes

S'ka dyshim se udhëtimi për të përfituar dije, qëndron në krye të qëllimeve të Sheriatit. Nëse qëllimi i udhëtimit është studimi i dijes së fesë, ai atëherë është edhe më i lartë. Mundet që një njeri të udhëtojë thjesht për të parë gjurmët e jetës së popujve të shkuar, ose për të parë mirësitë e All-llahut dhe madhësitë e Tij në Krijim, ose për të vizituar një qytet ku jetojnë dijetarë të njohur të fesë, ose për të vizituar shkolla, universitete a institucione, të cilat punojnë për fenë. Ky udhëtim është i mrekulueshëm dhe me synime të larta.

All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Thuaj: Udhëtoni nëpër Tokë e shikoni se si filloi Krijimi, pastaj All-llahu e fillon krijesën tjetër (Ringjalljen). Është e vërtetë se All-llahu ka mundësi gjithçka.”**

(Sure “El-Ankebut”, ajeti 20.)

Dhe: **“A nuk udhëtuan ata nëpër Tokë e të kenë zemra me të cilat të kuptojnë dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë? Pse, në të vërtetë nuk verbërohen sytë, por verbërohen zemrat në krahavaror!”**

(Sure “El-Haxh”, ajeti 46.)

E, çfarë u ndodhi popujve të shkuar, këto të merren në konsideratë. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Përpara jush kanë kaluar popujt, ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtroan!”**

(Sure “Ali Imran”, ajeti 137.)

Dhe: **“A nuk udhëtuan ata nëpër Tokë e të shohin se si ishte përfundimi i atyre që patën qenë para tyre?! Ata ishin edhe më të fuqishëm se këta e edhe lanë më shumë gjurmë në Tokë, por All-llahu i dënoi për shkak të mëkateve të tyre dhe nuk pati ndonjë që t'i mbronte prej dënimit të All-llahut.”**

(Sure “El-Gafir”, ajeti 21.)

Këto ajete të bekuara e të tjera përveç këtyre, ftojnë për të udhëtuar e për të ecur për dy qëllime:

1-Për të parë natyrën dhe çfarë gjendet në të, që tregon madhësinë e Krijuesit të gjithësisë dhe mëshirën e Tij të gjerë për robtë e Tij.

2-Për të parë gjurmët e popujve të shkuar, si kështjellat etj, që i ndërtuan xhebabirët. Historinë e tyre njeriu ta marrë në konsideratë, ta studiojë dhe të zbulojë rrugën e drejtë, rrugën e vërtetë.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Ai që del nga shtëpia e tij për të kërkuar dijen, është në rrugën e All-llahut derisa të kthehet.”**

(Sunen Termidhij, vëllimi.10.)

Dhe: **“Atij që bën një rrugë për të kërkuar dijen, All-llahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhennet.”**

(Munijetul Munrijd, f.104.)

2-Ruajtja e fesë dhe mbrojtja e saj

Nëse ruajtja e fesë dhe mbrojtja e besimit bëhet e vështirë në vendin ku jeton, është detyrë të udhëtohet dhe mërgimi bëhet i detyrueshëm. Nuk duhet që padrejtësia e shtypja të jenë shkak i largimit nga feja e nga besimi, por është detyrë që myslimani të mërgojë në një vend tjetër, i cili ia mundëson të kryejë rregullat dhe simbolet e fesë.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“Melekët që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetes u thanë: “Çfarë ishit ju?” - Ata thanë: “Ne ishim të paafte në atë tokë!” (melekët) u thanë: “A nuk ishte e gjërë Toka e All-llahut e të mërgonit në të (e të ushtronit lirisht fenë e Zotit)?” Vendi i tyre është Xhehennemi. Dhe, sa vend i keq është ai!”**

(Sure “En-Nisa”, ajeti 97.)

All-llahu i lavdëron mërgimtarët në rrugën e fesë e të besimit të tyre, duke thënë: **“Kush shpërngulet për hir (të fesë së) All-llahut, gjen mundësi dhe begati të madhe në tokë. E, kush del prej shtëpisë si mërgimtar tek All-llahu dhe i Dërguari i Tij dhe e zë vdekja (në rrugë), tek All-llahu është shpërblimi i tij. All-llahu është Mëshirues, Ai mbulon të metat.”**

(Sure “En Nisa”, ajeti 100.)

3-Haxhi e umre-ja

Është detyrë e çdo myslimani që të shkojë në Haxh një herë gjatë jetës së tij, nëse ka mundësi ekonomike e shëndetësore. S’ka dyshim se udhëtimi për të kryer Haxhin, për të vizituar xhaminë e Profetit (s.a.v.s.) dhe imamët e bekuar ka qëllim të lartë.

4-Sigurimi i kafshatës së ndershme

Prej arsyeve të ndershme të udhëtimit është kërkimi i kafshatës hallall. Edhe udhëtimi për turizëm për të qetësuar shpirtin, por me kusht që të mos ketë asnjë veprim haram.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Në urtësinë e Daudit (a.s) është shkruar; “Njeriu nuk jeton tri gjëra; furnizimin për ringjalljen, meremetun për jetesë dhe kënaqësinë për të jetuar.”**

(Biharul Anwar, vëll.73, f. 221, kap.45.)

Të mirat e udhëtimit

Për frytet e udhëtimit dhe çfarë vjel njeriu në të, Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Udhëtoni, të jeni të shëndetëshëm; udhëtoni, të pasuroheni!”**

(Biharul Anwar, vëll.73 f.221, kap.45.)

Dhe: **“Udhëtoni, sepse, nëse nuk pasuroheni, përfitoni intelektin!”**

(Mekarimul Akhlak, f. 240.)

Dhe: **“Udhëtoni, të jeni të shëndetshëm dhe të përfitoni mirësi!”**

(Kenzul Ummal, hadithi / 17469.)

Udhëtimi e lartëson besimtarin nga ana shpirtërore e materiale dhe i jep mundësi të njihet me kulturën dhe zakonet e popujve të tjerë. Po ashtu, i hap atij dritare për tregtim dhe fitime hallall. I jep mundësi të përhapë fenë e All-llahut në popuj e shoqëri duke i ndriçuar rrugët e tyre me dritën e Islamit. S’ka dyshim se në këtë vepër ka shpërblim të madh nga All-llahu (xh.sh.).

Përmbledhje

Arsyet e udhëtimit dhe qëllimet e tij sipas islamit janë: fitimi i dijes, ruajtja e fesë dhe e besimit, Haxhi dhe vizita e xhamisë së Profetit (s.a.v.s.), siguri i kafshatës së nderdhme dhe qetësia shpirtërore.

Pyetje

- 1- Numëroni mënyrat të cilat mund të fitohet njohja e All-llahut!
- 2- Për cilin lloj të udhëtimit nxit Islami?
- 3- Përmendni ajetin, që flet për ata, të cilët u përballën me padrejtësinë e shtypësve dhe iu nënshtruan të padrejtëve dhe nuk mërguan! Sqarojeni shkurtimisht!
- 4- Cilat janë arsyet e mërgimit sipas hadithit?
- 5- Cilat janë frytet që vjel njeriu në udhëtim?

Mësimi i 30-të

RREGULLAT E UDHËTIMIT DHE MORALI I UDHËTARIT

Cilido që bën nijet dhe vendos të udhëtojë, duhet të jetë i vëmendshëm për rregullat dhe kushtet e udhëtimit.

1-Zgjedhja e shokut në udhëtim

Është mirë që udhëtari të mos udhëtojë vetëm nëse ka mundësi dhe ta zgjedhë shokun, me të cilin do të udhëtojë, sepse shoku ia lehtëson rrugën duke biseduar etj. Veç kësaj, ka raste që udhëtari përballet më vështirësi dhe ka nevojë për ndihmë e për bashkudhëtar.

Imam Sadiku (a.s.) ka kumtuar se Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“A t’ju lajmëroj se cili është njeriu më i keq?”** I thanë: “Po, o i dërguari i All-llahut.” Ai tha: **“Ai që udhëton i vetëm, pengon refolehu dhe rreh shërbyesin e tij.”**

(Men la jehderubul fakih, kreu, “Përbuzja e vetmisë në udhëtim”, vëll. 2, f. 276.)

Dhe: **“Profeti (s.a.v.s.) ka mallkuar tre veta: atë që ha i vetëm, atë që fle në shtëpi vetëm dhe udhëtarin që udhëton vetëm.”**

(Men la jehderubul fakih, kreu, “Përbuzja e vetmisë në udhëtim”, vëll. 2, f. 276.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Zgjidh shokun, pastaj udhëto!”**

(Biharul Anuar, vëll.73, f.229, kap.47.)

2- Detyrimet e udhëtarit

Ai që vendos të udhëtojë, duhet të kryejë detyrat e tij ndaj Allahut (xh.sh). Ai duhet të shlyejë të gjitha detyrimet, si borxhet, kreditë etj. Nëse nuk ka mundësi ta bëjë këtë ta shkruajë në testamentin dhe këto të shlyhen prej pasurive që ai lë.

3- Përgatitja për udhëtim

Ai që vendos të udhëtojë, duhet të përgatitë çdo gjë që është e domosdoshme dhe e nevojshme për udhëtimin. Udhëtari nuk mund të mos ketë me vete shpenzimt e nevojshme e të mjaftueshme. Nëse nuk arrin t’i sigurojë ato, do të përballet me vështirësi në udhëim.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Prej krenarisë së njeriut është që të përgatitë furnizimin e vet kur del për të udhëtuar.”**

(Men la jehderhu el fakih, vëll.2, f. 281.)

Dhe: **“Prej synetit është: nëse një grup njerëzish dalin për të udhëtuar, të sigurojnë shpenzimet, sepse kjo është më e këndshme për njerëzit dhe më e përkryer për moralet.”**

(Men la jehderhu el fakih, vëll.1, f. 278.)

Në thelbin e moralit e të marrëdhënieve shoqërore: bashkudhëtarët duhet t'i ndajnë shpenzimet në mënyrë të barabartë dhe nuk duhet që dikush të shpenzojë në kurriz të të tjerëve. Pa dyshim kjo pasqyron pastërtinë e zemrave dhe shton respektin mes udhëtarëve.

4- Lutja dhe përmendja e Allahut

Udhëtari duhet ta përmendë Allahun (xh.sh) dhe t'i lutet Atij. Është mirë që para se të udhëtojë, udhëtari të lexojë suren *“Fatihë”*, ajetin e *“Kursijut”* dhe lutje të posaçme për udhëtimin, që na janë përcjellë nga Profeti (s.a.u.s.) dhe Ehli Bejti (a.s.).

Transmetohet se Imam Sadiku ka thënë se kur një njeri dëshiron të udhëtojë, të thotë: **“O Zot, na e lehtëso rrugë, mirësoje udhëtimin e na e ruaj shëndetin.”**

(Men la jehderhu el fakih, vëll.2, f. 271.)

Kur të futë këmbën në automjet, në aeroplan etj., të thotë ajetin: **“...Falënderuar qoftë Ai që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë.”** (Sure Zuhruf, ajeti 13.), pastaj të thotë 7 herë **“Subhanallah uelhamdulillah ue lailaheil-lall-llah.”**

(Mekarimul Ahlak).

Imam Rizai ka thënë: **“Kur nisesh për të udhëtuar ose kur kthehesh nga udhëtimi, thuaj: “Bismil-lahi, Amentubil-lahi, Masha-allahu, la hauleuela kuuete i-la bil-lahi.”**

(Men la jehderhu el fakih, vëll.2, f. 272.)

5-Sadekaja

Siç dihet prej syneti në Islam është dhënia e sadekasë të varfrve dhe nevojtarëve, veçanërisht kur vendos të udhëtojë.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Sadekaja largon fatkeqësitë.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f.137, kreu 14.)

Dhe: **“Sadekaja mbyll 70 porta të së keqes.”**

(Biharul Anuar, vëll. 93, f.137, kreu 14.)
Dhe: **“Sadekaja ndalon vdekjen e keqe.”**
(Biharul Anuar, vëll. 93, f.137, kreu 14.)

6 - Zemërgjerësia e shpirtmirësia

Bashudhëtarët duhet të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë zemërgjerë e shpirtmirë, të përballojnë të gjitha nevojat e udhëtimit dhe të mos e shqetësojnë njëri-tjetrin.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Kur shoqërohen dy veta, njëri prej tyre është më i madh, më i shpërblyer dhe më i dashur tek Allahu.”**

(El Uesail, vëll. 11, f. 412.)

Dhe: **“Zemërgjerësia në udhëtim do të thotë të shpenzosh, të kesh moral të mirë dhe të mos bësh shaka me mëkate.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f.266, kreu 49.)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Zemërgjerësia në udhëtim është të shpenzosh, të mos bësh konflikte me shokun tënd, ta shtosh përmendjen e Allahut në çdo ulje e në çdo ngritje, në çdo ngjitje e në çdo zbritje.”**

(El Uesail, vëll. 11, f. 437)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Lukmani i ka thënë të birit: kur të udhëtosh me të tjerë, këshillohu sa më shumë me ta në çështjen tënde dhe në çështjet e tyre, shtojë buzëqeshjen para tyre, bëhu bujar në shpenzimet e tua mes tyre, nëse të ftojnë përgjigju ftesës së tyre dhe nëse të kërkojnë ndihmë, ndihmoji ata!”**

(El Uesail, vëll. 11, f. 440)

7- Sjellja e dhuratave

Sheriati islam e nxit udhëtarin të sjellë dhurata për familjen e tij kur të kthehet prej udhëtimit. Vërtet, familjarët e presin ardhjen e tij me mall dhe dhurata është treguese e dashurisë dhe e mallit të tij për ta.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nëse dikush prej jush udhëton, kur të kthehet në familjen e tij le t’u sjellë dhuratë qoftë edhe gur.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f.283.)

Për udhëtimin ka, sigurisht edhe etika të tjera, sit ë lihet testamenti, të falen dy rekatë namaz, të përshëndeten të afërmit dhe shokët e nëse janë më shumë se tre veta në udhëtim, të zgjidhet përgjegjësi.

Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Nëse janë tre veta në udhëtim, të zgjedhin një prijës të tyre.”**

(Kenzul Ummal, hadithi /7549)

Përgjegjësi i zgjedhur nuk duhet ta konsiderojë këtë detyrë dallim, por përgjegjësi dhe ta zbatojë atë. Ai duhet të jetë i drejtë e i paanshëm ndaj shokëve të tij gjatë udhëtimit. Ai mund t’u shërbejë atyre. Për këtë Profeti Muhammed (s.a.u.s.) ka thënë: **“Më i nderuari i njerëzve është ai që u shërben të tjerëve në udhëtim.”**

(Biharul Anuar, vëll. 73, f. 273, kreu 49.)

Përmbledhje

Për udhëtimin ka shumë etika. Prej tyre janë: Udhëtari të mos udhëtojë i vetëm, të shlyejë borxhet, të shkruajë testamentin e tij, të mos jetë shpërfillës ndaj bashkudhëtarëve dhe të zgjidhet një përgjegjës.

Prej etikave të udhëtimit është lutja (*dua*) e të këndohet brenda mundësive Kur’an. Është e pëlqyeshme, gjithashtu, që udhëtari të japë sadeka, të jetë zemërmirë me shokët në udhëtim etj. Prej etikës së udhëtimit është sjellja e dhuratave për familjen, kur udhëtari të kthehet.

Pyetje

- 1- Përmendni disa etika të udhëtimit!
- 2- Shpjegoni shkurtimisht hadithin e nderuar, “*Shokun para udhëtimit.*”
- 3- Cilat janë ato etika me të cilat duhet të zbukurohet udhëtari kur udhëton me dikë tjetër?
- 4- Çfarë shpreh dhurata që sjell udhëtari familjes së tij kur kthehet nga udhëtimi?



Pasqyra e lëndës

Tema

Faqe

MËSIMI 1

POZITA E DIJES DHE E DIJETARËVE NË ISLAM

a-Pozita e dijes dhe e dijetarëve Kur'an

b- Pozita e dijes dhe e dijetarëve në hadithet profetike

Vlera e studiuesit dhe e kërkuesit të diturisë në hadithet e Profetit Muhammed (s.a.v.s.)

Përmbledhje

Pyetje

MËSIMI 2

POZITA E DIJES DHE E DIJETARËVE NË ISLAM (2)

Vlera e dijes dhe e dijetarëve në hadithet e Ehli Bejtit (a.s.)

Përsosuria e dijetarit në krahasim me përsosurnë e adhuresit

Qëllimi i kërkimit të diturisë

Përmbledhje

Pyetje

MËSIMI 3

RREGULLAT DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT (1)

Detyrat e përbashkëta

2- Çiltërsia e nijetit

Rrugët e arritjes së sinqeritetit në nijet

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i katërt

ETIKAT DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Dija dhe puna

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 5^{të}

ETIKA DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Largimi prej mendjemadhësisë së dijes

Mbështetja tek All-llahu (xh.sh.)

Devotshmëria

Morali i përsosur

Ndershmëria dhe pastërtia

Kapja pas simboleve të fesë

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 6^{të}

DETYRAT E MËSUESIT (1)

B- Detyrat individuale

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 7^{të}

DETYRAT E MËSUESIT (2)

Detyrat e mësuesit kundrejt nxënësve janë:

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 8 të

DETYRAT E MËSUESIT (3)

B- Detyrat e mësuesit në klasë

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 9 –të

DETYRAT E NXËNËSIT (1)

10- Detyrat individuale të nxënësit

11- Detyrat e nxënësit ndaj mësuesit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 10-të

DETYRAT E NXËNËSIT (2)

12- Detyrat e nxënësit në klasë

Mësimi i 11 -të

Etika e banimit në konvikte

Përmbledhje

Pyetje

MARTESA

Pozita e martesës dhe vlera e saj

Dobitë e martesës

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 12 –të

TË DREJTAT BASHKËSHORTORE

Detyrat e burrit ndaj gruas

Përmbledhje

Pyetje:

Mësimi i 13- të

VLERA E VEPRAVE MORALE NË DY GRUPE AJETESH E HADITHESH

Grupi i parë

Grupi i dytë

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 14-të

RREGULLAT E PUNËS E TË FITIMIT TË TË ARDHURAVE

A- Fikhu i punës

B- Largimi prej monopolit

C- Lutja dhe përmendja e All-llahut (xh.sh.)

Ç- Përmendja e të metave të mallit

D- Drejtësia në shitblerje

DH- Toleranca me të varfërit

E- Largimi prej mashtrimit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 15-të

PASTËRTIA (1)

2- Pastërtia e trupit

2- Rregullat e tualetit

3- Pastrimi i rrobave

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 16- të

PASTËRTIA (2)

4- Siuaku dhe pastrimi i dhëmbëve

Dobitë e siuakut

6- Shkurtimi i flokëve dhe rregullimi

6- Prerja e thonjve

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 17-të

PARFUMIMI

Pastrimi i shtëpisë dhe i mjedisit

Pastrimi i mjedisit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 18- të

RREGULLAT E TAHALIJUT

1- Mbulimi

2- Ruajtja e auresit (pjesëve të turpshme)

3- Mënyra e tehalijut

4- Heshtja

5-Etika të tjera

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 19-të

RREGULLAT E NGRËNIES (1)

1- Pastërtia dhe lejueshmëria (hallall) e ushqimit

2- Larja e duarve

3- Mënyrat e uljes në tryezë

4- Fillimi me “bismil-lah”

5-Nijeti

6- Mënyra e fillimit të ushqimit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 20-të

RREGULLAT E USHQIMIT (2)

7-Mënyra e ngënies

8- Mënjanimi i hajes së tepërt

9- Haja me xhemat

10- Etika e ngrënies bashkërisht

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 21- të

ADHURIMI (IBADETI)

1- Adhurimi, qëllimi i krijimit dhe mesazhi i të dërguarve.

2- Mirësitë e adhurimit

3- E vërteta e adhurimit dhe e nënshtrimit ndaj All-llahut (xh.sh.)

4- Adhurimi me vetëdije

5- Qëllimi i adhurimit

6-Llojet e adhurimit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 22 të

MIRËSITË E NAMAZIT

Namazi në ajetet e Kur'anit

Namazi në hadithet e Profetit (s.a.v.s.)

Namazi në hadithet e Ehli Bejtit (a.s.)

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 23 të

RREGULLAT E NAMAZIT

1- Zbatimi i kushteve të namazit

2- Etika e pranisë në namaz

4- Gjallëria dhe dashuria

4- Frika

Frika e zemrës

Frika e trupit

5-Prania e zemrës

7- Nderimi i namazit

8- Koha e përkryer

9- Zbukurimi

10-Falja e namazit me xhemat

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 24

MIRËSITË E AGJËRIMIT

6- Agjërimi është për Mua...

7- Agjërimi është mburojë

8- Arsyet e agjërit

9- Ndikimet shpirtërore të agjërit

10-Kufijtë e agjërit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 25 të

MIRËSITË E KUR'ANIT FAMËLARTË DHE POZITA E TIJ

- 2- Mirësitë e Kur'anit
- 2- Mirësitë e leximit a të këndimit të Kur'anit
- 3- Mirësia e mësimi dhe e të mësuarit të Kur'anit
- 4- Mirësitë e zbatimit të Kur'anit dhe e hifzit (mësimi përmendësh) të tij
- 5- Heshtja dhe dëgjimi me vëmendje

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 26 të

ETIKA E LEXIMIT A E KËNDIMIT TË KUR'ANIT

- 5- Etikë e jashtme
- 6- Vendi i leximit a i këndimit të Kur'anit
- 7- Sasia e leximit a e këndimit të Kur'anit
- 8- 5- Istiadh-ja dhe besmel-ja
- 6-Tertili i Kur'anit
- 7- Frika dhe trishtimi
- 8-Leximi a këndimi duke parë në Kur'an
- 9- Zbatimi i Kur'anit
- 10- Zëri i bukur

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 27-të

VLERAT E LUTJES (DUASË) E TË VIZITËS

- 2- Vlerësimi i lutjes
- 2-Vlerat e lutjes dhe ndikimet e saj
- 3-Vizitat e eulijave

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 28-të

RREGULLAT E LUTJES DHE TË VIZITËS

- 1-Njohja e All-llahut
- 2-Shpresa në All-llahun (xh.sh.)
- 3-Shpresimi tek askush tjetër përveçse tek All-llahut
- 4-Prania e zemrës
- 5-Përmbajtja dhe butësia
- 6-Fillimi me emrin e All-llahut
- 7-Falënderimi dhe lavdërimi
- 8-Salavati mbi Profetin dhe familjen e Tij
- 9-Pohimi i gjynaheve

10-Pastërtia dhe haja hallall
11-Këmbëngulja
12- Lutja me xhemat
13-Shoqërimi i veprës me lutjen
14- Lutjet me'thure
Përmbledhje
Pyetje
Mësimi i 29-të

UDHËTIMI, QËLLIMI DHE TË MIRAT E TIJ

Arsyet e udhëtimit sipas Sheriatit

1-Përfitimi i dijes dhe i njohjes
2-Ruajtja e fesë dhe mbrojtja e saj
3-Haxhi e umre-ja
4-Sigurimi i kafshatës së ndershme
Të mirat e udhëtimit
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi i 30-të

RREGULLAT E UDHËTIMIT DHE MORALI I UDHËTARIT

1-Zgjedhja e shokut në udhëtim
2- Detyrimet e udhëtarit
3- Përgatitja për udhëtim
4- Lutja dhe përmendja e Allahut
5-Sadekaja
6 - Zemërgjerësia e shpirtmirësia
7- Sjellja e dhuratave
Përmbledhje
Pyetje